



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJËNDJES CIVILE

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHËRBIMIN E GJËNDJES CIVILE



TIRANË 2010



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRËNDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJËNDJES CIVILE**

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHËRBIMIN E GJËNDJES CIVILE

Botimi i këtij materiali është financuar nga UNICEF

Për këtë botim bashkëpunoi TLAS

TIRANË 2010

LISTA E AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE BAZË, KU MBËSHKETET VEPRIMTARIA E SHËRBITIMIT TË GJENDJES CIVILE

Aktet ligjore

1. Ligji Nr. 10 129, datë 11. 05. 2009 “Për Gjendjen Civile”;
2. Ligji Nr. 8951, datë 10.10.2002, “Për numrin e identitetit të shtetasve”;
3. Ligji Nr. 8952, datë 10. 10. 2002, “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptare”, i ndryshuar;
4. Ligji Nr. 9062, datë 08. 05. 2003 “Kodi i Familjes”;
5. Ligji Nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 145, datë 28. 09. 2009 . 2008 ;
6. Ligji Nr. 8389, datë 05. 08. 1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8442, datë 21. 01. 1999 ;
7. Ligji Nr. 9060, datë 08. 05. 2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”;
8. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 134, datë 7.3.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”;
9. Akt – marrëveshje “Për bashkëpunimin e Zyrave të Gjendjes Civile dhe Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për dhënien e çertifikatave të vdekjes, për efekt të mbylljes së pensioneve, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme”;

10. Ligji Nr. 9220, datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit;
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 426, datë 9.7.1998 "Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", i azhurnuar me: VKM Nr. 788, datë 26.11.2003 dhe VKM Nr. 721, datë 30.10.2007;
12. Udhëzim Nr. 2, datë 19.7.2004 "Mbi përcaktimin dhe plotësimin e modelit të regjistrit të shërbimit të varrimit";
13. Udhëzim nr. 3912, datë 21.6.2004 "Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit";
14. Udhëzim Nr. 16, datë 18.4.2008 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.721, datë 30.10.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr.426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", të ndryshuar
15. Ligji Nr. 7652, Datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore";
16. Ligji Nr. 7895, datë 27. 01. 1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Seksioni VIII, Falsifikimi i Dokumenteve
17. Ligji Nr. 8116, datë 29. 03. 1996, Kodi Proçedurës Civile, i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjet nr. 8181, datë 23. 12. 1996 dhe 8431, datë 14. 12. 1998.
 - a. KREU IV, Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lidhen me martesën, B. Gjykime në lidhje me martesën
 - b. KREU VI, Shpallja e zhdukjes ose e vdekjes së një personi;
 - c. KREU VIII, Vërtetimi Gjyqësor i Fakteve;
 - d. KREU IX, Njohja e vendimeve të shteteve të huaja, Zbatimi i

vendimit të një gjykate të huaj,

18. Ligji Nr. 7850, date 29. 07. 1994 Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë

Kreu I, Personat fizikë

Ç. Banimi dhe qëndrimi

D. Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi

Akte të tjera nënligjore

19. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 07.01.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptare dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, e ndryshuar;

20. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 50, datë 23. 01. 2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 1, datë 07.01.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”;

21. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 418, datë 27. 04. 2009 “Për njohjen dhe përdorimin e letërnjoftimit si dokument identifikimi”;

22. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1243, datë 11. 12. 2009 “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve.

23. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1299, datë 16. 12. 2009 “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarqeve”;

24. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 332, datë 17. 03. 2010 "Për përcaktimin e formës, elementëve përbërëse. Mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile";
25. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 332, datë 01. 04. 2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 1, datë 07. 01. 2009 të Këshillit të Ministrave "Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve", të ndryshuar.
26. Urdhër i Ministrit të Brendshëm Nr. 1366, datë 19. 08. 2006 "Për Miratimin e Rregullores Për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Zyrës së Gjendjes Civile";
27. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 116, datë 12. 04. 2010 "Për procedurat e përfitimit të shpërblimit nga regjistrimi i fëmijëve sipas ligjit Nr. 10 129, Datë 12.04.2009 "Për gjendjen civile";
28. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 308, datë 08. 05. 2009 "Për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve";
29. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 373, datë 03. 06. 2009 "Mbi procedurat e ripajisjes së shtetasve me letërnjoftim/pasaportë biometrike në rastet të humbjes/vjedhjes së tyre;

LIGJ

Nr. 10 129, datë 11.5.2009

“PËR GJENDJEN CIVILE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Gjendja civile” është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre.
2. “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile” është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar,

shtetasi të huaj dhe çdo personi pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

3. "Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile" është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile. Ky libër ruhet në arkivin e degës të gjendjes civile në qark.

4. "Përbërës të gjendjes civile" janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë

për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj apo çdo personi pa shtetësi me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

5. "Përbërës të prezumuar" janë përbërësit e gjendjes civile, të cilët vlerësohen të mirëqenë deri në çastin, që vërtetohet ndryshe.

6. "Dokumente të arkivuara" është i gjithë dokumentacioni, që mbahet dhe përdoret nga zyra e degës së gjendjes civile në qark.

7. "Emra të papërshtatshëm" janë emrat me karakter fyjes, imoral ose racist, të përcaktuar të tillë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

8. "Ministri"/"Ministria" është ministri/ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 3

Karakter i personal i të dhënave

1. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal.

Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkrese për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përket këto të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

2. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i

përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.

3. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej institucioneve dhe organeve të ndryshme, në përputhje me përmbledhësen e miratuar prej tij dhe komisionerit të të dhënave personale. Përmbledhësja përcakton llojin dhe sasinë e informacionit, që mund t'u jepet institucioneve dhe organeve kërkuese, duke pasur parasysh ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tyre, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4

Vlera juridike e të dhënave

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

2. Për çdo akt dhe dokument, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon, në mënyrë të plotë, emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

Neni 5

Papajtueshmëria e veprimeve

Nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile aty ku është emëruar, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këtë rast veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile.

KREU II

GJENDJA CIVILE

Neni 6

Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, kombësia, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.
2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.
3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 7

Numri i identitetit

1. Numri i identitetit është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.
2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 8

Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë, kombësia dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 9

Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit

Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja.

Neni 11

Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera

Birësimi, shtetësia, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë të gjendjes civile, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë të gjendjes civile, kur ndryshohen sipas ligjit.

Neni 12

Përbërës që vërtetohen nga burime të tjera

Përbërësit e tjerë vërtetohen sipas ligjit nga organet dhe institucionet shtetërore, subjektet juridike, shtetërore e private, ose drejtpërdrejt nga ligji i veçantë dhe marrin cilësinë e përbërësit, kur pasqyrohen në dokumentet e gjendjes civile.

Neni 13

Gjendja civile e personave

1. Gjendja civile e një personi mund të jetë:

- a) beqar/e;
- b) i/e martuar;

- c) i/e ve;
- ç) i/e shkurorëzuar.
- 2. "Beqar/e" është shtetasi, i cili nuk ka kryer akt martesë.
- 3. "I/e martuar" është shtetasi i lidhur me akt martesë.
- 4. "I/e ve" është shtetasi pas vdekjes së bashkëshortes/bashkëshortit, me të cilën/cilin ishte i/e lidhur me akt martesë.
- 5. "I/e shkurorëzuar" është shtetasi, martesë e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor.

KREU III

DEKLARIMI DHE REGJISTRIMI I VENDBANIMIT

Neni 14

Deklarimi i vendbanimit

1. Shtetasit kanë të drejtë të kenë një apo më shumë banesa për përdorim vetjak apo familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese për përdorim, sipas kësaj pike.
2. Shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij.

Neni 15

Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit

1. Regjistrimi fillestar i vendbanimit/adresës së banesës, sipas nenit 14 të këtij ligji, si dhe ndryshimi i vendbanimit/adresës së banesës, si rregull, bëhet në zyrën e gjendjes civile bashki/komunë që ka në juridiksion territorial vendbanimin apo banesën e deklaruar.
2. Nëse një shtetas ka më shumë se një banesë për përdorim, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, ai duhet të deklarojë banesën, në të cilën ka vendbanimin e tij. Shtetasit nuk mund të deklarojnë njëherazi më

shumë se një vendbanim.

3. Në rast ndryshimi të vendbanimit, apo kur një banesë nuk përdoret më për përdorim vetjak apo të familjes, ky ndryshim deklarohet në zyrën e gjendjes civile. Regjistrimi fillestar i vendbanimit apo ndryshimi i tij bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. I njëjti afat zbatohet edhe për deklarimin e banesave që nuk kanë statusin e vendbanimit.

4. Rregullat e veprimeve për pasqyrimin e regjistrimit dhe ndryshimit të vendbanimit të shtetasve, përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

Neni 16

E drejta për deklarimin e vendbanimit

1. Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes.

2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtareve të tjerë të familjes, bën deklarim individual të vendbanimit. Shtetasi mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak.

3. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të, bëhet sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit.

Neni 17

Pranimi në një vendbanim tjetër

1. Një shtetas apo një familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një shtetasi apo familjeje tjetër, kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe kur zotërojnë një kontratë apo kur kryefamiljari i familjes pritëse apo shtetasi që

zotëron titull të ligjshëm pronësie ose përdorimi të banesës, deklarohet në zyrën e gjendjes civile pranimin e shtetasit apo familjes ardhëse në atë vendbanim.

Neni 18

Regjistrimi i vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë

1. Për shtetasit që:

a) kryejnë shërbimin ushtarak apo kryejnë detyra në Forcat e Armatosura dhe banojnë brenda

territorit të njësisë së Forcave të Armatosura;

b) kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor;

c) qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, me qëllim kurimin afatgjatë; dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

2. Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucion i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.

3. Kur përfundon qëndrimi i shtetasve në një nga institucionet e përcaktuara në këtë nen, institucioni përkatës njofton zyrën e gjendjes civile brenda juridiksionit të tij territorial, në lidhje me këtë fakt, brenda 5 ditëve. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon gjendjen civile.

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e njoftimit nga ana e institucioneve për kategoritë e shtetasve të përcaktuar në këtë nen.

Neni 19

Afati i deklarimit të ndryshimit të vendbanimit për arsye pune ose arsimimi

1. Shtetasit që për arsye të kryerjes së detyrave shtetërore apo për shkak punësimi janë të detyruar të jetojnë zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje apo për më shumë se gjashtë muaj, gjatë një viti kalendarik, në një vendbanim të ndryshëm me atë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile, janë të detyruar të deklarojnë vendbanimin e ri brenda 30 ditëve nga ardhja në atë vendbanim, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial vendbanimin e ri.

2. Rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për arsye arsimimi, kur ata ndjekin programe shkollore apo universitare në sistemin me shkëputje nga puna dhe kur programi i plotë akademik është më i gjatë se 1 vit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shtetasit që banojnë apo regjistrojnë vendbanimin e tyre brenda territorit të qarkut apo në rrethet fqinje me atë, në të cilin ndodhet adresa e institucionit arsimor, pavarësisht se nuk janë në të njëjtin qark.

Neni 20

Deklarimi i vendbanimit pranë punëdhënësit apo institucionit arsimor

1. Shtetasit që për arsye pune/arsimimi ndryshojnë vendbanimin, janë të detyruar të paraqesin

pranë institucionit shtetëror apo punëdhënësit, në çastin e fillimit të marrëdhënies së punës, ose pranë institucionit arsimor, në çastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik, një nga dokumentet që vërteton vendbanimin, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Në çdo rast, ky dokument duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i detyrës, marrëdhënies së punës ose paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik të studimeve. Në rast se regjistrimi në vitin akademik bëhet automatikisht dhe pa kërkesë, institucioni verifikon kushtet e parashikuara në këtë nen dhe, kur identifikon mangësi në dokumentacionin provues të vendbanimit, njofton brenda 5 ditëve shtetasin që ka detyrimin për deklarim, si dhe zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin arsimor.

2. Institucionet shtetërore dhe arsimore, si dhe punëdhënësit e përcaktuar në këtë nen, janë të detyruar të informojnë brenda 5 ditëve zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe që nuk kanë paraqitur ende dokumentin që vërteton vendbanimin.

3. Zyra e gjendjes civile, brenda 5 ditëve, në bashkëpunim me institucionin përkatës që ka bërë informimin, njofton me shkrim shtetasit, të cilët, për arsye pune apo arsimimi, janë vendosur me vendbanim në bashkinë/komunën në juridiksion të zyrës përkatëse të gjendjes civile, për detyrimin për regjistrim të vendbanimit dhe për sanksionet në rast mos-regjistrimi. Kur edhe pas kalimit të afatit për regjistrim, shtetasi nuk ka deklaruar vendbanimin e tij, zyra e gjendjes civile njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e komunikimit midis institucioneve apo punëdhënësve, subjekte të këtij neni, si dhe të njoftimit të shtetasve nga zyrat e gjendjes civile, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

Neni 21

Regjistrimi i vendbanimit të shtetasve të huaj dhe i personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë në zyrën e gjendjes civile vendbanimin e tyre, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit nga organi kompetent.

Zyra që mbulon shtetësinë dhe refugjatët njofton brenda 5 ditëve DPGJC-në për çdo akt të ri për këtë kategori shtetasish.

2. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim në Republikën e Shqipërisë, kur ndryshojnë vendbanim, janë të detyruar të njoftojnë zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të tyre brenda 30 ditëve nga ardhja në vendbanimin e ri.

Neni 22

Dokumentacioni për vërtetimin e vendbanimit dhe ndryshimit të tij

1. Zyra e Gjendjes Civile e regjistron deklarin e vendbanimit ose banesës për përdorim vetjak apo familjar të shtetasit kur ai paraqet dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose një kontratë apo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës.

2. Këshilli i Ministrave përcakton dokumentacionin e nevojshëm që vërteton vendbanimin apo

banesën për përdorim vetjak ose familjar të shtetasit, si dhe mënyrën e administrimit të këtij dokumentacioni nga zyra e gjendjes civile.

Neni 23

Çregjistrimi i personave që lënë shtetësinë shqiptare

Për shtetasit që, me dekret të Presidentit të Republikës, lënë shtetësinë shqiptare, DPGJC-ja u kërkon zyra të gjendjes civile, ku shtetasit kanë vendbanimin e tyre, që brenda 30 ditëve të bëjnë çregjistrimin e tyre nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Neni 24

E drejta e DPGJC-së të mbledhë të dhëna nga institucione të treta

1. DPGJC-ja ka të drejtë të ketë akses ose të kërkojë informacion, në mënyrë periodike apo rast pas rasti, nga institucione ose ente shtetërore e private të tjera që mbledhin dhe administrojnë baza të dhënash të shtetasve që përmbajnë të dhëna lidhur me adresën e personit apo të vendbanimit të tij.

2. Institucionet dhe entet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara që t'i sigurojnë akses të menjëhershëm e të papenguar DPGJC-së në bazat përkatëse të të dhënave, ose t'i dërgojnë asaj informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës.

3. DPGJC-ja i përdor të dhënat e siguruar në zbatim të këtij neni, për aq sa është e nevojshme për të verifikuar dhe siguruar saktësinë e të

dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Të dhënat e siguruara nga baza alternative të dhënash nuk përbëjnë burim të drejtpërdrejtë dhe të vetëm të dhënash, në lidhje me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. DPGJC-ja i përdor të dhënat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.

4. Këshilli i Ministrave përcakton llojin, sasinë, organizimin e informacionit dhe rregullat për marrjen dhe përpunimin e informacionit, sipas këtij neni.

KREU IV

NATYRA DHE DOKUMENTIMI I PËRBËRËSVE TË GJENDJES CIVILE

Neni 25

Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve

1. Përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, të shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, vërtetohen e dokumentohen në dokumentet bazë të gjendjes civile.

Këto dokumente hartohen nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga nëpunësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë, të ardhura nga të tretët, sipas ligjit.

2. Dokumentet bazë, që mban shërbimi i gjendjes civile, janë:

- a) akti i lindjes;
- b) akti i martesës;
- c) akti i vdekjes;
- ç) regjistrat themeltarë;
- d) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- dh) procesverbali/procesverbalet për ndryshim emri, mbiemri;
- e) procesverbali/procesverbalet për bashkim dhe veçim familjar.

3. Dokumentet bazë, që lëshon zyra e gjendjes civile, janë:

- a) letërnjoftimi;
- b) pasaporta;
- c) certifikata e lindjes;
- ç) certifikata martesore;
- d) certifikata e familjare;

dh) certifikata e vdekjes.

4. Forma, elementet përbërëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve bazë, që

mbahen dhe lëshohen nga shërbimi e gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26

Letërnjoftimi

1. Dokumenti bazë i përhershëm për identifikimin e shtetasve është letërnjoftimi.

2. Personat, të cilët, për efekt moshe, sipas ligjit, nuk përfitojnë letërnjoftim, pajisen nga zyra e gjendjes civile me certifikatën e lindjes me fotografi, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 27

Aktet për lindjet, martesat e vdekjet

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.

2. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

3. Aktet e lindjes, të martesës e të vdekjes, të mbajtura jashtë shtetit, në shërbimin diplomatik apo konsullor shqiptar, për shtetasit shqiptarë apo dhe për shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të

përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcillen nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda datës 20 janar të vitit pasardhës.

Neni 28

Nënshkrimi i akteve

1. Nëpunësi i gjendjes civile, i interesuari, si dhe të pranishmit, kur parashikohet nga ky ligj, nënshkruajnë me të njëjtin mjet, si dhe shënojnë emrin e mbiemrin. Nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, në çdo rast, shoqërohet me vulën e zyrës së gjendjes civile, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm.

2. Kur personi nuk di ose nuk është në gjendje fizike të nënshkruajë, në akt shënohen shkaqet, të vërtetuara me nënshkrim të veçantë të përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, të nëpunësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë, të pranishëm në veprim.

Neni 29

Dokumentet e tjera bazë

1. Dokumente të tjera janë aktet zyrtare, shtetërore ose joshtetërore, të cilat, sipas ligjit, vërtetojnë ose ndryshojnë faktet juridike, të vërtetuara me aktet e gjendjes civile. Përmbajtja e tyre, kurpasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, shndërrohet në përbërës të gjendjes civile të shtetasit.

2. Dokumentet e tjera bazë, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër, me karakter administrativ, plotësohen e administrohen, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse, sipas llojit të dokumentit.

Neni 30

Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara

1. Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara bëhen vetëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kopja e vendimit gjyqësor i bashkëlidhet dokumentit dhe çdo dokument i lëshuar në bazë të tij përmban elementet e përcaktuara në vendimin gjyqësor.

2. Korrigjimet, si gabime materiale, përcaktohen me rregullore nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh apo dokument bazë, të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të fletës familjare.

Neni 31

Detyrimet e organeve të tjera

Të gjitha organet, të cilat, në mbështetje të këtij ligji apo sipas një ligji të veçantë, janë përgjegjëse për caktimin, vërtetimin ose ndryshimin e një përbërësi të gjendjes civile, detyrohen të dërgojnë, zyrtarisht e drejtpërdrejt, një kopje të aktit, vendimit, në zyrën e gjendjes civile, ku personi figuron i regjistruar, brenda 15 ditëve nga data e lëshimit të aktit ose nga marrja e formës së prerë të vendimit.

Neni 32

Administrimi i dokumentacionit

1. Aktet mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjegjësi i gjendjes civile në degën e qarkut/përgjegjësi i gjendjes civile të Bashkisë së Tiranës rishikon saktësinë e veprimeve të kryera në aktet e lindjeve, të martesave e të vdekjeve dhe, në bashkëpunim me nëpunësin përkatës të zyrës së gjendjes civile, bën mbylljen e tyre. Pas verifikimit, aktet dorëzohen në arkivin e degës së gjendjes civile të qarkut, jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës dhe ruhen përgjithmonë.

2. Dokumentet, mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, vendosen në arkivin e zyrës së gjendjes civile, në njësinë e qeverisjes vendore, në muajin e parë të vitit pasardhës dhe ruhen për një periudhë 10-vjeçare.

3. Me krijimin e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, regjistrat themeltarë të shtetasve në bashki/njësi bashkiake/komuna dorëzohen në arkivin e degës së gjendjes civile në qark, sipas procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

4. Për administrimin e të gjithë dokumentacionit, shërbimi i gjendjes civile zbaton rregullat e përgjithshme për arkivat, për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

KREU V

REGJISTRI KOMBËTAR I GJENDJES CIVILE

Neni 33

Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile

1. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile është dokumenti unik shtetëror, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas shqiptar, për shtetasit e huaj dhe për personat pa shtetësi, kur kanë banim të përkohshëm/të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për shtetasit e huaj, të cilët kanë përfitur azil në Republikën e Shqipërisë.
2. Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Përditësimi i të dhënave të regjistrit bëhet nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.
3. Veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe në aktet e gjendjes civile bëhen me anë të teknikave informatike.
4. Mënyra e ngritjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe rregullat për shfrytëzimin e teknologjisë informatike që do të përdoren për këtë regjistër, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 34

Veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

Veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile kryhen vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe nga nëpunësi në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 35

Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

Përbërësit e gjendjes civile pasqyrohen në faqen individuale të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes

Civile për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe për shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 36

Plotësimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

Kur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

- a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;
- b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;
- c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.

Neni 37

Mungesa e së dhënës

1. Kur e dhëna, që kërkohet për aktin e lindjes dhe të vdekjes, është e pamjaftueshme ose nuk vërtetohet nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse pranë organit, që ka dijeni për faktin juridik, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji.
2. Me vërtetimin e së dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet plotësimi vetëm në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

KREU VI

REGJISTRIMI I AKTIT TË LINDJES

Neni 38

Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.
2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.
3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

Neni 39

Dokumentet bazë të personave të gjetur

1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.
2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit public dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.
3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinarë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjërisht të prindërve.
4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paaftë mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.
5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet

në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.

6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paaftë mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të pafidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.

Neni 40

Deklarimi i lindjes

1. Lindja e fëmijës deklarohet të nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

Neni 41

Regjistrimi i lindjes

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.

2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me

banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.

4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton

shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Fondi për shpërblimin e përmendur në pikën 4 të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe tërhiqet pranë bashkisë/njesisë bashkiake/komunës përkatëse.

6. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.

7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë.

Neni 42

Akti i lindjes

1. Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit.

2. Akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë dhe deklaruesi.

Ai përmban:

a) numrin rëndor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile;

b) datën e plotë dhe orën e lindjes;

c) vendin e lindjes;

ç) emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;

d) numrin e identitetit të fëmijës;

dh) gjininë;

e) kombësinë, në përputhje me kombësinë e prindërve;

ë) shtetësinë;

f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;

g) numrin e identitetit dhe identitetin e nënës;

gj) numrin e identitetit dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

h) identitetin, numrin e identitetit dhe cilësinë e deklaruesit;

i) numrin e identitetit, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

Neni 43

Vlefshmëria dhe kundërshtimi i aktit të lindjes

1. Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm.
2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.
3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrajnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.
4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 44

Ndryshimi i së dhënës së aktit të lindjes

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile mund të ndryshohet drejtpërdrejt nga nëpunësi i gjendjes civile në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, për emrin, mbiemrin dhe shtetësinë e përkohshme, ndërsa, me kërkesë të shtetasit përkatës, brenda 1 viti nga plotësimi i moshës madhore dhe pas kësaj me vendim gjykatë.

Neni 45

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

1. Në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme.
2. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm apo kombësia, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklarimit e nënshkrimit

të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

3. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuar, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykate.

4. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

KREU VII

REGJISTRIMI I AKTIT TË MARTESËS

Neni 46

Forma e aktit të martesës

1. Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

2. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet. Kur është e mundur, bëhet verifikimi i menjëhershëm dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen.

Neni 47

Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt.

2. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e hpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve.

3. Martesa e shtetasit të huaj ose e personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data që kërkohet të lidhet martesa, përveç rasteve kur ka mënyra dhe një afat tjetër, të përcaktuar në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.

4. Për të huajt, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ose janë refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi përkatës shqiptar ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi.

5. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile, me dëshirën e vet. Gjithashtu, martesa mund të lidhet kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të nxjerrë rregullat për veprimet, që do të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për dokumentacionin dhe procedurën që do të ndiqet.

Neni 48

Përmbajtja e aktit të martesës

Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm:

- a) zyra e gjendjes civile, ku kryhet akti i martesës;
- b) numri dhe data e mbajtjes së aktit të martesës;
- c) numri dhe data e shpalljes së martesës;
- ç) numri dhe data e vendimit të gjykatës;
- d) vendi i lidhjes së martesës dhe ora;
- dh) identiteti, numri i identitetit të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm;
- e) vendbanimi /vendqëndrimi para martesës;
- ë) vendbanimi pas martesës;
- f) mbiemri që do të mbajë pas lidhjes së martesës secili nga bashkëshortët;
- g) njohja e atësisë ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve, të lindur para martesës;

- gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve;
- h) numri identitetit, emri, mbiemri dhe vendbanimi i dëshmitarëve;
- i) numri i identitetit, emri, mbiemri i përkthyesit;
- j) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 49

Vërtetimi i martesës

Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të nëpunësit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve.

Neni 50

Veprimet me aktin e martesës

Akti i martesës pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëpunësi i gjendjes civile, që mban aktin e martesës, bën përditësimin e të dhënave për bashkëshortët e ardhshëm, në faqen përkatëse.

KREU VIII

REGJISTRIMI I AKTIT TË VDEKJES

Neni 51

Akti i vdekjes

1. Akti i vdekjes vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit.
 2. Akti i vdekjes është procesverbali, që mbahet për çdo të vdekur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi.
- Ai përmban:
- a) zyrën e gjendjes civile, ku mbahet akti i vdekjes;
 - b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;
 - c) vendin e vdekjes dhe orën;
 - ç) shkakun e vdekjes, sipas raportit mjekësor;
 - d) identitetin dhe numrin e identitetit të të vdekurit, ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura e pa identitet;

- dh) numrin e identitetit, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit ligjor, që ka lëshuar raportin;
- e) numrin e identitetit, emrin, mbiemrin e deklaruesit;
- ë) numrin e datën e shkresës së prokurorisë, që ka autorizuar veprimin për rastet e përcaktuara në këtë ligj;
- g) emrin, mbiemrin e nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 52

Deklarimi i vdekjes

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar madhor i familjes ose nga personat më të afërt të familjes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë/komunës, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi ka vendbanimin/vendqëndrimin ose ku është gjetur kufoma.
2. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor.
3. Deklarimi i vdekjes bëhet brenda 10 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.
4. Drejtuesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre.
5. Kur vdekja ndodh ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.
6. Me deklarin e vdekjes, zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit.
7. Në fshatra, në juridiksionin e komunave, që nuk kanë zyrë të gjendjes civile, lejen për varrimin e jep kryeplaku i fshatit. Në këtë rast, kryeplaku, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.
8. Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas pikës 4 të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit

vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit vendor, kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.

9. Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në regjistrin themeltar dhe në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mund të ngrejë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen, pasi të ketë shfrytëzuar të gjithë procedurën administrative.

10. DPGJC-ja është detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile listën e shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe për çdo datë 5 të muajit pasardhës shpërndan listën, sipas zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile, në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor, bën verifikimin rast pas rasti, sipas procedurës së miratuar nga ministri që mbulon gjendjen civile.

Neni 53

Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

1. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen

identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij.

Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin

faktik, në rrugë gjyqësore, sipas Kodit Civil.

2. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.

3. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale.

4. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes.

5. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

Neni 54

Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është nënshkruar edhe nga prokurori.

Neni 55

Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

1. Akti i vdekjes është absolutisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër.

2. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt.

3. Akti i vdekjes shpallet relativisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit, për sa i përket kohës, shkaktit e vendit të vdekjes.

4. Pavlefshmëria, sipas pikës 1 të këtij neni, konstatohet nga gjykata, pas kërkesës së paraqitur, në çdo kohë, nga personi, për të cilin është mbajtur akti i vdekjes. Kur personi është i mitur, i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar ose nuk është në gjendje mendore apo fizike, këtë të drejtë e kanë përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e tij dhe, kur nuk ka të tillë apo kur kjo e drejtë nuk ushtrohet prej tyre, të drejtën e ka edhe prokurori.

5. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, përveç personit, që rezulton i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasoja juridike nga mungesa e aktit të të vdekurit në fakt. Kur këta janë të mitur, u është

hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore apo fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor apo kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori.

6. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi, që rezulton i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht.

7. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por, në çdo rast, duke mbajtur një akt tjetër vdekjeje.

8. Personat, që e kanë përbërës emrin ose mbiemrin, por që janë familje më vete, bëjnë ndryshimin me kërkesën e tyre, me procesverbal të veçantë, ndërsa në rastet e papërshtatshmërisë, janë të detyruar ta pasqyrojnë ndryshimin brenda 1 muaji nga marrja dijeni.

9. Përveç ndryshimeve të mësipërme, emrit dhe mbiemrit mund t'i bëhen përmirësime dhe korrigjime, që lidhen me ndryshime e saktësime të shkronjave të veçanta. Këto ndryshime bëhen në bazë të kërkesës së personit të interesuar, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

KREU X

KOMBËSIA DHE GJENDJA CIVILE E SHTETASVE TË HUAJ DHE E PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 58

Kombësia

1. Fëmija merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë, të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur, sipas ligjit, vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve, ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndryshimin e atësisë apo të amësisë. Ndryshimi i kombësisë, në çdo rast, bëhet me vendim gjyqësor.

2. Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, fëmijës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ose në rast vdekjeje të njërit prej tyre, shërbimi i

gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të fëmijës atë të të atit. Kombësia e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës madhor.

3. Fëmija e lindur jashtë martese, kur nuk dihet atësia, merr kombësinë e nënës. Kjo kombësi mund të ndryshojë me vërtetimin e atësisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

4. Fëmija me prindër të panjohur, i lindur në Shqipëri, prezumohet me kombësi shqiptare. Kur njëri ose të dy prindërit gjenden ose kur fëmija arrin moshën madhore, për kombësinë e tij zbatohen përcaktimet e pikës 2 të këtij neni.

5. I birësuari merr kombësinë e birësuesve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, por kur ai arrin në moshë madhore, ka të drejtë të rimarrë kombësinë që kishte para birësimit, ose ta ndryshojë atë, sipas kombësisë që kanë prindërit biologjikë.

6. I linduri me fekondim artificial nga një grua e martuar merr kombësinë e njërit prej bashkëshortëve, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

7. Ndryshimi i kombësisë bëhet në rastet e përcaktuara në këtë ligj vetëm me vendim gjyqësor, duke u thirrur, në çdo rast, si palë në proces shërbimi i gjendjes civile, edhe kur kombësia ka qenë caktuar përkohësisht ose kur është bërë një gabim material.

8. Ndryshimi i kombësisë shqiptare të shtetasve shqiptarë nga organe të huaja është absolutisht i pavlefshëm.

Neni 59

Gjendja civile e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe shtetasit e huaj, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të gjitha të drejtat, sipas këtij ligji, me përjashtim të të drejtave, që lidhen ngushtë me shtetësinë shqiptare dhe të veçorive në mënyrën e dokumentimit.

2. Gjendja civile e shtetasit të huaj me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në dokumentet

e shtetit përkatës, ndërsa ajo e personit pa shtetësi, në dokumentet e shtetit ku ka lindur ose prej nga ka ardhur. Gjendja civile e shtetasit të huaj, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë vërtetohet nga të dhënat, që ka organi përkatës administrativ për refugjatët.

3. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/ të përhershëm, vizitorë ose që janë tranzit në Shqipëri, kanë të drejtë që, nëpërmjet shërbimit të gjendjes civile, të evidentojnë dhe të vërtetojnë faktet juridike të tyre, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, sikurse çdo shtetas shqiptar, përveçse kur ka pengesë ose një procedurë të veçantë, të përcaktuar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare.

KREU XI

SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 60

Natyra dhe funksioni

1. Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shërbimi i gjendjes civile u jep të dhëna marrësve, sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 61

Organizimi i shërbimit të gjendjes civile

1. Shërbimi i gjendjes civile është i organizuar si më poshtë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) degët e gjendjes civile në qark;
- c) zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake ose komuna.

2. Pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare funksionon

shërbimi i gjendjes civile, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 62

Struktura dhe organika

Struktura, organika dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e gjendjes civile në qark përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63

Buxheti

1. Të ardhurat që sigurohen nga shërbimi i gjendjes civile duhet të përdoren në përputhje me aktet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë përdorimin dhe administrimin e të ardhurave që krijohen nga institucionet buxhetore.

2. Buxheti i shërbimit të gjendjes civile është program më vete, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Brendshme.

3. Bashkitë, njësitë bashkiake dhe komunat, në përputhje me objektivin e tyre, mund të parashikojnë dhe kryejnë shpenzime, operative ose kapitale, shtesë, për përmirësimin e shërbimit të zyrës së gjendjes civile.

Neni 64

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 65

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen këto detyra:

- a) I propozon ministrit projektaktet në zbatim të ligjit.
- b) Harton dhe i propozon për miratim ministrit treguesit e cilësisë

së shërbimit, metodikat dhe rregulloret për funksionimin e zyrave të shërbimit të gjendjes civile.

c) Administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Regjistrin Kombëtar të Adreseve.

ç) Harton programe dhe merr masa për zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit të gjendjes civile.

d) Bën drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut, bashki, komuna dhe njësitë bashkiake, si dhe në përfaqësitë diplomatike e konsullore.

dh) Bashkëpunon me institucione dhe donatorë të interesuar për problemet e shërbimit të gjendjes civile dhe i paraqet ministrit për miratim projekt marrëveshje, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim.

e) Merr masa, harton dhe zbaton programe për kualifikimin dhe rekrutimin e nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.

ë) Propozon modelet e dokumenteve që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile, si dhe programet kompjuterike që përdor ky shërbim.

f) Vendos kriteret profesionale që duhen plotësuar nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për pranimin e tyre në këtë shërbim.

g) Kur vëren shkelje, i propozon kryetarit të bashkisë/njësisë bashkiake /komunës dhe prefektit të qarkut masa administrative për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Masat e propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile janë të detyrueshme për zbatim nga kryetarët dhe prefekti i qarkut.

gj) Zgjidh konfliktet për veprimet apo mosveprimet e zyrave të gjendjes civile, në ushtrim të funksioneve të tyre.

Neni 66

Degët e gjendjes civile në qark

1. Shërbimi i gjendjes civile i ushtron funksionet edhe në degët e qarkut.
2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të gjendjes civile në degët e qarkut bëhet nga prefekti, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, sipas kriterëve të përcaktuara më parë nga Drejtoria e Përgjithshme

e Gjendjes Civile.

3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të gjendjes civile të degës së qarkut bëhet nga prefekti, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 67

Detyrat e degëve të gjendjes civile në qark

Degët e gjendjes civile në qark kanë këto detyra:

- a) zbatojnë metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administrojnë arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile, në shkallë rrethi;
- c) lëshojnë certifikata të shërbimit të gjendjes civile, për dokumentet që administrojnë vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u japin të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranojnë dhe shpërndajnë në zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna njoftimet, që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollojnë veprimtarinë e zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna dhe u propozojnë organeve përkatëse marrjen e masave të nevojshme;
- e) raportojnë para prefektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e degës së qarkut dhe të zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna.

Neni 68

Zyrat e gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake ose komuna

- 1. Shërbimi i gjendjes civile ushtron funksionet në bashki/njësi bashkiake/komuna.
- 2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- 3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 69

Detyrat e zyrave të gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake ose komuna

Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna kanë këto detyra:

- a) përditësojnë Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- b) mbajnë aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;
- c) lëshojnë dokumentin e identitetit, certifikatat e lindjes, ato familjare, të martesës dhe të vdekjes, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- ç) kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi;
- d) plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve të interesuara;
- dh) vënë në dijeni këshillin dhe kryetarin e bashkisë/njesisë bashkiake/komunës, si dhe degën e gjendjes civile në qark, për veprimtarinë e zyrës së gjendjes civile, sipas kërkesës ose periodikisht, në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- e) plotësojnë të gjitha detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 70

Detyrat e zyrës së gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës

Zyra e gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës ka këto detyra:

- a) zbaton metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administron arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile të njësive bashkiake të Tiranës;
- c) lëshon certifikata të shërbimit të gjendjes civile për dokumentet që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrave të gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u jep të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranon dhe shpërndan, në zyrat e gjendjes civile të njësive bashkiake të Tiranës, njoftimet që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollon veprimtarinë, që kryejnë zyrat e gjendjes civile në njësitë

bashkiake dhe u propozon organeve përgjegjëse marrjen e masave të nevojshme;

e) raporton para kryetarit të bashkisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e zyrës në bashki dhe të zyrave të gjendjes civile në njësitë bashkiake.

Neni 71

Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Veprimet, të cilat kryhen nga nëpunësit e shërbimit konsullor, që mbulojnë çështjet e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare, duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara nga ligji në fuqi. Këta nëpunës, përpara fillimit të punës, duhet të trajnohen si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Ata administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, që janë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

Neni 72

Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile

Të drejtat dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve në regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i kanë vetëm nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, ndërsa për përfaqësitë diplomatike e konsullore, vetëm nëpunësit e trajnuar për këtë qëllim.

Neni 73

Tarifat e shërbimit të gjendjes civile

Shërbimet, që kryhen nga zyrat e gjendjes civile, kryhen me pagesë nga kërkuesi, marrësi ose deklaruesi, sipas tarifave të miratuara nga legjislati në fuqi.

Neni 74

Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose moszbatimi i dispozitave të parashikuara në nenin 15 pika 3, në nenin 19 pikat 1 e 2, në nenin 20 pika 1, në nenin 21 pikat 1 e 2, në nenin 41 pika 6 dhe në nenin 52 pikat 3, 5 dhe 7 dënohet me gjobë në masën 3 000 lekë dhe me pezullim të shërbimit deri në vjeljen e gjobës, të cilën e vendos dhe e vjel nëpunësi i gjendjes civile.

Gjoba e vendosur nga nëpunësi i gjendjes civile mund të ankimohet brenda 10 ditëve te prefekti i qarkut, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të ankesës;

b) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në nenin 18 pikat 2 e 3, në nenin 20 pikat 1 e 2, në nenin 41 pika 6 dhe në nenin 52 pika 4 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

c) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në nenin 65 shkronja "dh", në nenin 66 pikat 2 dhe 3 dhe në nenin 68 pika 2 dhe 3 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

2. Gjocat e parashikuara në shkronjat "b" dhe "c" të këtij neni vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, sipas njoftimit të ardhur nga zyrat e gjendjes civile. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në institucionin e ministrit që mbulon gjendjen civile, i cili brenda 10 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

3. Masat administrative të gjobës, të cilat nuk ankimohen brenda afatit, si dhe ato të cilat lihen në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat përmbarimore për ekzekutimin e tyre.

KREU XII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75 **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 76 **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për gjendjen civile që të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 15 pika 4, 18 pikat 3 dhe 4, 20 pika 4, 22 pika 2, 24 pika 4, 25, 33, 52 pika 10, 62 dhe 63 të këtij ligji.

Neni 77 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6180, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr. 8951, datë 10.10.2003

“PËR NUMRIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i ligjit është përcaktimi i kuptimit, mënyrës së formimit dhe sferës së përdorimit të numrit të identitetit, si një nga përbërësit e veçantë të gjendjes civile, i cili përcakton dhe shërben për identifikimin e shtetasve shqiptare, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

1. Numri i identitetit është unik dhe vendoset nga shërbimi i gjendjes civile. Ai përbehet nga dhjetë elementë me informacion të koduar dhe ka strukturën e mëposhtme:

Elementi 1-2	viti i lindjes
Elementi 3-4	muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6	data e lindjes
Elementi 7 -9	numri serial brenda se njëjtës datë
Elementi 10	element kontrolli.

2. Numri i identitetit lëshohet nga shërbimi i gjendjes civile.

Neni 3

Numri i identitetit shërben:

1. Për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Për dokumentin e identitetit.
3. Si numër i sigurimit shoqëror për të identifikuar, regjistruar dhe për të kërkuar përfitime nga sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe për programet e tjera të mbrojtjes shoqërore.
4. Për Regjistrin Kombëtar të Zgjedhjeve.
5. Për sistemin tatimor.
6. Për dëshminë e aftësisë së drejtimit të automjeteve.
7. Për nevojat e organeve dhe të institucioneve të tjera shtetërore, si organeve të drejtësisë, të rendit, të prokurorisë, të mbrojtjes, të arsimit dhe të Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë.

Neni 4

Mënyra e kodimit të numrit të identitetit, masat dhe detyrat e organeve shtetërore për pajisjen e shtetasve me numër identiteti, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 1, nenet 2, 3, 6, 7, si dhe paragrafi i tretë i nenit 13 të ligjit nr. 7845, datë 13.7.1994 "Për numrin e sigurimit shoqëror", shfuqizohen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 12 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3541, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

LIGJ

Nr. 8952, datë 10.10.2002

“PËR DOKUMENTIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave;

KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Ky ligj përcakton dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptare, me qellim pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptare, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një dokument identifikues unik, kriteret për lëshimin e tij, si dhe përmbajtjen e këtij dokumenti.

Neni 2

1. Dokumenti i identitetit të personave është dokumenti bazë, i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptare. Ky dokument lëshohet nga zyra e gjendjes civile, në regjistrin themeltar të së cilës është regjistruar shtetasi.
2. Çdo shtetas duhet të mbajë me vete dokumentin e identitetit.

Neni 3

1. Për pajisjen me dokument identiteti shtetasi duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
 - a) të jetë i regjistruar në regjistrin themeltar dhe të jetë banor i njësisë vendore, që ka në juridiksion zyra e gjendjes civile, e cila e lëshon këtë dokument;
 - b) të ketë mbushur moshën 16 vjeç.

2. Çdo shtetas që plotëson kushtet e mësipërme është i detyruar të pajiset me dokument identiteti, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Dokumenti i identitetit mund të lëshohet me ose pa afat.

Dokumenti i identitetit lëshohet me afat për shtetasit me moshe nga 16 deri në 30 vjeç. Pavarësisht nga kjo, dokumenti i identitetit ka afat të paktën 5 vjet nga data e lëshimit. Dokumenti i identitetit lëshohet pa afat për shtetasit mbi 30 vjeç.

Neni 5

Shtetasi pajiset me dokument të ri identiteti kur:

- a) plotëson kushtet e nenit 3 pika 1 të këtij ligji;
- b) njeri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në dokumentin e identitetit, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) vërtetohet nga organet përkatëse se dokumenti i identitetit i ka humbur ose i është vjedhur

Neni 6

Dokumenti i identitetit është një kartë plastike, në të cilën janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda informatike:

- a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, emri, mbiemri, atësia, amësia, datëlindja dhe vendlindja;
- b) fotografia e shtetasit, mbajtës i këtij dokumenti;
- c) numri i identitetit të shtetasit;
- ç) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;
- d) elemente sigurie brenda normave të Komunitetit Evropian, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Shkelja e afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji përben

kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobe në masën 5 000 lekë.
Të drejtën për vendosjen e gjobës e ka shërbimi i gjendjes civile.

2. Mënyra e vendosjes së gjobës dhe ankimi në gjykatë bëhen sipas ligjit nr. 7697, date 7.4.1993 “Për kundravajtjet administrative ” i ndryshuar .

Neni 8

Forma, modeli i dokumentit të identitetit dhe mënyra e shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ligji nr. 4172, date 13.9.1966 “Mbi pajisjen e shtetasve me letërnjoftim,” ndryshuar me ligjet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3542, date 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu

LIGJ

Nr. 9062, 8.5.2003

KODI I FAMILJES

Në mbështetje të neneve 53, 54, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

Neni 2

Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 3

Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

Neni 4

Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesa.

Neni 5

Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

Neni 6

Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohet, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij.

Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim tepër të motivuar. I mituri mund të dëgjohet vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij.

Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale.

PJESA E DYTË

BASHKËSHORTËT

TITULLI I

MARTESA

KREU I

KUSHTET THELBËSORE PËR LIDHJEN E MARTESËS

Neni 7

Mosha e lidhjes së martesës

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe.

Neni 8

Pëlqimi i bashkëshortëve

Martesa lidhet para nëpunësit të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm.

Neni 9

Ndalimet për lidhjen e martesës

Nuk mund të lidhë martesë të re personi që është martuar, derisa martesa e mëparshme nuk është shpallur e pavlefshme ose nuk është zgjidhur.

Neni 10

Nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungji dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave.

Gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave.

Neni 11

Nuk mund të lidhin martesë midis tyre vjehri dhe nusja, vjehra dhe dhëndri, njerku dhe thjeshtira, njerka dhe thjeshtri, pavarësisht se martesë që ka krijuar këtë lidhje është shpallur e pavlefshme, ka pushuar ose është zgjidhur.

Neni 12

Nuk mund të lidhë martesë personi që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të pa aftë të kuptojë qëllimin e martesës.

Neni 13

Ndalohet martesë midis kujdestarit dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria.

Neni 14

Ndalohet martesë midis birësuesit e të birësuarit dhe pasardhësve të tyre, të birësuarit dhe bashkëshortit të birësuesit, midis birësuesit e bashkëshortit të të birësuarit, midis të birësuarve, si dhe midis të birësuarit dhe fëmijëve të birësuesit.

Me birësimin nuk zhduket shkak që ndalon martesën midis të birësuarit dhe gjinisë së tij të parashikuar nga neni 10 i këtij Kodi.

KREU II

FORMA E LIDHJES SË MARTESËS

Neni 15

Shpallja e martesës

Përpara lidhjes së martesës, nëpunësi i gjendjes civile bën shpalljen e saj, duke afishuar në vende të caktuara nga bashkia ose komuna

aktin, ku tregohet identiteti, profesioni, vendbanimi dhe vendqëndrimi i bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe vendi ku do të lidhet martesë.

Neni 16

Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme.

Shpallja bëhet në bashkinë ose komunën e vendit ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

Nëse nuk kanë jetuar 6 muaj në vendbanimin ose vendqëndrimin aktual, shpallja duhet të bëhet edhe në bashkinë ose komunën ku bashkëshorti ka jetuar më parë.

Neni 17

Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes.

Në qoftë se shpallja ndërpritet përpara mbarimit të këtij afati, ky fakt duhet të përmendet në shpalljen e re.

Neni 18

Në qoftë se lidhja e martesës nuk është bërë brenda 1 viti nga shpallja, martesë nuk mund të lidhet pa u bërë shpallja e re e parashikuar në dispozitat për shpalljen e martesës.

Neni 19

Personi që kërkon shpalljen duhet t'i paraqesë nëpunësit të gjendjes civile certifikatat e lindjes së të dy bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe çdo dokument tjetër që është i nevojshëm dhe provon se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës.

Neni 20

Kundërshtimet e lidhjes së martesës

Prindërit dhe, në mungesë të tyre, paraardhësit e tjerë dhe të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallë të tretë, mund të kundërshtojnë lidhjen e martesës së të afërmeve të tyre për çdo shkak që vjen në kundërshtim me kushtet e parashikuara në këtë Kod për lidhjen e martesës.

E drejta e kundërshtimit i takon edhe bashkëshortit të personit që do të lidhë një martesë tjetër, si dhe kujdestarit, nëse njëri prej bashkëshortëve është vënë në kujdestari.

E drejta e kundërshtimit të martesës i takon edhe prokurorit për shkaqet që parashikohen në ligj, për të cilat ai mund të kërkojë pavlefshmërinë e saj.

Neni 21

Kundërshtimi i lidhjes së martesës bëhet para nëpunësit të gjendjes civile ku do të lidhet martesa, i cili është i detyruar të bëjë shënimet përkatëse në regjistrin e martesave.

Nëpunësi i gjendjes civile është i detyruar që të bëjë shënimin e heqjes së kundërshtimit në regjistrin e martesave kur:

- a) vlerëson se kundërshtimi nuk është bërë në përputhje me dispozitat e këtij Kodi;
- b) për këtë ka një vendim gjyqësor;
- c) hiqet dorë nga kundërshtimi.

Heqja dorë nga kundërshtimi nuk pengon nëpunësin e gjendjes civile të refuzojë lidhjen e martesës për shkaqet e parashikuara në këtë Kod.

Neni 22

Akti i kundërshtimit duhet të përmbajë cilësinë që i jep të drejtën kundërshtuesit të bëjë kundërshtimin, vendin ku martesa duhet të lidhet, shkaqet e kundërshtimit dhe dispozitën ligjore ku mbështetet ai.

Neni 23

Kur nëpunësi i gjendjes civile vlerëson se kundërshtimi është bërë në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, pezullon procedurën e lidhjes së martesës derisa gjykata të vendosë refuzimin e kundërshtimit ose të hiqet dorë prej tij.

Kundër vendimit të pezullimit, bashkëshortët e ardhshëm kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të pezullimit.

Neni 24

Akti i kundërshtimit të lidhjes së martesës nuk ka efekt pas kalimit të 1 viti nga data e regjistrimit të kundërshtimit.

Neni 25

Gjykata kompetente, me kërkesë të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, vendos për heqjen ose jo të kundërshtimit të bërë për lidhjen e martesës.

Neni 26

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë mund të ankimohet në gjykatën e apelit, e cila duhet të vendosë brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të çështjes.

Neni 27

Në qoftë se kundërshtimi nuk pranohet, kundërshtuesit, me përjashtim të paraardhësve, mund të detyrohen me dëmshpërblim, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

Neni 28

Lidhja e martesës

Martesa lidhet publikisht përpara nëpunësit të gjendjes civile, të cilit i është bërë kërkesa për shpallje.

Neni 29

Me kërkesë të prokurorit të vendit ku lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm, gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të vendosë që martesa të lidhet edhe pa u shpallur.

Neni 30

Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës, nëpunësi i gjendjes civile, pasi bindet për identitetin e bashkëshortëve të ardhshëm, në bazë të akteve dhe të thënieve të dëshmitarëve, si dhe të vetë bashkëshortëve të ardhshëm, në prani të dy dëshmitarëve, u lexon bashkëshortëve të ardhshëm nenet e këtij Kodi që përmbajnë të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, merr nga secili bashkëshort deklarin se ata duan të lidhin martesë dhe, pasi merr pëlqimin e tyre, i shpall në emër të ligjit të martuar.

Akti i martesës hartohet menjëherë, nënshkruhet nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nëpunësi i gjendjes civile dhe regjistrohet në regjistrin e martesave.

Neni 31

Në qoftë se njëri nga bashkëshortët, për shkak të sëmundjes ose për ndonjë pengesë tjetër të justifikuar përpara nëpunësit të gjendjes civile, është në pamundësi për të shkuar në zyrën e gjendjes civile të komunës ose bashkisë, atëherë nëpunësi i gjendjes civile shkon në vendin ku ndodhet bashkëshorti që ka pengesë dhe lidh martesën, sipas procedurës së parashikuar në nenin 30 të këtij Kodi.

Neni 32

Refuzimi i lidhjes së martesës

Nëpunësi i gjendjes civile mund të refuzojë lidhjen e martesës vetëm për shkaqe të parashikuara në këtë Kod. Në këtë rast ai mund të lëshojë një akt ku të tregohen shkaqet e refuzimit.

Kundër aktit të refuzimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

KREU III

PAVLEFSHMËRIA E MARTESËS

Neni 33

Shkaqet e pavlefshmërisë

Martesa që është lidhur pa pëlqimin e lirë dhe pa vese të të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre është e pavlefshme.

Neni 34

Martesa e lidhur në lajthim për personin e bashkëshortit shpallet e pavlefshme.

Ka lajthim për personin, kur njëri nga bashkëshortët lidh martesë me një person që nuk është ai me të cilin dëshiron të martohet.

Shpallet e pavlefshme martesa e lidhur në lajthim për cilësitë thelbësore të bashkëshortit, të cilat po t'i dinte bashkëshorti tjetër, nuk do të lidhte martesën.

Neni 35

Martesa e lidhur nga një person që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës, është e pavlefshme.

Neni 36

Martesa e lidhur nga bashkëshortët pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua është e pavlefshme.

Neni 37

Martesa e lidhur në kushtet kur njëri nga bashkëshortët gjendet në ndikimin e një kanosjeje, pa të cilën nuk do të lidhej martesa, shpallet e pavlefshme.

Neni 38

Kërkesa për pavlefshmërinë e martesës, në rastet e parashikuara në nenet 34 dhe 37 të këtij Kodi, parashkruhet kur ka pasur një bashkëjetesë të vazhdueshme për 6 muaj që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë ose nga çasti që gjendja e kanosjes ka mbaruar dhe ai ka marrë dijeni për lajthimin.

Neni 39

Martesa e lidhur nga personi që nuk ka mbushur moshën e parashikuar në këtë Kod është e pavlefshme.

Një martesë e tillë nuk shpallet e pavlefshme kur personi ka arritur moshën e kërkuar, ose kur gruaja ka lindur fëmijë ose ka mbetur shtatzënë.

Neni 40

Martesa e lidhur midis personave që përmenden në nenet 9, 10, 11, 13 dhe 14 të këtij Kodi është e pavlefshme.

Gjykata nuk shpall të pavlefshme martesën e lidhur midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave, kur çmon se ka shkaqe me rëndësi.

Neni 41

Martesa e lidhur gjatë vazhdimit të një martesë të mëparshme të njërit

prej bashkëshortëve është e pavlefshme.

Kur gjatë gjykimit për pavlefshmërinë e martesës, bashkëshortët pretendojnë se martesa e mëparshme ka qenë e pavlefshme ose e zgjidhur, gjykohet më parë vlefshmëria ose ekzistenca e martesës së mëparshme dhe, në qoftë se kjo martesë shpallet e pavlefshme, martesa e dytë mbetet e vlefshme.

Martesa e dytë, e lidhur gjatë vazhdimit të martesës së mëparshme të njërit prej bashkëshortëve, nuk shpallet e pavlefshme, në qoftë se në këtë kohë zgjidhet martesa e mëparshme.

Neni 42

Martesa që nuk është lidhur publikisht dhe përpara nëpunësit të gjendjes civile është e pavlefshme.

Kërkesa mund të bëhet nga bashkëshortët, nga prindërit e tyre, nga të paralindurit dhe nga të gjithë ata që kanë një interes të drejtpërdrejtë, si dhe nga prokurori.

Neni 43

Bashkëshorti, në dëm të të cilit është lidhur një martesë e dytë, mund të kërkojë pavlefshmërinë e kësaj martese.

Në qoftë se bashkëshortët nga martesa e dytë pretendojnë pavlefshmërinë e martesës së parë, pavlefshmëria e martesës së parë do të gjykohet paraprakisht.

Neni 44

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur pa pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre e kanë të dy bashkëshortët ose bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk ka qenë i lirë.

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur me kanosje ose me lajthim e ka vetëm bashkëshorti që ka qenë i kanosur ose në lajthim.

E drejta e padisë parashkruhet, në qoftë se nga data që ka pushuar kanosja, që është zbuluar lajthimi ose bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë

në rast të martesës pa pëlqim të lirë, kanë kaluar 6 muaj, por në çdo rast jo më tepër se 3 vjet nga lidhja e martesës.

E drejta e padisë, në rastet kur ka pasur një bashkëjetesë të vazhdueshme për 6 muaj që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë ose nga çasti që ai ka marrë dijeni për lajthimin, parashkruhet me kalimin e këtij afati.

Neni 45

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës për shkaqet e parashikuara në nenet 36, 39, 40 dhe 41 të këtij Kodi e kanë secili nga bashkëshortët, prokurori dhe kushdo tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës.

E drejta e padisë për pavlefshmërinë e martesës nuk parashkruhet, përveç rasteve të parashikuara në nenet 44 dhe 46 të këtij Kodi.

Neni 46

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës, për shkaqet e parashikuara në nenin 35, pas shërimit të bashkëshortit të sëmurë, e ka secili nga bashkëshortët.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 6 muajve nga shërimi i bashkëshortit.

Neni 47

Kur bashkëshortit i është hequr zotësia për të vepruar, padia për pavlefshmërinë e martesës mund të ngrihet nga kujdestari i tij.

Neni 48

E drejta e padisë për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës nuk u kalon trashëgimtarëve, përveçse kur gjykimi ka filluar përpara vdekjes së bashkëshortit.

E drejta e trashëgimtarëve kufizohet vetëm për rastet që prekin rendin

publik dhe jo për raste që kanë të bëjnë thjesht me mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortëve, si lajthimi e kërcënimi.

Neni 49

Pasojat e pavlefshmërisë

Martesa që shpallet e pavlefshme me vendim të formës së prerë konsiderohet se nuk është lidhur.

Për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pasojat fillojnë nga data që vendimi merr formë të prerë.

Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme, quhen si të lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen si në rastet kur zgjidhet martesa.

TITULLI II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET QË LINDIN NGA MARTESA

KREU I

TË DREJTAT DHE DETYRIMET RECIPROKE TË BASHKËSHORTËVE

Neni 50

Detyrimi për besnikëri, ndihmë dhe bashkëpunim

Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime.

Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës.

Neni 51

Mbiemri i bashkëshortit

Bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet.

Mbiemri regjistrohet në regjistrin e martesave.

Neni 52

Mbiemri i fëmijëve

Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Kur prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që do të vendosin prindërit me marrëveshje. Kur marrëveshja nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit.

Neni 53

Detyrimi ndaj fëmijëve

Martesa vendos mbi të dy bashkëshortët detyrimin për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e fëmijëve.

Neni 54

Kontributi i bashkëshortëve

Në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesa nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre.

Neni 55

Vendbanimi i bashkëshortëve

Bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët.

Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët.

Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës, e cila, pasi dëgjon mendimet e të dy bashkëshortëve dhe, nëse është rasti, edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mundohet të arrijë një zgjidhje me mirëkuptim.

Kur kjo nuk është e mundur, gjykata vendos zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për kërkesat e familjes.

Neni 56

Largimi nga vendbanimi

E drejta për ndihmë morale dhe materiale e parashikuar në këtë Kod ndërpritet kundrejt bashkëshortit, që është larguar pa shkak nga vendbanimi familjar dhe refuzon të kthehet.

Në rast të mospërmbylljes së detyrimeve që rrjedhin nga martesë, gjykata, sipas rrethanave, mund të urdhërojë sekuestrimin e të mirave të bashkëshortit të larguar, në masën e duhur.

Neni 57

Pëlqimi i bashkëshortit

Bashkëshortët nuk mund të disponojnë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e tjetrit, cilito qoftë regjimi pasuror martesor.

Bashkëshorti që nuk ka dhënë pëlqimin për veprimin juridik të kryer nga tjetri, lidhur me banesën bashkëshortore, mund të kërkojë anulimin e tij brenda 1 viti nga data kur ai ka marrë njoftim për këtë veprim juridik, por jo më tepër se 1 vit nga data që regjimi pasuror martesor ka marrë fund.

Neni 58

Autorizimi i gjykatës

Çdo bashkëshort mund të autorizohet nga gjykata për të kryer një veprim juridik, për të cilin bashkëpunimi ose pëlqimi i bashkëshortit tjetër do të ishte i nevojshëm, në qoftë se ky i fundit nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose në qoftë se refuzimi i tij vjen në kundërshtim me interesin e familjes.

Veprimi juridik i kryer si më sipër, mund të kundërshtohet nga bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk është marrë, për të mos e ngarkuar atë me asnjë detyrim.

Neni 59

Autorizimi i përfaqësimit

Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, bashkëshorti tjetër mund ta përfaqësojë në të gjitha veprimet juridike ose në veprime juridike të caktuara që lidhen me regjimin pasuror martesor. Kushtet dhe gjerësia e përfaqësimit përcaktohen në autorizimin e dhënë nga gjykata.

Neni 60

Veprime pa pëlqimin e bashkëshortit

Secili nga bashkëshortët mund të kryejë vetë, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, veprimet juridike që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes ose me edukimin e fëmijëve. Për detyrimet e marra përsipër nga njëri bashkëshort, detyrohet solidarisht edhe bashkëshorti tjetër.

Përgjegjësia solidare nuk ka vend për shpenzimet haptazi të tepërta, duke pasur parasysh mënyrën e jetesës në familje, dobishmërinë e veprimit të kryer, si dhe mirëbesimin ose keqbesimin e personave të tretë kontraktues.

Neni 61

Masat urgjente

Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes, gjykata, me kërkesën e bashkëshortit tjetër, mund të përcaktojë të gjitha masat urgjente që lidhen me ta.

Zgjatja e masave të parashikuara në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar dhe në asnjë rast të mos i kalojë 3 vjet.

Neni 62

Masat kundër dhunës

Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që

ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore.

Neni 63

Disponimi i të ardhurave

Secili nga bashkëshortët mund të ushtrojë lirisht një profesion, të disponojë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit pasuror martesor përkatës, pasi të ketë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa.

Neni 64

Administrimi i sendeve vetjake

Secili nga bashkëshortët ka të drejtën e administrimit dhe të tjetërsimit lirisht të sendeve të tij vetjake, pa qenë nevoja e pëlqimit të bashkëshortit tjetër.

Neni 65

Përparësia e detyrimeve që rrjedhin nga martesa

Zbatimi i dispozitave të këtij kreu rrjedh nga martesa dhe zbatohet pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve.

TITULLI III

REGJIMET PASURORE MARTESORE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 66

Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve

Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat

e këtij Kodi dhe legjisllacionit përkatës.

Neni 67

Të drejta të pashmangshme

Bashkëshortët nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesë, si dhe përgjegjësisë prindërore dhe rregullave të administrimit ligjor dhe të kujdestarisë.

Neni 68

Përfaqësimi i bashkëshortit

Secili nga bashkëshortët mund t'i japë të drejtën bashkëshortit tjetër për ta përfaqësuar gjatë regjimit pasuror martesor, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Mandati i përfaqësimit mund të revokohet në çdo kohë.

Neni 69

Forma e kontratës

Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre.

Në çastin e nënshkrimit të kontratës, noteri i lëshon palëve një akt noterial, i cili përmban identitetin e plotë, adresën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe datën e lidhjes së kontratës.

Noteri ka detyrimin të depozitojë kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës.

Në qoftë se në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.

Neni 70

Në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore derisa të mbushë moshën

18 vjeç, çast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.

Neni 71

Në qoftë se një nga bashkëshortët ushtron veprimtari tregtare, ndryshimet në kontratën e martesës lidhur me veprimtarinë tregtare duhet të depozitohen, në çdo rast, edhe në regjistrin tregtar.

Efektet për personat e tretë fillojnë nga çasti i depozitimit të ndryshimit, parashikuar në paragrafin e parë.

Neni 72

Bashkëshortët mund të bien dakord, në interes të familjes, për ta ndryshuar pjesërisht ose tërësisht regjimin pasuror martesor vetëm pas kalimit të 2 vjetëve të zbatimit të tij.

Ndryshimet, në këtë rast, duhet të bëhen në të njëjtën formë që kërkohet për kontratën fillestare të martesës.

Ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka efekt kundrejt të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës. Në mungesë të këtij shënimi, ndryshimi nuk kundërshtohet nga të tretët, në qoftë se në aktet e bëra midis tyre, bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimin pasuror martesor.

KREU II

REGJIMI PASUROR MARTESOR NË BASHKËSI

Bashkësia ligjore

Neni 73

Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor.

Neni 74

Përbërja e bashkësisë

Bashkësia përbëhet nga:

- a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës;
- b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
- c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
- ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.

Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit.

Neni 75

Pasuria e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare

Pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare të njërit prej bashkëshortëve dhe shtesat e prodhimit të saj janë objekt i bashkëpronësisë vetëm nëse ekzistojnë si të tilla në çastin e mbarimit të martesës.

Neni 76

Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.

Neni 77

Pasuria vetjake

Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:

- a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;
- b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose

legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë;

c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake;

ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare;

d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;

dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura;

e) shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes.

Neni 78

Bashkësia mund të përfitojë kompensim, pas mbarimit të saj, për të ardhurat dhe pasuritë që bashkëshorti ka neglizhuar të marrë ose për ato që ai ka shpenzuar në keqbesim.

Kërkesa për kompensim duhet të paraqitet nga bashkëshorti i interesuar para mbarimit të procedurës të ndarjes së pasurisë.

Neni 79

E drejta e kompensimit

Pasuria e fituar në shkëmbim të një pasurie, e cila i përkiste individualisht njërit prej bashkëshortëve, është pasuri vetjake, me përjashtim të kompensimit që i bëhet bashkësisë ose e kundërta, kur nga shkëmbimi rezulton të ketë diferenca.

Nëse diferenca në ngarkim të bashkësisë është më e madhe se vlera e pasurisë vetjake të tjetërsuar, pasuria e fituar në këtë shkëmbim i përket bashkësisë, përveç kompensimit në favor të pasurisë vetjake të bashkëshortit.

Neni 80

Të ardhurat e përfituara, si pasojë e një ankandi ose forme tjetër, të një pasurie të paluajtshme, ku njëri nga bashkëshortët është bashkëpronar në pjesë të pandarë, nuk përbën pasuri të fituar gjatë martesës, me përjashtim të kompensimit që duhet t'i bëhet bashkësisë për shpenzimin që ajo ka bërë.

Neni 81

Detyrimet mbi bashkësinë

Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi:

- a) për të gjitha barrët dhe detyrimet që rëndojnë mbi ta në çastin e fitimit të pronësisë;
- b) për të gjitha shpenzimet e administrimit të pasurisë së përbashkët;
- c) për të gjitha shpenzimet për mbajtjen e familjes dhe për çdo detyrim të kontraktuar nga bashkëshortët, qoftë dhe veçmas, që është në interes të familjes;
- ç) për çdo detyrim tjetër kontraktues ose jokontraktues, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara si vetjake në këtë Kod.

Neni 82

Detyrimet që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës ose që rëndojnë trashëgimitë dhe dhurimet që fitojnë gjatë martesës mbeten detyrime vetjake.

Neni 83

Kreditorët e bashkëshortit, në rastin e nenit 82, mund t'i kërkojnë pagesat e tyre fillimisht mbi pasurinë vetjake dhe të ardhurat e bashkëshortit debitor. Ata mund të kërkojnë dhe vënien sekuestro mbi pasurinë e bashkësisë, atëherë kur pasuritë e luajtshme që i përkasin debitorit të tyre datën e lidhjes së martesës ose që i fitojnë me trashëgimi ose me dhurim janë përzier me pasurinë në bashkësi dhe nuk mund të identifikohen, sipas këtij Kodi.

Neni 84

Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi deri në gjysmën e vlerës së saj, kundrejt kreditorëve vetjakë të çdo bashkëshorti, kur pasuria vetjake e tij nuk mjafton për përmbushjen e:

- a) detyrimeve që ai ka marrë përsipër vetëm për administrimin e pasurisë në bashkësi, jashtë kufijve të tagrave të tij të administrimit;
- b) detyrimeve të tij vetjake, cilido qoftë çasti i lindjes së tyre.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet, nëse ka pasur mashtrim nga bashkëshorti debitor dhe keqbesim nga kreditori.

Neni 85

Në rast se detyrimi vetjak i njërit bashkëshort është shlyer nga bashkësia, ai detyrohet të bëjë kompensimin e bashkësisë.

Neni 86

Të ardhurat vetjake të një bashkëshorti nuk mund të preken nga kreditorët e bashkëshortit tjetër, vetëm nëse detyrimi ka qenë i kontraktuar për mirëmbajtjen e banesës dhe të familjes, sipas nenit 81 të këtij Kodi.

Neni 87

Detyrimet e kontraktuara veçmas nga bashkëshortët

Në rastin kur detyrimi është kontraktuar në interesin vetjak të njërit prej bashkëshortëve dhe ai është shlyer nga pasuria në bashkësi, bashkëshorti përfitues detyrohet të bëjë kompensimin e bashkësisë.

Neni 88

Në rast se nga pasuria në bashkësi janë paguar gjoba ose dëmshpërblime, për të cilat është detyruar njëri prej bashkëshortëve për shkak të një dënimi penal ose administrativ, ai detyrohet të kompensojë pasurinë në bashkësi.

Bashkësia ka të drejtën për kompensim nëse detyrimi që bashkësia ka

shlyer ishte kontraktuar nga njëri prej bashkëshortëve në kundërshtim me detyrimet që i imponon martesë.

Neni 89

Detyrimet solidare të bashkëshortëve me pasurinë në bashkësi

Kur një detyrim vjen në bashkësi për shkak të njërit bashkëshort, ai nuk mund të kërkohet mbi pasuritë vetjake të bashkëshortit tjetër. Nëse ka detyrime solidare të të dy bashkëshortëve, ai mund të kërkohet mbi pasurinë në bashkësi.

Neni 90

Administrimi i bashkësisë

Secili bashkëshort ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë në bashkësi.

Secili bashkëshort është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër përpara organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi.

Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve.

Neni 91

Administrimi nga një bashkëshort

Në rast largësie ose pengese tjetër të njërit bashkëshort dhe në mungesë të prokurës ose autorizimit të gjykatës, bashkëshorti tjetër mund të kryejë veprimet që janë të nevojshme edhe në rastin kur kërkohet pëlqimi i të dy bashkëshortëve, sipas nenit 90 të këtij Kodi.

Neni 92

Refuzimi i pëlqimit

Nëse njëri prej bashkëshortëve refuzon të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi të administrimit të jashtëzakonshëm ose për veprime të tjera, për të cilat kërkohet pëlqimi, bashkëshorti tjetër mund t'i drejtohet gjykatës

për të marrë autorizimin.

Gjykata vendos dhënien e autorizimit kur kryerja e veprimit është e nevojshme për interesa të familjes ose të veprimtarisë tregtare që bën pjesë në bashkësi.

Neni 93

Zëvendësimi në administrim

Nëse njëri nga bashkëshortët, për një kohë të vazhdueshme, ndodhet jashtë gjendjes për të shprehur vullnetin e tij, ose nëse administrimi i bashkësisë nga ana e tij dëshmon për paaftësi ose keqbesim, bashkëshorti tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të zëvendësojë atë në ushtrimin e të drejtave të tij.

Bashkëshorti i privuar nga të drejtat e administrimit të bashkësisë mund t'i kërkojë gjykatës rikthimin e tyre, nëse provon se janë zhdukur shkaqet e përjashtimit të tij nga administrimi.

Neni 94

Tejkalimi i të drejtave

Nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, mund të kërkohet nga bashkëshorti tjetër anulimi i veprimit, nëse më vonë ai nuk ka dhënë pëlqimin për këtë veprim.

Kjo padi mund të ngrihet brenda 1 viti nga data e marrjes dijeni për veprimin dhe, në çdo rast, jo më vonë se 1 vit nga mbarimi i bashkësisë.

Neni 95

Administrimi i pasurisë vetjake të bashkëshortit

Secili bashkëshort ka të drejtë të administrojë dhe të disponojë lirisht pasuritë vetjake.

Nëse gjatë martesës njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij vetjake, zbatohen rregullat e përfaqësimit.

Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë vetjake të tjetrit, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një akt përfaqësimi në heshtje, që mbulon

veprimet e administrimit dhe të përdorimit, me përjashtim të tagrit të disponimit. Në këtë rast, ai përgjigjet kundrejt bashkëshortit tjetër me cilësinë e përfaqësuesit dhe, nëse është rasti, detyrohet të dorëzojë vetëm frytet që ekzistojnë, duke mos u përgjigjur për ato që janë konsumuar.

Nëse njëri nga bashkëshortët, me gjithë kundërshtimin e tjetrit, administron pasurinë e tij vetjake dhe kryen veprime lidhur me të, përgjigjet për dëmin e shkaktuar dhe për frytet që duhet të ishin marrë. Në këtë rast, bashkëshorti i dëmtuar ka të drejtë të ngrejë padi për anulimin e veprimit të kryer, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 94 të këtij Kodi.

Neni 96

Mbarimi i bashkësisë

Bashkësia mbaron me:

- a) vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, shpalljen i zhdukur ose i vdekur të njërit prej tyre, shpalljen të pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës;
- b) pjesëtimin e pasurive;
- c) ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjell mbarimin e bashkësisë.

Neni 97

Ndalimi i pjesëtimit

Pjesëtimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshjeje të bashkëshortëve.

Neni 98

Pjesëtimi i pasurisë

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi mund të kërkohej në gjykatë në rast paaftësie dhe administrimit të keq të njërit prej bashkëshortëve, kur mënyra e administrimit të pasurisë prej tij vë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes, ose kur njëri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë dhe kur ka ndodhur një pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi.

Ndarja e pasurisë mund të kërkohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga përfaqësuesi i tij ligjor. Kreditorët e njërit bashkëshort nuk mund të kërkojnë vetë ndarjen e pasurisë.

Vendimi i gjykatës për ndarjen ka fuqi që nga data kur është paraqitur kërkesa dhe i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive martesore të ndara, të parashikuar në këtë Kod.

Neni 99

Kur procedura për pjesëtimin e pasurisë ka filluar, kreditorët mund të kërkojnë të njihen me kërkesën dhe dokumentet e paraqitura nga bashkëshortët, si dhe të ndërhyjnë në seancën gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Neni 100

Depozitimi

Kërkesa dhe vendimi i ndarjes së pasurisë duhet të depozitohen pranë zyres së gjendjes civile dhe, nëse është rasti, edhe në regjistrin tregtar. Vendimi shënohet në regjistrin e gjendjes civile, si dhe në origjinalin e kontratës së martesës.

Neni 101

Kompensimet

Secili nga bashkëshortët duhet të kompensojë shumat e marra nga pasuria në bashkësi, që janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ai i përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në nenin 81 të këtij Kodi.

Neni 102

Kompensimet dhe kthimet realizohen në çastin e mbarimit të bashkësisë. Gjykata mund të autorizojë dhe të urdhërojë për ato në çdo çast nëse e kërkon dhe e lejon interesi i familjes.

Neni 103

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivitetit dhe pasivitetit të saj.

Pasi të jenë zbritur nga bashkësia detyrimet që ajo ka ndaj bashkëshortëve ose të tretëve, pasuria që mbetet ndahet në pjesë të barabarta midis bashkëshortëve.

Gjykata, në bazë të nevojave të fëmijëve dhe nga fakti se kujt do t'i besohen ata, mund të vendosë në favor të një bashkëshorti kalimin e një pjesë të pasurisë së bashkësisë që i takon bashkëshortit tjetër.

Neni 104

Kur kompensimi bëhet në dobi të njërit bashkëshort, ky i fundit merr nga pasuria e bashkësisë një shumë të barabartë me vlerën që bashkësia i detyrohet atij. Në qoftë se aktivi i pasurisë së bashkësisë është i pamjaftueshëm, bashkëshorti tjetër është i detyruar për diferencën.

Në rastet kur aktivi i pasurisë nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e bashkësisë ndaj të tretëve, kreditorët kanë të drejtë t'i drejtohen secilit prej bashkëshortëve, të cilët përgjigjen solidarisht. Bashkëshorti që ka shlyer detyrimin e bashkësisë si më sipër, ka të drejtën e regresit ndaj bashkëshortit tjetër për pjesën e detyrimit të shlyer për llogari të tij.

Neni 105

Në fillim të procedurës së pjesëtimit të pasurisë në bashkësi, bashkëshortët ose trashëgimtarët e tyre kanë të drejtë të marrin pasurinë e luajtshme vetjake, që u përkiste para bashkësisë ose që ata e kanë fituar gjatë bashkësisë në formë trashëgimie ose dhurimi. Në mungesë të provave të kundërta prezumohet se pasuria e luajtshme bën pjesë në bashkësi.

Neni 106

Marrja e vlerës në rast të mungesës së pasurisë së luajtshme

Nëse pasuria e luajtshme nuk ekziston në natyrë, bashkëshorti ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të marrin vlerën e saj duke zbritur amortizimin e tij nga përdorimi në bashkësi, me kusht që mungesa e pasurisë të ketë ardhur për shkak të konsumit për përdorim, për shkak të shkatërrimit ose humbjes së saj ose për çdo shkak që nuk mund t'i kundërvihet bashkëshortit tjetër.

Neni 107

Pjesëtimi i pasurisë së bashkëshortëve bëhet sipas këtij Kodi, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile.

KREU III

BASHKËSIA ME KONTRATË

Neni 108

Bashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të ndryshojnë bashkësinë ligjore me marrëveshje, e cila nuk duhet të vijë në kundërshtim me nenet 66 dhe 67 të këtij Kodi.

Bashkëshortët mund të bien dakord që:

- a) bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme para martesës dhe fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës;
- b) të ndryshohen rregullat lidhur me administrimin;
- c) të kenë pjesë jo të barabarta;
- ç) të ketë ndërmjet tyre bashkësi universale.

Rregullat e bashkësisë ligjore mbeten të zbatueshme për të gjitha pikat që nuk janë bërë objekt i kontratës së martesës ndërmjet palëve.

Neni 109

Kur bashkëshortët bien dakord që të ketë ndërmjet tyre bashkësi, sipas nenit 108 shkronja "a", pasuria në bashkësi përbëhet nga pasuria në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore, nga pasuria e luajtshme para martesës dhe fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës.

Mbetet pasuri vetjake dhe nuk mund të përfshihet në bashkësi pasuria e luajtshme e parashikuar në shkronjat "c", "ç", "d" të nenit 77 të këtij Kodi.

Neni 110

Bashkëshortët, për detyrimet e tyre para martesës, përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi deri në kufirin e vlerës së pasurisë së tyre, e cila, në bazë të kontratës së lidhur, sipas këtij Kodi, është pjesë përbërëse e bashkësisë.

Neni 111

Administrimi i përbashkët

Bashkëshortët mund të bien dakord që ta administrojnë së bashku bashkësinë. Në këtë rast, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë së bashkësisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të dy bashkëshortëve dhe përmbajnë detyrimin solidar të tyre.

Neni 112

Pjesët jo të barabarta

Bashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të bien dakord të caktojnë pjesë jo të barabarta për pasurinë në bashkësi, ndryshe nga bashkësia ligjore.

Neni 113

Në rastet kur bashkëshortët, në kontratën e martesës, kanë përcaktuar pjesë jo të barabarta në bashkësi, ata ose trashëgimtarët e tyre i

përballojnë detyrimet në raport me pasurinë që kanë në bashkësi ose që kanë përfituar nga bashkësia.

Çdo klauzolë e kontratës është e pavlefshme nëse detyron bashkëshortin me pjesë të kufizuar ose trashëgimtarët e tij të përballojnë një detyrim më të madh se pjesa e tyre në bashkësi ose të përjashtohen nga përballimi i detyrimit të tyre në raport me këtë pjesë.

Neni 114

Bashkësia universale

Bashkëshortët mund të vendosin në kontratën e martesës një bashkësi universale të pasurisë së tyre, të luajtshme dhe të paluajtshme, që ekziston dhe që do të vihet në të ardhmen, me përjashtim të pasurisë vetjake të parashikuar në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të nenit 77 të këtij Kodi.

Bashkësia universale përballon të gjitha detyrimet e bashkëshortëve, që ekzistojnë në çastin e lidhjes së kontratës dhe gjatë martesës.

KREU IV

REGJIMI I PASURIVE TË NDARA

Neni 115

Kur bashkëshortët kanë përcaktuar në kontratën e martesës regjimin e pasurive të ndara, secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij.

Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur atij, para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 70 të këtij Kodi.

Neni 116

Detyrimet që rrjedhin nga martesë

Bashkëshortët kontribuojnë në detyrimet që rrjedhin nga martesë, sipas përcaktimit të kushteve në kontratën e martesës.

Në rast se kontrata e martesës nuk përmban asgjë lidhur me detyrimet që rrjedhin nga martesë, bashkëshortët kontribuojnë sipas nenit 54 të këtij Kodi.

Neni 117

Administrimi i pasurisë

Në rast se gjatë martesës, njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij, zbatohen rregullat e përfaqësimit.

Bashkëshorti përfaqësues nuk është i detyruar të japë llogari për kthimin e fryteve, nëse prokura nuk e detyron shprehimisht për një gjë të tillë.

Neni 118

Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë e bashkëshortit tjetër, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një mandat të heshtur, i cili mbulon veprimet lidhur me administrimin, por jo ato të disponimit.

Në këtë rast, bashkëshorti përfaqësues përgjigjet ndaj bashkëshortit tjetër vetëm për frytet që ekzistojnë dhe nuk përgjigjet për ato që janë konsumuar.

Nëse njëri nga bashkëshortët, me gjithë kundërshtimin e tjetrit, administron pasurinë e këtij të fundit ose kryen veprime lidhur me këtë pasuri, ai përgjigjet për dëmin dhe për frytet që duhet të ishin marrë.

Neni 119

Pasuria e luajtshme që posedohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga të dy bashkëshortët prezumohet, në lidhje me kreditorët e secilit prej tyre, se i përket bashkëshortit debitor. Ky prezumim nuk është i vlefshëm në rast të ndërprerjes së jetesës së përbashkët.

Pasuria e luajtshme që posedohet nga të dy bashkëshortët prezumohet, në lidhje me njëri-tjetrin, se i përket të dy bashkëshortëve në pjesë të barabarta.

Pasuria e luajtshme, e paracaktuar për përdorim vetjak nga njëri prej bashkëshortëve, prezumohet se i përket këtij të fundit.

Neni 120

Me mbarimin e martesës për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort, pjesëtimi i pasurisë ndërmjet bashkëshortëve me regjime pasurish të ndara, për sa i përket formës, ruajtjes së pandarë të sendit të papjesëtueshëm, radhës së preferencave, shitjes në ankand të sendeve të papjesëtueshme, efekteve të ndarjes, garancisë dhe diferencave, i nënshtrohet rregullave të trashëgimisë për ndarjen midis trashëgimtarëve. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe pas zgjidhjes së martesës, me përjashtim të radhës së preferencave. Mund të vendoset që diferenca e mundshme të paguhet me para në dorë.

Neni 121

Nëse martesa mbaron ose shpallet e pavlefshme dhe pasuria e njërit prej bashkëshortëve është shtuar nga lidhja e martesës, bashkëshorti tjetër, në rastin kur ai ka kontribuar në një mënyrë ose në një tjetër për këtë shtim, ka të drejtën të kërkojë kthimin e pjesës së shtuar nga kontributi i tij.

Neni 122

E drejta e parashikuar në nenin 121 i kalon trashëgimtarëve të bashkëshortit të vdekur, vetëm nëse njihet në kontratë ose për shkak të vazhdimit të një gjykimi të filluar.

Kjo e drejtë parashkruhet me kalimin e 2 vjetëve nga mbarimi ose shpallja e pavlefshme e martesës.

TITULLI IV

MBARIMI I MARTESËS

KREU I

RASTET E MBARIMIT TË MARTESËS

Neni 123

Martesa mbaron me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës së tyre.

Neni 124

Kur bashkëshorti që është shpallur i vdekur del se është gjallë, martesa e mbaruar me shpalljen e vdekjes bëhet përsëri e vlefshme, përveçse kur bashkëshorti tjetër ka lidhur martesë të re.

KREU II

RASTET E ZGJIDHJES SË MARTESËS

Neni 125

Pëlqimi reciprok i bashkëshortëve

Kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën, edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.

Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre respektivë.

Neni 126

Gjykata shqyrton kërkesën, dëgjon fillimisht veçmas secilin nga bashkëshortët, më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre dhe në fund thërret përfaqësuesit e bashkëshortëve, në qoftë se ata kanë të tillë.

Neni 127

Gjykata vendos zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.

Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore.

Neni 128

Refuzimi i miratimit

Në rast se gjykata konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve, pezullon gjykimin për 3 muaj dhe u kërkon bashkëshortëve të bëjnë rregullimet e duhura në marrëveshje.

Në qoftë se edhe pas afatit të parashikuar në paragrafin e parë nuk janë bërë rregullimet e duhura, gjykata refuzon miratimin dhe rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve.

Neni 129

Zgjidhja e martesës për ndërprerje të jetesës së përbashkët

Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.

Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër.

Neni 130

Gjykata mund të rrëzojë padinë për zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, kur bashkëshorti tjetër provon se zgjidhja e martesës do të ketë pasoja veçanërisht të rënda morale dhe materiale për fëmijët ose bashkëshortin tjetër. Padia mund të ringrihet për të njëtat shkaqe nëse ekzistojnë rrethana të reja.

Neni 131

Ndërprerja e jetesës së përbashkët mund të paraqitet si shkak për zgjidhjen e martesës vetëm nga bashkëshorti që ka paraqitur kërkesëpadinë. Bashkëshorti i paditur ka të drejtë të paraqesë kundërpadi. Në këtë rast, gjykata mund të rrëzojë padinë dhe të pranojë kundërpadinë, duke zgjidhur martesën.

Neni 132

Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort

Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.

Neni 133

Gjykata vendos për fajësinë, në zgjidhjen e martesës, vetëm kur kjo kërkohet prej njërit ose të dy bashkëshortëve.

Neni 134

Përpjekjet për pajtim

Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton

fillimisht një seancë pajtimi, në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët.

Gjyqtari mund t'i dëgjojë ata veçmas secilin dhe më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre.

Kur arrihet pajtimi, mbahet procesverbal dhe gjykimi pushohet për këtë shkak.

Neni 135

Në rast se në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Kur nuk paraqitet i padituri, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari shtyn seancën e pajtimit, duke i përsëritur njoftimin të paditurit. Nëse edhe në këtë seancë i padituri nuk paraqitet pa ndonjë shkak të arsyeshëm, gjyqtari, pasi dëgjon paditësin dhe krijon bindje se pajtimi i bashkëshortëve nuk mund të arrihet, cakton seancën gjyqësore, duke urdhëruar thirrjen e provave të nevojshme.

Neni 136

Gjykata mund të shtyjë shpalljen e vendimit deri në 1 vit, kur nuk ka krijuar bindje se përjashtohet çdo mundësi pajtimi e bashkëshortëve.

Neni 137

Pezullimi i gjykimit me kërkesën e gruas shtatzënë

Kur gruaja është shtatzënë, me kërkesën e saj, gjykata mund të pezullojë gjykimin e padisë së zgjidhjes së martesës, por jo më tepër se 1 vit nga çasti i lindjes së fëmijës.

Neni 138

Bashkimi i kerkimeve të tjera

Në kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës mund të kërkohet edhe detyrimi i bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, shpenzimet për jetesë

të bashkëshortit nevojtar, në rastet e parashikuara në këtë Kod, si dhe likuidimin e regjimit pasuror martesor përkatës.

Gjykata veçon likuidimin e regjimit pasuror martesor në rast se vështirësohet shqyrtimi i çështjes, sipas kërkesave të paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 139

Marrja e masave të përkohshme

Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të marrë masa të përkohshme për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, për detyrimin për ushqim të bashkëshortit, kur shihet e arsyeshme, për sigurimin e banimit, si dhe administrimin dhe përdorimin e pasurisë së vënë gjatë martesës, nëse është rasti.

Vendimi për marrjen e një mase të përkohshme ka fuqi derisa të jepet vendimi përfundimtar, por ai mund të ndryshohet ose të shfuqizohet nga gjykata, kur çmon se kanë ndryshuar rrethanat ose kur vendimi është marrë mbi të dhëna jo të sakta.

Neni 140

Të drejtat e trashëgimtarëve

E drejta e padisë për zgjidhjen e martesës nuk u kalon trashëgimtarëve. Në rast se gjykimi ka filluar më parë, gjykata ndërpret procesin dhe pushon gjykimin.

Në këtë rast, bashkëshorti pasjetues gëzon të drejtën për të trashëguar bashkëshortin e vdekur.

Neni 141

E drejta e ngritjes së padisë nga kujdestari

Kur bashkëshortit i është hequr zotësia për të vepruar ose për arsye të tjera është vënë në kujdestari, padia për zgjidhjen e martesës mund të ngrihet nga kujdestari i tij.

Në rast se bashkëshorti, ndaj të cilit është bërë kërkesëpadi, është në kujdestari, në gjykimin e zgjidhjes së martesës përfaqësohet nga

kujdestari i tij.

Në rastin kur bashkëshorti i pazotë për të vepruar ndodhet në kujdestarinë e bashkëshortit tjetër, gjykata i cakton atij një kujdestar të posaçëm, për ta përfaqësuar në procedurën e zgjidhjes së martesës.

Neni 142

Në rastin e burgimit të bashkëshortit, e drejta e ngritjes së padisë për zgjidhjen e martesës mund të ushtrohet nga kujdestari ose përfaqësuesi ligjor, vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e bashkëshortit që vuan dënimin me burgim.

Neni 143

Dërgimi i vendimit në zyrën e gjendjes civile

Pasi të ketë marrë formë të prerë, vendimi për zgjidhjen e martesës i dërgohet nga gjykata për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Neni 144

Efektet e vendimit të zgjidhjes së martesës

Vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës i fillon efektet e tij nga data që merr formë të prerë.

Vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës i fillon efektet e tij për të tretët nga data e regjistrimit të tij në zyrën e gjendjes civile, sipas legjislacionit përkatës.

KREU III

PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS

Neni 145

Pasojat për ish-bashkëshortët

Në rast se ish-bashkëshortët që kanë zgjidhur martesën dëshirojnë ta rilidhin atë, duhet të zbatojnë të gjitha procedurat e nevojshme për lidhjen

e një martesë të re.

Neni 146

Përdorimi i mbiemrit

Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.

Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.

Neni 147

Kontributi kompensues

Gjykata mund të detyrojë njërin nga ish-bashkëshortët të derdhë për llogari të tjetrit një kontribut të destinuar për të kompensuar sa të jetë e mundur pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim.

Gjykata përcakton nëse kontributi mund të jepet i menjëhershëm ose periodik dhe mënyrën e pagimit të tij.

Neni 148

Kontributi kompensues caktohet sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues dhe burimeve të tjetrit, duke marrë në konsideratë gjendjen në çastin e zgjidhjes së martesës dhe kohëzgjatjen e saj në një të ardhme të parashikueshme.

Kohëzgjatja e dhënies së kontributit kompensues caktohet nga gjykata, sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues.

Nëse ish-bashkëshorti përfitues lidh martesë të re, kontributi kompensues ndërpritet.

Neni 149

Në përcaktimin e nevojave dhe të burimeve, gjykata merr në konsideratë:

- a) moshën dhe gjendjen shëndetësore të ish-bashkëshortëve;
- b) kohën e shpenzuar dhe atë që i duhet të shpenzojnë për edukimin e fëmijëve;
- c) kualifikimin e tyre profesional;
- ç) predispozitën e tyre për punë të reja;
- d) të drejtat që ata gëzojnë dhe ato që parashikohen për të ardhmen;
- dh) pasurinë e tyre, si kapital ose si e ardhur, pas likuidimit të regjimit pasuror martesor.

Neni 150

Ndryshimi i kontributit kompensues mund të kërkohet në gjykatë vetëm në rast se vazhdimi i njëjtë i tij sjell pasoja tepër të rënda për njërin nga ish-bashkëshortët.

Neni 151

Në rastin e kërkesës së përbashkët, ish-bashkëshortët caktojnë shumën dhe mënyrën e dhënies së kontributit kompensues me marrëveshje, e cila i paraqitet gjyqtarit për miratim.

Gjyqtari mund të refuzojë miratimin e marrëveshjes, nëse konstaton se të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve janë caktuar në mënyrë të padrejtë.

Neni 152

Marrëveshja e miratuar nga gjykata mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje të re, të miratuar nga gjykata, kur rrethanat kanë ndryshuar ose kur ato e imponojnë një gjë të tillë.

Bashkëshortët, në rast ndryshimi të papritur të burimeve dhe nevojave të tyre, mund t'i kërkojnë gjykatës të rishikojë kontributin kompensues.

Neni 153

E drejta e përdorimit të banesës

Në rast se banesa familjare është në pronësi të njërit ish-bashkëshort

dhe bashkëshorti tjetër nuk ka në pronësi banesë tjetër të përshtatshme në vendbanimin e tyre, gjykata mund të lejojë përdorimin nga ish-bashkëshorti jopronar të banesës kur:

a) fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim këtij të fundit, derisa ata të arrijnë moshën madhore;

b) zgjidhja e martesës bëhet nga ish-bashkëshorti pronar për ndërprerje prej tij të jetesës së përbashkët. Në këtë rast e drejta e përdorimit të banesës është deri në 7 vjet, por në rast se ish-bashkëshorti jopronar rimartohet, e humbet këtë të drejtë;

c) kur ish-bashkëshorti jopronar ka instaluar në banesën e ish-bashkëshortit pronar një kabinet profesional me vlerë të madhe, lëvizja e të cilit do të kërkonte shpenzime të mëdha. Në këtë rast e drejta e përdorimit është deri në 3 vjet.

Në këto raste gjykata përcakton afatin e përdorimit dhe masën e qirasë që detyrohet të paguajë ish-bashkëshorti jopronar në përputhje me të ardhurat e tij.

Në çdo rast gjykata mund të zgjidhë kontratën e qirasë, në qoftë se kjo justifikohet nga rrethana të reja.

Neni 154

Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët

Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Kod.

Neni 155

Para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija.

Në rast se gjykata arrin në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t'i besohet një personi të tretë ose një familjeje kujdestare, duhet të marrë

mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi.

Neni 156

Gjykata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose për t'i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurorit, në rast se ka shkaqe të rënda që janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore.

Neni 157

Gjyqtari, në këtë rast, merr në konsideratë:

- a) marrëveshjen e bërë ndërmjet ish-bashkëshortëve;
- b) mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij;
- c) mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën.

Neni 158

Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër. E drejta e vizitës dhe e banimit, sipas kushteve të përcaktuara nga gjykata, nuk mund t'i refuzohen, veçse për arsye të rënda që dëmtojnë interesat e fëmijës.

Neni 159

Vendimi lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mund të ndryshohet në çdo çast nga gjykata, me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, një të afërmi ose të prokurorit.

Neni 160

Në rast të zgjidhjes së martesës me kërkesë të përbashkët, kushtet e marrëveshjes së miratuar nga gjyqtari, lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, mund të rishqyrtohen për shkaqe me rëndësi dhe sipas kërkesës së njërit prej ish-bashkëshortëve ose të prokurorit.

Neni 161

Në vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet dhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën dhe për ish-bashkëshortin, nëse është rasti, sipas parashikimeve të kreut "Detyrimi për ushqim" të këtij Kodi.

Neni 162

Çdonjëri prej ish-bashkëshortëve është i detyruar t'i japë tjetrit të dhëna të sakta për pasurinë dhe të ardhurat e tij, kur ato janë të nevojshme për të caktuar detyrimin për ushqim. Me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, punëdhënësi, organet financiare përkatëse, zyrat e tatimeve dhe çdo organ tjetër ku mund të merren prova, janë të detyruar të japin gjithë informacionin e nevojshëm për gjendjen pasurore të ish-bashkëshortit tjetër dhe për të gjitha të ardhurat e tjera të tij.

TITULLI V

BASHKËJETESA

Neni 163

Kuptimi i bashkëjetesës

Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Neni 164

Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.

PJESA E TRETË

FËMIJËT

TITULLI I

AMËSIA DHE ATËSIA

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 165

Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesë provohen nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Neni 166

Nuk mund të ngrihet padi për vërtetimin e amësisë ose atësisë për një fëmijë që nuk ka lindur i gjallë.

Neni 167

Nga njohja e amësisë ose e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese nuk mund të hiqet dorë.

Neni 168

Në rastin e ngatërimit ose zëvendësimit të fëmijës, në çdo rast, edhe kur bëhet në mënyrë të pavullnetshme, mund të kërkohet me padi njohjeje

ose kundërshtimi një identitet i ndryshëm i fëmijës, nëse konstatimi është bërë përpara ose pas marrjes së aktit të lindjes.

Neni 169

Në mungesë të aktit të lindjes ose në qoftë se fëmija është regjistruar me emër të rremë, ose pa treguar emrin e nënës dhe të atit, amësia dhe atësia mund të vërtetohen me vendim gjyqësor.

Neni 170

Njohja e amësisë dhe atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese

Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martese mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon të drejta dhe detyrime të njëjta, në mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesa.

Neni 171

Mbiemri i fëmijës së lindur jashtë martese

Fëmija i lindur jashtë martese merr mbiemrin e prindit, amësia ose atësia e të cilit është vendosur më përpara. Në qoftë se amësia dhe atësia vendosen në të njëjtën kohë, prindërit vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë fëmija. Në rast mosmarrëveshjeje, fëmijës i vendoset mbiemri i të atit.

Neni 172

Njohja e një fëmije nuk mund të pasohet nga një njohje tjetër, e ndryshme nga e para, në rast se kjo e fundit nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore.

Neni 173

Kundërshtimi i njohjes

Njohja mund të kundërshtohet nga të gjithë personat që kanë një interes

të ligjshëm dhe që kanë dijeni se njohja e bërë është e pavërtetë. Kundërshtimi mund të bëhet edhe nga personi që ka bërë njohjen, kur ajo është bërë në kushtet e mashtrimit ose kanosjes.

Të drejtën e kundërshtimit të njohjes e ka edhe prokurori, në rast se, nga të dhënat që figurojnë në aktet e gjendjes civile, rezulton pavërtetësia e amësisë dhe atësisë së deklaruar.

Neni 174

Efektet e vendimit

Vendimi i gjykatës që përcakton amësinë ose atësinë ka efekt që nga lindja e fëmijës.

KREU II

AMËSIA

Neni 175

Amësia e fëmijës vërtetohet me aktin e lindjes.

Neni 176

Njohja e amësisë

Kur fëmija është regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur, nëna mund ta njohë fëmijën. Njohjen e fëmijës mund ta bëjë edhe vetë nëna e mitur.

Njohja mund të bëhet para nëpunësit të gjendjes civile ose me testament. Njohja e bërë nuk mund të revokohet edhe sikur të jetë bërë me testament.

Neni 177

Fëmija i regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur mund të kërkojë nga gjykata vërtetimin e amësisë.

E drejta e padisë për vërtetimin e amësisë nuk u kalon trashëgimtarëve të fëmijës, por gjykimi i filluar që më parë mund të vazhdojë nga

trashëgimtarët.

Padia për vërtetimin e amësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të gruas që kërkohet të vërtetohet se është nëna.

E drejta e padisë për vërtetimin e amësisë nuk parashkruhet gjatë gjithë kohës që fëmija jeton.

Neni 178

Kundërshtimi i amësisë

Amësia e treguar në aktin e lindjes mund të kundërshtohet nga gruaja e regjistruar si nënë e fëmijës ose nga gruaja që kërkon të njihet si nënë ose nga fëmija kur bëhet madhor.

E drejta e padisë nuk u kalon trashëgimtarëve, por gjykimi i filluar mund të vazhdojë prej tyre.

Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të gruas së regjistruar si nënë.

E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.

Neni 179

Kundërshtimi i njohjes së amësisë

Njohja e amësisë mund të kundërshtohet në gjykatë nga gruaja që kërkon të njihet si nënë, nga fëmija kur bëhet madhor ose nga prokurori.

E drejta e padisë nuk u kalon trashëgimtarëve, por gjykimi i filluar më parë mund të vazhdojë nga trashëgimtarët e paditësit.

Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të nënës që ka njohur fëmijën.

E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.

KREU III

ATËSIA

Neni 180

Fëmija që ka lindur gjatë martesës presumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës.

Fëmija që ka lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës ose nga shpallja e pavlefshmërisë së martesës presumohet se ka për atë ish-bashkëshortin e nënës.

Kur fëmija ka lindur gjatë vazhdimit të martesës së dytë të nënës, presumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës me martesë të dytë, edhe sikur fëmija të ketë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj.

Neni 181

Njohja e atësisë

Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njeh fëmijën si të tij.

Njohja e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e lajmëron nëpunësi i gjendjes civile. Kur nëna e kundërshton këtë njohje ose nuk përgjigjet brenda 1 muaji nga marrja e lajmërimit, burri që ka njohur fëmijën si të tij mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga data e marrjes së lajmërimit nga nëpunësi i gjendjes civile, për mospranimin nga ana e nënës.

Neni 182

Ati që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç mund të njohë në çdo kohë fëmijën e tij të lindur jashtë martese para nëpunësit të gjendjes civile ose me testament.

Njohja e bërë nga i ati ka efekt vetëm ndaj tij, në rastin kur nuk tregohet emri i nënës dhe kur ajo nuk ka dhënë pëlqimin për njohjen e fëmijës.

Njohja e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese nuk mund të revokohet edhe sikur të jetë bërë me testament.

Neni 183

Padia për vërtetimin e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese mund të ngrihet nga nëna e fëmijës edhe kur ajo është e mitur ose nga kujdestari i saj, me pëlqimin e gjykatës.

E drejta e padisë së nënës parashkruhet me kalimin e 3 vjetëve nga lindja e fëmijës.

Padia për vërtetimin e atësisë mund të ngrihet edhe nga vetë fëmija madhor.

E drejta e padisë nuk parashkruhet.

Padia për vërtetimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të atij që kërkohet të vërtetohet se ishte i ati i fëmijës.

Neni 184

Kundërshtimi i atësisë së prezumuar

Burri, që sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet se është atë i një fëmije, mund të kundërshtojë atësinë e këtij fëmije.

Padia për kundërshtimin e atësisë ngrihet kundër fëmijës, i cili përfaqësohet nga nëna. Kur nëna është në pamundësi dhe fëmija është i mitur, i caktohet një kujdestar i posaçëm nga gjykata.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti, nga data që burri ka marrë dijeni për lindjen e fëmijës.

Neni 185

Nëna mund të kundërshtojë që të jetë i ati i fëmijës së saj burri që, sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet i ati i këtij fëmije.

Padia për kundërshtimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e një 1 viti nga lindja e fëmijës.

Neni 186

Fëmija, kur bëhet madhor, mund të kundërshtojë që të jetë i ati i tij bashkëshorti i nënës.

Padia për kundërshtimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të të atit.

E drejta e padisë nuk parashkruhet.

Neni 187

Kundërshtimi i njohjes së atësisë

Fëmija, kur bëhet madhor, mund të kundërshtojë që të jetë ati i tij burri që e ka njohur. Padia për kundërshtimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit që e ka bërë njohjen.

E drejta e padisë nuk parashkruhet.

Neni 188

Burri që e quan veten si i ati i fëmijës së lindur jashtë martese, mund të kundërshtojë që një burrë tjetër, i cili e ka njohur fëmijën, të jetë ati i tij. Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit që e ka njohur fëmijën si të tij.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga regjistrimi i atësisë në regjistrin e gjendjes civile.

Neni 189

Vërtetimi i atësisë së fëmijës së lindur jashtë martese

Atësia e një fëmije të lindur jashtë martese mund të vërtetohet me vendim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë, ose nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martese, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të tijin.

Neni 190

Kur ka shkaqe të përligjura, gjykata mund të zgjasë afatet e mësipërme të parashkrimit, me kërkesën e personit të interesuar.

Neni 191

E drejta e padisë, e parashikuar në nenet 184, 185, 186, 187 dhe 188 të këtij Kodi, nuk u kalon trashëgimtarëve të paditësit, por gjykimi i filluar më parë mund të vazhdojë nga trashëgimtarët e tij.

Në rast se fëmija është zënë kur mungonte bashkëshorti i nënës dhe ky ka vdekur pa u plotësuar afati brenda të cilit mund të ngrihet padia për kundërshtimin e atësisë, të paralindurit ose të paslindurit e tij mund ta ngrenë padinë brenda 6 muajve nga data e vdekjes së tij.

TITULLI II

DETYRIMI PËR USHQIM

KREU I

PERSONAT E DETYRUAR

Neni 192

Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës:

- a) bashkëshorti ndaj bashkëshortit tjetër dhe fëmijët ndaj prindërve të tyre;
- b) prindërit ndaj fëmijëve të tyre;
- c) të paslindurit ndaj të paralindurve të tyre, që nuk janë prindër, sipas radhës më të afërt;
- ç) të paralindurit ndaj të paslindurve të tyre, që nuk janë fëmijë të tyre, sipas radhës më të afërt;
- d) vëllezërit dhe motrat ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre, sipas radhës më të afërt;

Neni 193

Detyrimi i përfituesit të dhurimit

Përfituesi i dhurimit, në preferencë kundrejt çdo të detyruari tjetër, detyrohet t'i japë dhuruesit detyrimin për ushqim, përveçse kur bëhet fjalë për dhurim të bërë lidhur me një martesë ose për një dhurim me kusht.

Neni 194

Detyrimi midis njerikut, njerks dhe thjeshtërve të tyre

Kanë detyrim për ushqim edhe njerku e njerka ndaj thjeshtërve të tyre të mitur, përveç rasteve kur këta kanë persona të tjerë që kanë detyrimin për ushqim ndaj tyre dhe janë në gjendje ta japin këtë detyrim.

Thjeshtërit kanë detyrimin për ushqim për njerkun dhe njerken e tyre, kur këta ia kanë dhënë për një kohë të gjatë këtë detyrim dhe janë kujdesur për ta në mituri, jo më pak se 10 vjet. Në këtë rast thjeshtërit ngarkohen me dhënien e detyrimit për ushqim njëllor si ndaj prindërve të tyre.

Neni 195

Detyrimi për ushqim pushon në qoftë se martesa ndërmjet prindit dhe njerks ose njerikut është zgjidhur.

Neni 196

Pamundësia e dhënies së detyrimit për ushqim

Kur personat e ngarkuar për dhënien e detyrimit për ushqim nuk janë në gjendje që ta japin këtë tërësisht ose pjesërisht, ky detyrim u kalon tërësisht ose pjesërisht personave që janë në radhë të mëpasme.

Prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t'u jetë hequr përgjegjësia prindërore.

Neni 197

Detyrimi për ushqim ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij.

Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç.

Neni 198

Detyrimi për ushqim lind vetëm kur personi që kërkon këtë detyrim është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Neni 199

Detyrimi ndërmjet bashkëshortëve

Bashkëshorti që është i paaftë për punë dhe pa mjete të mjaftueshme për të jetuar, ka të drejtë të kërkojë detyrimin për ushqim nga bashkëshorti tjetër.

Detyrimi për ushqim kërkohet në të njëjtën kohë me padinë për zgjidhjen e martesës.

Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe brenda 6 muajve, nga data që vendimi për zgjidhjen e martesës ka marrë formë të prerë, me kusht që paaftësia dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme për të jetuar të kenë ekzistuar gjatë martesës.

Neni 200

Mbarimi i detyrimit ndërmjet bashkëshortëve

Detyrimi për ushqim, sipas nenit 199 të këtij Kodi, caktohet për një kohë jo më të gjatë se 6 vjet pas zgjidhjes së martesës.

Ky detyrim pushon para këtij afati, kur bashkëshorti, që e gëzonte këtë të

drejtë, lidh martesë të re ose bëhet i aftë për punë, ose siguron mjete të mjaftueshme për të jetuar, ose kur gjykata, duke marrë parasysh rrethanat, gmon se nuk është i denjë për të përfituar nga kjo e drejtë.

Neni 201

Kufijtë e detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim mund të kërkohej vetëm nga ai që është nevojtar dhe nuk është në gjendje të sigurojë nevojat e domosdoshme të tij.

Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Ai nuk duhet të kapërcejë atë që është e nevojshme për jetën e personit që përfiton detyrimin për ushqim, duke pasur parasysh rrethanat e jetës së tij.

Neni 202

Në rastin e dhurimit, përfituesi i tij nuk mund të detyrohet më shumë sesa vlera e pasurisë së dhuruar që ekziston në pasurinë e tij.

Neni 203

Kufijtë e detyrimit midis vëllezërve dhe motrave

Detyrimi për ushqim midis vëllezërve dhe motrave kufizohet vetëm në nevojat e domosdoshme. Këtu mund të përfshihen edhe shpenzimet e edukimit dhe arsimimit, kur bëhet fjalë për vëllezërit dhe motrat e mitura.

Neni 204

Konkurrimi i të detyruarve

Nëse për dhënien e detyrimit për ushqim ka shumë të detyruar të së njëjtës shkallë, të gjithë janë të detyruar solidarisht në dhënien e këtij detyrimi, secili në raport me mundësitë e tij ekonomike.

Nëse personat e thirrur në një shkallë të mëparshme nuk janë në gjendje që ta përballojnë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për ushqim, ky u kalon plotësisht ose pjesërisht personave të thirrur në një shkallë të mëpasme.

Neni 205

Nëse personat e detyruar nuk bien dakord për kufijtë e detyrimit për ushqim, për shpërndarjen dhe mënyrën e dhënies së tij, sipas rrethanave konkrete, vendos gjykata.

Neni 206

Konkurrimi i personave që marrin detyrimin për ushqim

Kur disa persona marrin detyrimin për ushqim nga i njëjti person i detyruar dhe kur ky i fundit nuk është në gjendje të përballojë nevojat e secilit prej tyre, gjykata vendos detyrimin për ushqim, duke marrë parasysh shkallën e afërsisë dhe nevojat që ka secili prej personave që merr këtë detyrim.

Neni 207

Heqja, pakësimi ose shtimi i detyrimit për ushqim

Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë, kur rrethanat në bazë të të cilave është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë.

Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë.

Nëse pas përcaktimit të detyrimit për ushqim konstatohet se një nga personat e detyruar në shkallë të mëparshme është në gjendje që ta japë atë, gjykata vendos zëvendësimin këtij detyrimi.

Në këtë rast, personi i detyruar në shkallën e mëpasme nuk çlirohet nga ky detyrim, pa u caktuar detyrimi për ushqim ndaj personit në shkallën e mëparshme.

Neni 208

Pagimi i shpenzimeve

Cilido që ka bërë shpenzime për ushqimin e një personi, pa qenë i detyruar, ka të drejtë të kërkojë me padi kthimin e asaj që ka paguar nga ai që ka qenë i detyruar për ushqim, në qoftë se shpenzimet e bëra kanë qenë të nevojshme.

Neni 209

Mënyra e përmbushjes së detyrimit për ushqim

Personi që ka detyrimin për ushqim ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht, ose duke e mbajtur në shtëpinë e tij atë që merr detyrimin për ushqim.

Gjykata, sipas rrethanave, përcakton mënyrën e dhënies së detyrimit për ushqim.

Në rast nevojë urgjente, gjykata vendos detyrimin për ushqim në ngarkim të njërit prej personave të detyruar. Në këtë rast, personi i detyruar ruan të drejtën e padisë së regresit ndaj personave të tjerë.

Neni 210

Fillimi i detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim fillon nga data e ngritjes së padisë.

Pakësimi ose heqja e detyrimit për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë dhe të paekzekutuar, fillon nga data kur kanë ndryshuar rrethanat, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, kurse shtimi i tij fillon nga data e ngritjes së padisë.

Neni 211

Kur një vendim, që përmban një detyrim për ushqim, vihet në ekzekutim pas 6 muajve nga data që ka marrë formë të prerë, detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për 6 muajt e fundit.

Neni 212

Pushimi i detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim pushon me vdekjen e personit të detyruar, personit që e përfiton atë, edhe sikur ky detyrim, që përmbahet në një vendim të formës së prerë, të mos jetë ekzekutuar.

Neni 213

Ndalimi i kompensimit dhe i zëvendësimit të detyrimit për ushqim

E drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim nuk mund t'i kalojë një personi tjetër.

Personi që ka detyrimin për ushqim nuk mund të kërkojë që ky detyrim të shlyhet me një kredi që ka ndaj personit që e përfiton atë, edhe sikur të ketë detyrime të prapambetura për ushqim.

Neni 214

Heqja dorë

Heqja dorë nga e drejta për të marrë detyrimin për ushqim për kohën e ardhshme është e pavlefshme.

TITULLI III

PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE

KREU I

KUPTIMI I PËRGJEGJËSISË PRINDËRORE

Neni 215

Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.

Neni 216

Kufijtë e përgjegjësisë prindërore

Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në arritjen e moshës madhore.

Neni 217

Detyrimi reciprok

Prindërit dhe fëmijët reciprokisht duhet të ndihmojnë, të duan dhe të respektojnë njëri-tjetrin.

Neni 218

Kthimi i fëmijës

Prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë. Gjkata, për rrethana të rënda, mund të mos vendosë kthimin, në qoftë se ky vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Gjkata merr edhe mendimin e fëmijës kur ka mbushur moshën dhjetë vjeç.

Neni 219

Marrëdhëniet e fëmijës me gjyshërit

Prindërit nuk mund të ndalojnë fëmijën të ketë marrëdhënie vetjake me gjyshërit e tij, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë shkaqe të rënda. Në rast mosmarrëveshjeje midis palëve, gjykata mund të vendosë për mënyrën e rregullimit të këtyre marrëdhënieve.

KREU II

USHTRIMI I PËRGJEGJËSISË PRINDËRORE

Neni 220

Ushtrimi i përbashkët i përgjegjësisë prindërore

Përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijën e lindur gjatë martesës së tyre ose jashtë martese, nëse është njohur nga të dy prindërit.

Neni 221

Në qoftë se prindërit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës, ata mund t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos pasi është përpjekur ta zgjidhë çështjen me pajtim.

Neni 222

Kur njëri nga prindërit kryen një veprim të zakonshëm me të tretët, që lidhet me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ai prezumohet se ka marrë edhe pëlqimin e prindit tjetër.

Neni 223

Humbja e përgjegjësisë prindërore

Prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpuntorë për një veprë penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkëpunëtorë në një veprë penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj.

Neni 224

Pamundësia e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore

Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtarit të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes.

Në këtë rast merret mendimi i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë.

Neni 225

Në qoftë se njëri nga prindërit është para pamundësisë së ushtrimit të

përgjegjësisë prindërore ose kur njëri nga prindërit ka vdekur, përgjegjësia prindërore ushtrohet nga prindi tjetër.

Neni 226

Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës

Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë zgjidhur martesën, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore bëhet sipas Kreut III “Pasojat e zgjidhjes së martesës” të këtij Kodi.

Neni 223

Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës së lindur jashtë martese

Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës së lindur jashtë martese ushtrohet nga prindi që e ka njohur fëmijën si të tij. Në qoftë se ai është njohur nga të dy prindërit, përgjegjësinë prindërore e kanë të dy prindërit.

Me kërkesë të të atit, të nënës ose të prokurorit, gjykata mund të ndryshojë kushtet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe të vendosë që ai të ushtrohet nga njëri prind ose nga të dy bashkërisht. Gjykata në këtë rast vendos se me cilin prind do të banojë fëmija.

Gjykata vendos për të drejtën e vizitës dhe të mbikëqyrjes së prindit, me të cilin fëmija nuk banon.

Neni 228

Heqja e përgjegjësisë prindërore

Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore.

Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje.

Neni 229

Gjykata vendos që heqja e përgjegjësisë prindërore të shtrihet mbi të gjithë ose mbi disa nga fëmijët e lindur para vendimit të gjykatës për heqjen e përgjegjësisë.

Heqja e përgjegjësisë prindërore e shkarkon fëmijën nga detyrimi për ushqim ndaj prindërve, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe.

Neni 230

Kthimi i përgjegjësisë prindërore

Përgjegjësia prindërore mund të kthehet me vendim të gjykatës, kur pushon shkaku për të cilin është hequr kjo përgjegjësi.

KREU III

PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE PËR PASURINË E FËMIJËS

Neni 231

Përfaqësimi dhe administrimi

Prindërit e fëmijës kanë të drejtën e administrimit dhe të përdorimit të pasurisë së fëmijës së tyre.

Neni 232

Prindërit përfaqësojnë fëmijën e tyre të mitur që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, i mituri mund t'i kryejë vetë.

I mituri që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç i kryen vetë veprimet juridike, por kurdoherë me pëlqimin paraprak të prindërve, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, mund t'i kryejë vetë.

Neni 233

Pasuria e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës, kurse pasuria e të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve.

Neni 234

Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit.

Veprimi juridik, që është kryer pa u marrë autorizimi i gjykatës, mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e prokurorit, të prindit ose të kujdestarit të të miturit.

Në qoftë se gjykata jep pëlqimin më vonë, veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm.

Neni 235

Përdorimi i të ardhurave të fëmijës

Prindërit mund të përdorin të ardhurat nga pasuria e fëmijës, që ata administrojnë, për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e tij.

Ata mund t'i përdorin këto të ardhura, për të plotësuar nevojat e domosdoshme të familjes, kur nuk kanë pasuri të mjaftueshme për t'i plotësuar vetë ato. Të ardhurat e mbetura kthehen në pasurinë e fëmijës.

Neni 236

Administrimi i pasurisë

Administrimi i pasurisë së fëmijës bëhet nga të dy prindërit bashkërisht, në rastin kur ata e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkërisht dhe në

rastet e tjera ose nga i ati apo nga nëna nën kontrollin e gjykatës, sipas neneve 234 dhe 235 të këtij Kodi.

E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës është e lidhur me të drejtën e administrimit ligjor. Kjo e drejtë u takon të dy prindërve bashkërisht ose atij që është i ngarkuar me administrimin e pasurisë së fëmijës.

Neni 237

E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës nga prindi pushon:

- a) kur fëmija bëhet madhor;
- b) për shkaqet për të cilat merr fund përgjegjësia prindërore ose administrimi ligjor;
- c) për të gjitha shkaqet që lidhen me marrjen fund të uzufruktit.

Neni 238

Detyrimet që lidhen me të drejtën e përdorimit të pasurisë së fëmijës janë:

- a) detyrimet që kanë personat që gëzojnë të drejtën e uzufruktit në një pasuri;
- b) detyrimi për ushqim, mirëritje, edukim dhe arsimim të fëmijës, në bazë të pasurisë.

Neni 239

E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës nuk shtrihet mbi pasurinë që ai fiton nga puna e tij, as mbi pasurinë që i është dhuruar ose që i ka kaluar me trashëgimi, kur prindi është ndaluar shprehimisht të ketë të drejtën e përdorimit mbi këtë pasuri.

TITULLI IV

BIRËSIMI

Neni 240

Interesi i të miturit

Birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore.

Neni 241

Kushtet e birësimit

Birësohet vetëm i mituri.

Birësuesi duhet të ketë një diferencë moshe të paktën 18 vjet me të birësuarin.

Në qoftë se birësohet fëmija i bashkëshortit, diferenca e moshës duhet të jetë jo më pak se 15 vjet.

Neni 242

I mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë.

Birësimi i ri lejohet pas vdekjes së birësuesit ose të birësuesve apo pas vdekjes së njërit prej birësuesve, në qoftë se kërkesa është paraqitur nga bashkëshorti i ri i birësuesit.

Neni 243

Ndalimet e birësimit

Nuk mund të birësohet një person nga të paralindurit e tij, si edhe vëllai nga motra dhe anasjelltas.

Neni 244

Nuk mund të birësohet një person nga kujdestari i tij, pa u parë përpara nga gjykata administrimi i pasurisë së të miturit prej tij, dorëzimi i pasurisë

së të miturit, si dhe vlerësimi i detyrimeve në ngarkim të kujdestarit ose dhënia e garancisë nga kujdestari për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Neni 245

Personi nuk mund të birësojë kur:

- a) i është hequr nga gjykata përgjegjësia prindërore;
- b) vuan nga një sëmundje psikike ose ka zhvillim mendor të metë, si dhe vuan nga një sëmundje, e cila mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e atij që do të birësohet;
- c) nuk ka garancinë si person, se do të kryejë në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e atij që do të birësohet.

Neni 246

Pëlqimi për birësim

Për birësimin e të miturit kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të tij.

Në qoftë se njëri nga të dy prindërit ka vdekur, nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose i është hequr përgjegjësia prindërore, pëlqimi i prindit tjetër është i mjaftueshëm.

Kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre u është hequr zotësia për të vepruar ose janë të panjohur, gjykata vendos nëse fëmija duhet të birësohet.

Kur birësuesi është i martuar, duhet të merret pëlqimi i bashkëshortit të tij.

Kur i birësuari ka mbushur moshën dhjetë vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën dymbëdhjetë vjeç kërkohet pëlqimi i tij.

Neni 247

Pëlqimi për birësim jepet përpara gjykatës kompetente. Në rast se personi ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij në një shtet tjetër, mund të japë pëlqimin para agjentit diplomatik ose konsullor pranë ambasadës ose konsullatës shqiptare.

Neni 248

Pëlqimi për birësim mund të tërhiqet nga prindërit biologjikë, brenda 3 muajve nga çasti i dhënies së tij.

Kjo periudhë shërben edhe si periudhë provë për marrëdhëniet midis birësuesve dhe të birësuarit.

Periudha e provës shërben për të vendosur një marrëdhënie birësuese midis një fëmije dhe një familjeje.

Prindërit mund të tërheqin pëlqimin e tyre edhe pas kalimit të afatit tremujor, deri në çastin e marrjes së vendimit nga gjykata kompetente.

Gjykata, përpara se të vendosë, duhet të verifikojë nëse janë plotësuar afatet e mësipërme, nëse janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për kthimin e fëmijës pranë prindërve biologjikë dhe nëse gjatë bashkimit ka funksionuar marrëdhënia e të miturit me birësuesit.

Në qoftë se personi, që i është besuar fëmija gjatë periudhës së provës dhe më pas, refuzon ta kthejë atë, prindërit mund t'i drejtohen gjykatës, e cila mund të vendosë kthimin e fëmijës në rast se kjo është në interesin e tij.

Neni 249

Nëse birësuesi vdes pasi ka dhënë pëlqimin dhe para dhënies së vendimit, gjykata mund të vazhdojë procedurën e gjykimit për përfundimin e birësimit.

Trashëgimtarët e birësuesit mund të paraqesin në gjykatë pretendime për të kundërshtuar birësimin.

Nëse birësimi pranohet nga gjykata, ai sjell efekte që nga çasti i dhënies së pëlqimit nga birësuesi.

Neni 250

Deklarimi i braktisjes

Gjykata e rrethit mund të deklarojë të braktisur të miturin që ndodhet pranë një institucioni të përkujdesjes sociale, publik ose privat, ose te personi që e ka në përkujdesje, kur prindërit e tij, në mënyrë të dukshme, nuk janë interesuar për të gjatë një viti, përpara paraqitjes së kërkesës për

deklarimin e braktisjes.

Kur i mituri ka qenë strehuar që nga lindja e tij në një institucion, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj.

Konsiderohen në mënyrë të dukshme të paiteruesuar për fëmijën prindërit që vullnetarisht nuk kanë mbajtur marrëdhënie të përzemërta të nevojshme për rritjen e tij dhe që kanë treguar pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

Gjykata i kërkon personit që ka paraqitur kërkesën shpjegime nëse ka bërë përkjekje për gjetjen e prindërve biologjikë të fëmijës dhe kthimin e fëmijës në familjen biologjike, nëse kjo është e mundur.

Braktisja nuk deklarohet kur, gjatë afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, një anëtar i familjes ka kërkuar të marrë përsipër rritjen e fëmijës dhe kjo kërkesë është konsideruar në përputhje me interesin e fëmijës.

Neni 251

Kërkesa për deklarimin e braktisjes bëhet nga drejtuesi i institucionit ku ndodhet fëmija ose nga personi që e ka në përkujdesje. Kërkesa i dërgohet gjykatës, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni ose vendbanimi i personit që e ka marrë në përkujdesje të miturit.

Çdo person që ka një interes ligjshëm për mbrojtjen e fëmijës, mund të ndërhyjë në procesin e gjykimin.

Gjykata, që deklaron të braktisur të miturin, cakton në të njëjtin vendim edhe kujdestarin për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës, një institucion të përkujdesjes sociale ose një person të caktuar, nisur nga interesi më i lartë i të miturit.

Neni 252

Paraqitja e kërkesës

Personat që dëshirojnë të birësojnë të mitur shqiptarë mund të birësojnë vetëm të miturit që figurojnë në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Komiteti Shqiptar i Birësimit është autoritet qendror i pavarur, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë.

Shtetasit e huaj nuk mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit Shqiptar

të Birësimit.

Kërkesa e tyre i paraqitet Komitetit Shqiptar të Birësimit nëpërmjet autoriteteve publike kompetente ose organizmave private të parashikuar në ligj. Kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuara, sipas ligjit të vendit ku jeton birësuesi.

Shtetasit shqiptarë që kanë vendbanimin e tyre jashtë vendit dhe shtetasit e huaj rezidentë prej 2 vjetësh në Shqipëri, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Neni 253

Detyrimi i Komitetit Shqiptar të Birësimit

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve përkatëse, Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon gjykatës studimin për personin që kërkon të birësojë dhe atë të të miturit që mund të birësohet.

Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon gjykatës edhe pëlqimin me shkrim për këtë birësim dhe për birësimet ndërvendase, si dhe konfirmimin se i mituri nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri për një afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit në listat e këtij Komiteti.

Neni 254

Gjykata kompetente

Kërkesa për birësim, e bërë nga një shtetas shqiptar, bëhet në gjykatën e vendbanimit të personit që kërkon të birësojë.

Kërkesa për birësim, e bërë nga një shtetas i huaj ose shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën nën juridiksionin e së cilës ndodhet vendbanimi i të miturit.

Kërkesa për birësimin e të miturit shqiptar që banon jashtë shtetit paraqitet në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 255

Ndërhyrja në proces

Çdo person që ka një interes të ligjshëm për mbrojtjen e të miturit si

dhe prokurori mund të ndërhyjë në procesin e birësimit, si dhe kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës.

Neni 256

Në rast se gjatë procedurës për birësimin e një fëmije rezulton se është paraqitur një kërkesë në gjykatë, për njohje atësie, procedura pezullohet deri në përfundim të gjykimit për njohjen e atësisë.

Neni 257

Ndalimet për birësimin ndërvendas

Kushtet dhe efektet e birësimit të shpallur në Shqipëri përcaktohen nga legjislacioni shqiptar.

Birësimi ndërvendas nuk lejohet kur:

- a) birësimi nuk njihet në shtetin ku banojnë birësuesit;
- b) arrihet në përfundimin së birësimi është me pasojë të rënda për të miturin;
- c) i mituri, në shtetin ku banojnë birësuesit, nuk gëzon të njëjtat të drejta që njihen në Shqipëri.

Birësimi ndërvendas lejohet pasi fëmija ka qëndruar në pritje për 6 muaj në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimit dhe, gjatë kësaj periudhe, janë ezauruar të gjitha mundësitë për të bërë birësimin brenda vendit.

Neni 258

Efektet e birësimit

Birësimi i prodhon efektet e tij nga data që vendimi merr formë të prerë.

Birësimi është i përevokueshëm.

Gjykata i dërgon vendimin e formës së prerë për regjistrim zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar birësuesi.

Neni 259

Marrëdhëniet ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit

Me birësimin ndërmjet birësuesit dhe gjinisë së tij, nga njëra anë, dhe

të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga ana tjetër, lindin të drejta dhe detyra të njëjta me ato që kanë ndërmjet tyre personat që janë gjini. Të drejtat dhe detyrat ndërmjet të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga njëra anë, dhe gjinisë së tij, nga ana tjetër, pushojnë.

Kur njëri nga prindërit e të birësuarit është bashkëshort i birësuesit, i birësuari nuk i shkëput lidhjet me këtë prind dhe gjininë e tij.

Neni 260

Atësia, mëmësia dhe mbiemri i të birësuarit

I birësuari merr mbiemrin e birësuesit dhe në rast të birësimit nga të dy bashkëshortët, mbiemrin e përbashkët të tyre; në qoftë se ata kanë mbiemra të ndryshëm vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë i birësuari; në rast mosmarrëveshjeje fëmija merr mbiemrin e të atit.

Me kërkesë të birësuesit ose të birësuesve, gjykata mund të ndryshojë emrin e të birësuarit.

I birësuari merr për emër nënë dhe ati atë të birësuesit ose birësuesve të tij.

Neni 261

Për birësimin surrogativ, të parashikuar në ligjin nr.8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”, zbatohen të njëjtat kritere dhe procedura për birësimin, sipas këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës.

Neni 262

I mituri, prindërit biologjikë dhe birësuesit kanë të drejtën e mirëbesimit për procesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje të respektimit të jetës private.

Kur moshë dhe niveli i pjekurisë e lejojnë, i mituri ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur, me të dhënat për prindërit biologjikë.

TITULLI V

KUJDESTARIA

KREU I

KUJDESTARIA MBI TË MITURIT

Neni 263

Vendosja e kujdestarisë

Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.

Neni 264

E drejta për paraqitjen e kërkesës

Të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë:

- a) të afërmit e fëmijës së mitur;
- b) cilido që merr njoftim për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur;
- c) vetë i mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç;
- ç) prokurori;
- d) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari.

Neni 265

Gjykata vendos si kujdestar personin e caktuar nga prindi, që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, me testament ose deklaratë noteriale. Kujdestari i caktuar, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nuk është i

detyruar të pranojë kujdestarinë.

Në rastet kur kujdestari i caktuar sipas këtij neni nuk plotëson kushtet e kërkuara nga ky Kod, kujdestaria vendoset nga gjykata.

Neni 266

Familja kujdestare

Familja kujdestare është një familje alternative, e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale.

Evidentimi i familjeve kujdestare është përgjegjësi e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social pranë bashkisë ose komunës ku banon i mituri, e cila realizohet me firmosjen e një deklarate gatishmërie nga familja për të marrë fëmijë në kujdestari.

Numri i fëmijëve që i jepen në kujdestari një familjeje kujdestare duhet të jetë i kufizuar, duke u dhënë prioritet në këtë vendosje fëmijëve që janë vëllezër dhe motra me njëri-tjetrin.

Neni 267

Në rast se nuk është caktuar kujdestar nga prindi që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, gjykata i jep prioritet zgjedhjes së kujdestarit midis paraardhësve, personave të afërt të të miturit, një familjeje kujdestare dhe, si alternativë të fundit, institucionin publik ose privat.

Para se gjyqtari të caktojë kujdestarin, duhet të dëgjojë personin e zgjedhur si të tillë dhe të marrë mendimin e të miturit nëse ai ka mbushur moshën dhjetë vjeç.

Gjykata, në çdo rast, merr mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës së vendit ku zhvillohet gjykimi, i cili përmban ekzaminimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës në kontekstin familjar edukativ e social dhe ekzaminimin e kushteve dhe përshtatshmërisë së fëmijës me personin kujdestar të ardhshëm, të familjes kujdestare ose institucionit të përkujdesjes.

Caktimi i kujdestarit nga gjykata bëhet duke parë cilësitë e personit kujdestar, të familjes kujdestare të zgjedhur ose të institucionit të përkujdesjes, sipas paragrafit të tretë të këtij neni, si dhe pasi ka dëgjuar

mendimin e një psikologu, që duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit.

Neni 268

Njoftimi i gjykatës

Nëpunësi i gjendjes civile, që merr njoftimin për vdekjen e të dy prindërve ose prindit të vetëm, që ka lënë fëmijë në moshë të mitur, ose të lindjes së një fëmije nga prindër të panjohur, dhe noteri që çel një testament, ku parashikohet caktimi i një kujdestari, duhet të njoftojnë gjykatën për faktin brenda 10 ditëve.

Njoftimi i gjykatës mund të bëhet edhe nga të afërmit e të miturit ose persona të tjerë të interesuar.

Gjykata, brenda 30 ditëve nga marrja njoftim ose nga paraqitja e kërkesës, vendos për caktimin e kujdestarit të të miturit.

Neni 269

Kujdestaria mbi disa të mitur

Për të miturit që janë vëllezër e motra caktohet një kujdestar i vetëm, përveç rastit kur rrethanat e veçanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të më shumë se një kujdestari.

Neni 270

Paaftësia dhe papajtueshmëria për të qenë kujdestar

Nuk mund të caktohet kujdestar personi që:

- a) është vetë në kujdestari;
- b) ka konflikt interesash me të miturin;
- c) nuk ka administrimin e lirë të pasurisë së tij;
- ç) është përjashtuar nga kujdestaria për shkak të deklarimit me shkrim të prindit që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore;
- d) ka humbur ose i është hequr përgjegjësia prindërore, ose i është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;
- dh) është i dënuar me burgim për një vepër penale dhe është gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe kur është dënuar për krime ndaj të miturve.
- e) ka mbushur moshën 65 vjeç;

- ë) për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nuk mund ta ushtrojë me lehtësi kujdestarinë;
- f) ushtron përgjegjësinë prindërore në më shumë se tre fëmijë;
- g) është i ngarkuar me më shumë se dy kujdestari;
- gj) nuk jep pëlqimin për të qenë kujdestar.

Neni 271

Kujdestaria në institucionet e përkujdesjes

Kujdestaria mbi të miturin, i cili nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licencuar për përkujdesjen e fëmijëve.

Drejtuesi i institucionit i delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit.

Drejtuesi i institucionit, brenda 10 ditëve nga caktimi i personit që merr funksionet e kujdestarit, i dërgon gjykatës aktin përkatës, i cili depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë.

Neni 272

Funksionet e kujdestarit

Kujdestari kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë në të gjitha veprimet juridike dhe administron pasurinë e tij, sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 273

Detyrat e të miturit

I mituri duhet ta respektojë dhe t'i bindet kujdestarit. Ai nuk mund të braktisë banesën ose institucionin ku është lënë pa lejen e kujdestarit.

Kur largohet pa leje, kujdestari ka të drejtë ta kërkojë të miturin dhe, nëse është e nevojshme, t'i drejtohet gjykatës për kthimin e tij.

Gjatë gjykimit duhet të dëgjohet dhe i mituri që ka mbushur moshën dhjetë vjeç, në praninë e psikologut.

Neni 274

Rastet e kujdestarisë së posaçme

Gjykata vendos caktimin e një kujdestari të posaçëm kur:

- a) ka konflikt interesash midis të miturit dhe prindërve ose midis të miturit dhe kujdestarit të tij, si dhe kur midis tyre duhet të kryhet një veprim juridik;
- b) ka konflikt interesash midis të miturve, vëllezër dhe motra, që kanë të njëjtin kujdestar ose kur duhet të kryhet një veprim juridik midis tyre;
- c) për shkak sëmundjeje ose për shkaqe të tjera, kujdestari i caktuar pengohet të kryjë një veprim të caktuar ose të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi.

Neni 275

Caktimi i kujdestarit të posaçëm

Kujdestari i posaçëm caktohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës së prindit, të kujdestarit, së të afërmeve të të miturit, të miturit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personave të interesuar.

Neni 276

Me caktimin e kujdestarit të posaçëm, gjykata cakton kufijtë e detyrave dhe të drejtave të kujdestarit, sipas rrethanave të çdo rasti të veçantë.

Neni 277

Gjykata kompetente

Gjykatë kompetente për caktimin e kujdestarit të posaçëm është ajo e vendbanimit ose e vendqëndrimit të të miturit, ose e vendit ku ndodhet pasuria e tij.

Neni 278

Funksionet e kujdestarit të posaçëm

Kujdestari i posaçëm përfaqëson të miturin në rastet kur interesi i tij është

në konflikt me interesin e kujdestarit.

Kur kujdestari i posaçëm ndodhet në konflikt interesash me të miturin, gjyqtari emëron një kujdestar tjetër.

Kujdestari i posaçëm duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari të ri në rastin kur kujdestari nuk kryen ose braktis detyrën. Kujdestari i posaçëm kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e pasurisë në raste urgjente.

Neni 279

Dhurimi ose disponimi me testament

Dhuruesi ose personi që disponon me testament në favor të një të mituri, edhe pse ky i fundit është nën përgjegjësinë e prindërve të tij, mund t'i caktojë atij një kujdestar të posaçëm për pranimin dhe administrimin e pasurisë së dhuruar ose të lënë atij me testament.

Nëse dhuruesi ose testatori nuk ka vendosur ndryshe, kujdestari i posaçëm duhet të ushtrojë të drejtat dhe detyrat e tij, sipas dispozitave për administrimin të këtij Kodi.

Neni 280

Mbarimi i kujdestarisë së posaçme

Kujdestaria e posaçme mbaron kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur. Mbarimi i kujdestarisë së posaçme bëhet me kërkesën e personave, sipas nenit 275 të këtij Kodi.

Neni 281

Masa urgjente

Përpara se kujdestari të marrë përsipër funksionet e tij, i takon gjyqtarit që, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të prokurorit, të një të afërmi ose të çdo personi të interesuar, të vendosë një kujdestar të përkohshëm ose të marrë masa të tjera urgjente që janë të nevojshme për mbrojtjen e të miturit ose për të ruajtur dhe administruar pasurinë e tij.

Neni 282

Inventari

Kujdestari, brenda 10 ditëve pasi ka marrë njoftimin ligjor për emërimin e tij, duhet të procedojë me inventarin e pasurisë së të miturit. Inventari duhet të bëhet brenda 30 ditëve.

Me kërkesën e kujdestarit, gjyqtari mund të zgjasë afatin e mësipërm, nëse rrethanat e kërkojnë atë.

Neni 283

Inventari bëhet në praninë e noterit, me pjesëmarrjen e kujdestarit dhe, nëse është e mundur, të të miturit që ka mbushur moshën dhjetë vjeç, si dhe në praninë e dy dëshmitarëve të zgjedhur nga gjykata, mundësisht midis të afërmve ose miqve të familjes. Gjyqtari mund të lejojë që inventari të bëhet pa praninë e noterit, nëse vlera e supozuar e pasurisë nuk e kalon shumën 50 mijë lekë.

Inventari depozitohet pranë gjykatës.

Neni 284

Përmbajtja e inventarit

Në inventar përfshihen pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, kreditë dhe debitë dhe përshkruhen dokumentet, shënimet dhe shkresat e lidhura me gjendjen e aktivit dhe pasivit të pasurisë, duke iu përmbajtur formaliteteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 285

Nëse në pasurinë e të miturit ka ndërmarrje, shoqëri, shoqëri tregtare ose bujqësore, procedohet sipas legjislacionit përkatës për hartimin e inventarit të ndërmarrjes ose të shoqërisë dhe në përputhje me nenin 283 këtij Kodi. Ky inventar depozitohet pranë gjykatës dhe i shtohet inventarit të përmendur në nenin 284 të këtij Kodi.

Neni 286

Administrimi nga kujdestari

Para se të bëhet inventari, administrimi i pasurisë nga kujdestari duhet të kufizohet në çështjet që, nga vetë natyra e tyre, janë të ngutshme.

Neni 287

Pas inventarit, gjykata, me propozim të kujdestarit, vendos për vazhdimin e veprimtarisë, tjetërsimin ose likuidimin e ndërmarrjes, shoqërisë, shoqërisë tregtare ose bujqësore, që janë pasuri e të miturit, si dhe për mënyrat përkatëse dhe masat paraprake.

Gjatë gjykimit, gjykata mund të lejojë funksionimin e përkohshëm të ndërmarrjes.

Neni 288

Pasuria e administruar nga kujdestari i posaçëm

Kujdestari duhet të përfshijë në inventarin e pasurisë së të miturit edhe pasuritë, administrimi i të cilave i është dhënë një kujdestari të posaçëm. Nëse ky ka bërë një inventar të veçantë për këto pasuri, duhet t'i japë kopje kujdestarit, i cili e bashkon me inventarin e përmendur në nenin 284 të këtij Kodi.

Kujdestari i posaçëm duhet t'i japë kujdestarit kopje të llogarive periodike të administrimit të pasurisë, përveçse kur disponuesi me testament ose dhuruesi e ka përjashtuar këtë.

Neni 289

Deklarimi i debive ose kredive të kujdestarit

Kujdestari që ka debi, kredi ose deklarime të tjera kundrejt të miturit, duhet t'i bëjë të ditura para mbylljes së inventarit.

Kancelari i gjykatës ka detyrimin që ta pyesë lidhur me këto deklarime. Në rast të inventarit të bërë pa pjesëmarrjen e kancelarit të gjykatës, kujdestari pyetet nga gjyqtari lidhur me aktin e depozitimit.

Në çdo rast, fakti i pyetjes ose deklarimit të kujdestarit duhet përmendur

në inventar ose në procesverbalin e depozitimit.

Neni 290

Mungesa e deklarimit

Kujdestari humbet çdo të drejtë, në qoftë se, duke qenë në dijeni të kredisë ose të të drejtave të tij, nuk i ka deklaruar edhe pse është pyetur shprehimisht.

Kujdestari shkarkohet nga detyra kur, duke e ditur që është debitor, nuk ka deklaruar borxhin e tij.

Neni 291

Depozitimi i parave, titujve dhe objekteve

Kujdestari duhet të depozitojë paratë, titujt e kredive të prurësi dhe objektet me vlerë që ekzistojnë në pasurinë e të miturit pranë një banke ose instituti tjetër krediti, të përcaktuar nga gjykata, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe lidhur me ruajtjen e tyre.

Kujdestari nuk është i detyruar të depozitojë shumat që nevojiten për shpenzimet urgjente lidhur me të miturin.

Neni 292

Kapitalet e të miturit, me autorizim paraprak të gjykatës, mund të investohen nga kujdestari, në rastet që e shikon të përshtatshme dhe në interes të të miturit.

Neni 293

Autorizimi i gjykatës

Kujdestari, pa autorizim të gjykatës, nuk mund:

- a) të blejë pasuri, përveç sendeve të luajtshme të nevojshme për përdorim nga i mituri, për ekonominë shtëpiake dhe për administrimin e pasurisë;
- b) të marrë kapitale, të lejojë heqjen e hipotekave ose zgjidhjen e pengut, të marrë përsipër detyrime, me përjashtim të rastit kur këto lidhen me

shpenzimet e nevojshme për mbajtjen e të miturit dhe për administrimin e zakonshëm të pasurisë të tij;

c) të pranojë trashëgimi ose të heqë dorë prej saj, të pranojë dhurime ose leg, që janë me barrë ose me kusht;

ç) të lidhë kontrata qiraje të pasurive të paluajtshme për një afat mbi 9 vjet ose që në çdo rast zgjasin më shumë se 1 vit pasi i mituri ka mbushur moshën madhore;

d) të ngrejë padi, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për kallëzim të një punimi të ri ose të dëmit të mundshëm, të padive të posedimit, ose për nxjerrjen nga shtëpia të qiramarrësit, dhe të padive për kërkimin e fryteve ose për marrjen e masave konservative;

dh) të tjetërsojë pasurinë e të miturit, përveç fryteve dhe të mirave të luajtshme që dëmtohen lehtësisht;

e) të krijojë pengje ose hipoteka;

ë) të fillojë procedurën e pjesëtimit të pasurisë ose të ngrejë padinë përkatëse;

f) të bëjë premtime dhe transaksione ose të pranojë marrëveshje.

Neni 294

Shitja e pasurisë

Në autorizimin për shitjen e pasurisë, gjykata vendos nëse shitja duhet bërë me ose pa ankand, duke përcaktuar në çdo rast çmimin minimal.

Kur në autorizim nuk është përcaktuar mënyra e shpërndarjes ose riinvestimit të të ardhurave të realizuara nga shitja, këtë e vendos gjykata në një autorizim të mëvonshëm.

Neni 295

Veprimet e kryera në kundërshtim me nenet paraardhëse

Çdo veprim që kujdestari kryen në kundërshtim me ligjin është i pavlefshëm.

Kujdestari, i mituri, trashëgimtarët e tij ose personat që kanë interes, mund të kërkojnë pavlefshmërinë e veprimeve të kryera në kundërshtim me Kreun I të Titullit V “Kujdestaria” të këtij Kodi.

Neni 296

Ndalimet për kujdestarin dhe kujdestarin e posaçëm

Kujdestari dhe kujdestari i posaçëm as me ankand nuk mund të bëhen blerës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave të tjerë, të pasurisë dhe të të drejtave të të miturit. Ata nuk mund të marrin me qira pasuritë e të miturit pa autorizimin dhe masat mbrojtëse të vendosura nga gjykata. Personat e përcaktuar në nenin 295 të këtij Kodi mund të kërkojnë pavlefshmërinë e veprimeve të kryera në kundërshtim me ndalimet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, me përjashtim të kujdestarit dhe kujdestarit të posaçëm që i kanë kryer ato.

Neni 297

Shpërblimi i kujdestarit

Detyra e kujdestarit është pa pagesë.

Gjykata, duke pasur parasysh madhësinë e pasurisë dhe vështirësitë e administrimit ose shërbimit për të miturin, mund t'i caktojë kujdestarit një kompensim të arsyeshëm nga pasuria e të miturit.

Nëse e kërkojnë rrethanat e veçanta, gjykata, pasi ka dëgjuar kujdestarin e posaçëm, mund të autorizojë kujdestarin që të caktojë si zëvendës të tij në administrim, nën përgjegjësinë e tij vetjake, një ose më shumë persona me pagesë.

Neni 298

Mbajtja e kontabilitetit

Kujdestari duhet të mbajë kontabilitetin e rregullt të administrimit të pasurisë dhe t'i japë llogari një herë në vit gjyqtarit.

Gjyqtari mund t'ia nënshtrojë kontabilitetin e administrimit të pasurisë shqyrtimit vjetor nga ana e kujdestarit të posaçëm ndonjë të afërmi ose një personi në lidhje krushqie me të miturin.

Neni 299

Përgjegjësia e kujdestarit dhe kujdestarit të posaçëm

Kujdestari duhet ta administrojë pasurinë e të miturit me kujdesin e një prindi të mirë.

Kujdestari detyrohet të shpërblejë të miturin për të gjitha dëmet që i ka shkaktuar këtij në kryerjen e parregullt të detyrës, ose për shkak të lënies pa arsye të detyrës së kujdestarit.

Të njëjtën përgjegjësi ka edhe kujdestari i posaçëm, për aq sa lidhen me detyrat e tij.

Neni 300

Zëvendësimi i kujdestarit

Gjykata e heq kujdestarin dhe e zëvendëson atë me një tjetër kur vëren se ai shpërdoron të drejtat e tij, tregohet i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës ose, në mënyra të tjera, vë në rrezik interesat e të miturit, si dhe kur vetë kujdestari kërkon largimin e tij për shkaqe të arsyeshme. Kërkesa për zëvendësimin e kujdestarit mund të bëhet nga personat e interesuar ose prokurori.

Në këto raste gjykata dëgjon më parë pretendimet e kujdestarit.

Neni 301

Dorëzimi i pasurisë

Me mbarimin e kujdestarisë ose zëvendësimin e saj, kujdestari duhet të bëjë menjëherë dorëzimin e pasurisë së të miturit, sipas rastit, të miturit që është bërë madhor, trashëgimtarëve të tij ose kujdestarit të ri.

Brenda 2 muajve nga çasti i mbarimit ose zëvendësimit, kujdestari i paraqet gjykatës llogarinë përfundimtare të administrimit të pasurisë.

Gjykata, kur ka shkaqe të arsyeshme, vendos shtyrjen e dorëzimit të llogarisë tej këtij afati.

Neni 302

Miratimi i llogarisë

Gjykata thërret kujdestarin e posaçëm, të miturin që ka mbushur moshën madhore, nëse është rasti kujdestarin e ri dhe, në rast të vdekjes së të miturit, trashëgimtarët e tij, për të shqyrtuar llogarinë dhe për të bërë vërejtjet përkatëse.

Nëse nuk ka vërejtje dhe parregullsi ose mangësi në llogari, gjykata e miraton atë.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim nga kujdestari ose nga personat e tjerë të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 303

Parashkrimi i padive për kujdestarinë

Paditë e të miturit kundër kujdestarit dhe ato të kujdestarit kundër të miturit, për kujdestarinë, parashkruhen brenda 5 vjetëve, pasi i mituri ka mbushur moshën madhore ose ka vdekur.

Nëse kujdestari ka paraqitur llogarinë përpara se i mituri të mbushë moshën madhore ose përpara vdekjes, afati fillon nga data kur gjyqtari ka marrë vendim mbi llogarinë.

Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për padinë e pagimit të diferencës që rezulton nga llogaria përfundimtare.

Neni 304

Ndalimi i marrëveshjes para miratimit të llogarisë

Midis kujdestarit dhe të miturit që ka arritur moshën madhore nuk mund të bëhet asnjë marrëveshje përpara miratimit të llogarisë së paraqitur nga kujdestari.

I mituri që ka arritur moshën madhore, trashëgimtarët e tij ose ata që kanë një interes të ligjshëm mund t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e marrëveshjes së bërë, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 305

Regjistri i kujdestarisë

Në regjistrin e kujdestarisë, që ndodhet pranë gjykatës, nën përkujdesjen e kancelarit të gjykatës, regjistrohen vendosja dhe mbarimi i kujdestarisë, përjashtimi ose shkarkimi nga detyra i kujdestarit ose kujdestarit të posaçëm, rezultatet e inventarëve dhe të llogarive, raportet vjetore të përcaktuara në nenin 302 të këtij Kodi dhe të gjitha masat që sjellin ndryshime në statusin vetjak ose pasuror të të miturit.

Për vendosjen dhe mbarimin e kujdestarisë, kancelari i gjykatës njofton brenda 10 ditëve nëpunësin e gjendjes civile për të bërë shënimin në aktin e lindjes së të miturit.

Neni 306

Mbarimi i kujdestarisë

Kujdestaria mbaron kur fëmija:

- a) bëhet madhor;
- b) vdes;
- c) fiton zotësinë për të vepruar me martesë.

KREU II

KUJDESTARIA MBI PERSONAT QË U ËSHTË HEQUR OSE KUFIZUAR ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR

Neni 307

Gjykata, në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar.

Neni 308

Dispozitat e kujdestarisë për të miturit zbatohen edhe për kujdestarinë e personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar,

përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

Neni 309

Kujdestari i personit, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, përfaqëson dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi përfaqëson dhe administron pasurinë e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.

Kujdestari i personit, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, jep pëlqimin dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi jep pëlqimin dhe administron pasurinë e të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.

Neni 310

Kujdestari i personit, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, detyrohet të kujdeset për personin dhe sidomos për mjekimin e tij.

Neni 311

Të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe ndodhet nën përgjegjësinë prindërore, kur i hiqet zotësia për të vepruar, nuk i caktohet kujdestar, por vazhdon të jetë nën kujdesin e prindërve, si i mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.

Kur i mituri bëhet madhor dhe nuk i është kthyer zotësia për të vepruar, gjykata i cakton një kujdestar, që mund të jetë një nga prindërit ose një person tjetër.

Neni 312

Të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, kur ndodhet në kujdestari dhe gjatë kësaj kohe i hiqet zotësia për të vepruar, gjykata i cakton një kujdestar të ri ose vendos që kujdestari i tij të mbajë përsëri këtë detyrë.

Neni 313

Kujdestaria mbi personin, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, pushon kur kjo zotësi i është kthyer me vendim të gjykatës.

TITULLI VI

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 314

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 315

Bashkëpronësia e bashkëshortëve, e krijuar para hyrjes në fuqi të Kodit të Familjes, mund të ndryshojë me marrëveshje të bashkëshortëve, sipas dispozitave të këtij Kodi.

Pasuria që fitohet nga bashkëshortët pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, rregullohet nga ky Kod edhe për bashkëshortët që kanë lidhur martesë para hyrjes në fuqi të tij.

Neni 316

Për afatet e parashkrimit të padisë, që kanë filluar të ecin para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk janë plotësuar sipas dispozitave të mëparshme, zbatohen dispozitat e këtij Kodi.

Neni 317

Çështjet që janë në gjykim në datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi gjykohen sipas Kodit të mëparshëm, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Neni 318

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohen Kodi i Familjes, i miratuar me ligjin nr. 6599, datë 29.6.1982, dispozitat e ligjit nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes” që vijnë në kundërshtim me këtë Kod, nenet 86 e 87 të Kodit Civil, miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.6.1981, si dhe nenet 358-368 e 384 të Kodit të Proçedurës Civile, të miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996.

Neni 319

Ky ligj hyn në fuqi gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LIGJ

Nr. 9975, datë 28.7.2008

“PËR TAKSAT KOMBËTARE”

I azhurnuar me:

- Ligjin nr. 10065, datë 29.01.2009
- Ligjin nr. 10131, datë 11.05.2009
- Ligjin nr. 10 145, datë 28.9.2009

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton llojet e taksave kombëtare, që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave kombëtare.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Taksapagues” është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërin nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. “Taksë” është taksa kombëtare e vendosur me këtë ligj.
3. “Agjent i taksave” është personi, i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e

Buxhetit të Shtetit të të ardhurave nga taksat kombëtare.

Neni 3

Llojet e taksave kombëtare

Taksat kombëtare janë:

1. Taksa portuale.
2. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve.
3. Taksa e mjedisit, që përbëhet nga:
 - a) taksa e importimit të automjeteve të përdorura;
 - b) taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin;
 - c) taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve (bidonë, shishe plastike e kuti të plastifikuara, të të gjitha formave dhe përmasave), të mbushura, të prodhuara në vend dhe të importuara, për produktet si ujë, pije freskuese, lëngje frutash e perimesh, qumësht dhe nënproduktet e tij, vajra ushqimore, vajra lubrifikante dhe detergjentë.
4. Taksa e rentës minerare.
5. Taksa e akteve dhe e pullës.
6. Taksa për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive.
7. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit.

Neni 4

Niveli i taksave kombëtare

5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas lidhjes nr. 3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 5

Agjentët e taksave

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

a) për taksat portuale, kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore apo private;

b) për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet degëve në rrethe, kontrollon pagimin e taksës nga zotëruesit e mjeteve dhe, kur vëren se nuk është paguar, zbaton gjobë, të barabartë me masën e taksës. Kur taksa apo gjoba nuk paguhet brenda 10 ditëve, ajo bllokoi mjetin deri në pagesën e tyre. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa paguhet e plotë, pavarësisht nga data e regjistrimit dhe është e vlefshme për 365 ditë;

c) për taksën e mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për importimin e makinave të përdorura, për karburantin e importuar dhe për ambalazhet plastike të lëngjeve të importuara, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për karburantin e prodhuar në vend dhe për ambalazhet plastike të lëngjeve, të prodhuara në vend;

ç) për taksën e rentës minerare, organet doganore e tatimore;

d) për taksën e akteve dhe të pullës, zyrat e gjendjes civile;

dh) për taksat për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive, struktura përgjegjëse e lojërave të fatit në ministrinë përgjegjëse për financat ;

e) për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj në rrethe.

Neni 6

Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit dhe në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore

Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Agjentët e taksave janë të detyruar t'i transferojnë taksat e vjela në Buxhetin e Shtetit dhe në llogari të bashkive ose të komunave, sipas nenit 5 të këtij ligji, brenda datës 30 të muajit kur janë arkëtuar taksat.

Kur detyrimi për pagimin e taksave vjetore për herë të parë lind në 6-mujorin e parë, paguhet 100 për qind e taksës, ndërsa kur ky detyrim

lind në 6-mujorin e dytë, paguhet 50 për qind e masës së këtyre taksave.

Neni 7

Taksat që vilen nëpërmjet pullës

Taksat kombëtare, që vilen nëpërmjet pullës, janë taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve dhe taksa e akteve të gjendjes civile.

Neni 8

Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave

1. Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji dhe transferohen, sipas tarifave të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, në llogaritë e të ardhurave tatimore të Buxhetit të Shtetit dhe të buxhetit të njërive të qeverisjes vendore, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Agjentëve të taksave, për shërbimin që kryejnë, u jepet komisioni përkatës, në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje në bazë të masës së taksave që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore. Masa në përqindje e komisionit është si më poshtë:

a) për taksat portuale (kapitenerisë së porteve)

2 për qind;

b) për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve

8 për qind,

nga të cilat:

- Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor

6 për qind;

- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme

2 për qind.

c) për taksën e mjedisit

0 për qind;

ç) për taksën e akteve dhe të pullës

5 për qind;

d) për taksën e rentës minerare (Royalty)

0 për qind;

dh) taksa për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive, zero për qind.

3. Komisionet e përfituara përdoren:

- a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
- c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

Neni 9

Përfjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare

1. Përfjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve:

- a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;
- b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;
- c) invalidët tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status, në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti është në zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre vetjake dhe jo për veprimtari private.

Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" dhe të nenit 4 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtrojnë veprimtari private, nuk përfjashtohen nga pagimi i kësaj takse.

2. Përfjashtohen nga pagimi i taksës së mjedisit, për komponentin e taksës së importimit të mjeteve të përdorura, invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status, në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti importohet për zotërimin e tyre dhe

përdoret vetëm për nevojat e tyre vetjake dhe jo për veprimtari private.

3. Përfshihen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

- a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;
- b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

Neni 10

Shkeljet dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, përcaktohen sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen po sipas ligjit të procedurave tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Tarifa shërbimi

1. Përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:

- a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik Shqiptar;
- c) tarifë shërbimi konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit;
- ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- d) tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotevizive e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT);
- dh) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e kapitenerisë së porteve;

e) tarifa për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

ë) tarifa për qarkullimin e automjeteve të huaja e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

f) tarifa për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

2. Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.

Neni 12

Shfuqizimet

Ligji Nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 5862, datë 1.8.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi

SHTOJCA NR. 3

TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

Masa e taksës (në lekë)

1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit

50 lekë

2. Për lëshimin e dokumentit "Çertifikatë për lidhje martesë" në gjuhë të huaj

200 lekë

3. Për lëshimin e dokumentit "Çertifikatë lindjeje" në gjuhë të huaj

200 lekë

4. Për lëshimin e dokumentit "Çertifikatë martesë" në gjuhë të huaj

200 lekë

5. Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies së shtetësisë shqiptare

2 000 lekë

6. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit

1 000 lekë

7. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës

1 000 lekë

8. Për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve

1 000 lekë

LIGJ

Nr. 8389, datë 5.8.1998

PËR SHTETËSINË SHQIPTARË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shtetësia shqiptare është një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e ndërsjellta të personit fizik dhe të shtetit shqiptar.

Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 2

Është shtetas shqiptar:

- a) Çdo person, i cili ka pasur shtetësinë shqiptare deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji;
- b) Çdo person, që fiton shtetësinë shqiptare në bazë të këtij ligji.

Neni 3

Shtetasi shqiptar mundet të jetë edhe shtetas i një shteti tjetër.

Neni 4

Askujt nuk mund t'i hiqet arbitrarisht shtetësia shqiptare.

Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare me kusht që të ketë një shtetësi tjetër, të ketë fituar një shtetësi tjetër apo t'i jetë garantuar nga organet kompetente të shtetit të huaj dhënia e një shtetësie tjetër.

Neni 5

Fitimi dhe rifitimi i shtetësisë shqiptare, si dhe heqja dorë prej saj, nga të miturit bëhet me miratimin e prindërve. Çdo ndryshim në shtetësinë e të miturve, të moshës 14-18 vjeç, bëhet duke marrë edhe pëlqimin e fëmijës.

KREU II

FITIMI I SHTETËSISË SHQIPTARE

Neni 6

Shtetësia shqiptare fitohet me:

- a) lindje;
- b) natyralizim;
- c) birësim.

Neni 7

Fitimi i shtetësisë me lindje

Një fëmijë fiton shtetësinë shqiptare me lindje në rastet kur:

1. të dy prindërit, në kohën e lindjes së fëmijës, janë shtetas shqiptarë;
2. njëri prej prindërve, në kohën e lindjes së fëmijës, është shtetas shqiptar dhe fëmija lind në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përfshihen rastet kur prindërit, bashkërisht, vendosin që fëmija të fitojë shtetësinë e prindit tjetër;
3. ka lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe njëri prej

prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër është me shtetësi të panjohur ose pa shtetësi;

4. ka lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe njëri prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër ka një shtetësi tjetër, por të dy prindërit bien dakord që fëmija të marrë shtetësinë shqiptare.

Neni 8

1. Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë merr shtetësinë shqiptare në rast se ai është lindur nga prindër të panjohur, dhe si pasojë fëmija do të mbetet pa shtetësi.

Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur përpara se fëmija të ketë arritur moshën 14 vjeç, dhe ata janë me shtetësi të huaj, shtetësia shqiptare mund të hiqet më kërkesë të prindërve të njohur ligjrisht, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi si pasojë e këtij veprimi.

2. Një fëmijë i lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të marrë shtetësinë shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve.

Neni 9

Marrja e shtetësisë me natyralizim

Një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare me natyralizim e fiton atë në rast se plotëson kushtet e mëposhtme:

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç.

2. Të ketë banuar ligjrisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet.

3. Të ketë banesë dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme.

4. Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në një ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie.

Përrjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike.

5. Të ketë njohuri, të paktën fillestare, të gjuhës shqipe;

6. Pranimi i tij si shtetas shqiptar të mos prekë sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë ;

7. Të huajt, që ka mbushur moshën 18 vjeç, mund t'i jepet shtetësia shqiptare me natyralizim edhe në qoftë se nuk plotëson kushtet e këtij ligji, me përjashtim të pikës 6, në qoftë se Republika e Shqipërisë ka një interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombëtar.

Në rast se personi është pa shtetësi, kushtet e pikës 1, 3, 4 dhe 5 të këtij neni nuk merren parasysh.

Në rast se i huaji vërtetohet se është me origjinë shqiptare deri në dy shkallë, qoftë edhe nga njëri prind, koha e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë , e përmendur në pikën 2 të këtij neni, duhet të jetë të paktën 3 vjet. Të gjitha kushtet e tjera për fitimin e shtetësisë shqiptare të treguara në këtë nen, mbeten të paprekura.

Neni 10

I huaji që është i martuar me një shtetas shqiptar prej jo me pak se 3 vjetësh, në rast se dëshiron, mund të fitojë shtetësinë shqiptare me natyralizim edhe në qoftë se nuk plotëson kushtet e neni, 9, pikat 2 dhe 5. Në këtë rast i huaji duhet të ketë banuar, në mënyrë të vazhdueshme dhe të ligjshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën një vit.

Neni 11

Në rast se të dy prindërit fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tyre, nën moshën 18 vjeç, kur jeton me prindërit, bëhet gjithashtu shtetas shqiptar me kërkesën e prindërve dhe me pëlqimin e fëmijës, në qoftë se ky është në moshën 14-18 vjeç.

Në rast se njëri prej prindërve fiton shtetësinë shqiptare, fëmija i tij nën 18 vjeç bëhet shtetas shqiptar, nëse kjo kërkohet nga të dy prindërit, ose nga njëri prej prindërve kur prindi tjetër është pa shtetësi dhe fëmija ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë .

Neni 12

Fitimi i shtetësisë me birësim

Në rast se dy prindërit me shtetësi shqiptare birësojnë një të mitur të një shtetësie tjetër apo pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare.

I mituri i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur njëri prej prindërve është shqiptar dhe të dy prindërit, në çastin e birësimit, banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë , si dhe në çdo do rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi, si rezultat i birësimit.

Neni 13

Revokimi i vendimit për dhënien e shtetësisë

Vendimi për dhënien e shtetësisë shqiptare mund të revokohet në se vërtetohet se i huaji ose personi pa shtetësi, me vetëdije, kërkesën për marrjen e shtetësisë shqiptare e ka bazuar në të dhëna të pasakta ose në dokumente të falsifikuara.

Vendimi për marrjen e shtetësisë shqiptare, i dhënë në kushtet e paragrafit të mësipërm, revokohet edhe për fëmijët nën moshën 18 vjeç, të cilët e kanë fituar shtetësinë së bashku me prindërit e tyre, duke pasur gjithnjë parasysh interesin e fëmijës, si dhe faktin që fëmija të mos mbetet pa shtetësi.

Neni 14

Personi, i cili ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare për shkak të premtimit për fitimin e një shtetësie tjetër, e rifiton shtetësinë shqiptare në qoftë se nuk fiton shtetësinë e premtuar brenda një kohe të arsyeshme.

Edhe në këtë rast bëhet një kërkesë dhe paraqiten dokumentet e nevojshme.

KREU III

MBARIMI I SHTETËSISË SHQIPTARE

Neni 15

Shtetësia shqiptare merr fund me kërkesë të personit, kur ai plotëson kushtet e mëposhtme:

1. Ka mbushur moshën 18 vjeç.
2. Nuk mbetet pa shtetësi si rezultat i heqjes dorë nga shtetësia shqiptare, meqenëse ka shtetësi të huaj, fiton shtetësi të huaj ose garanton se do të fitojë shtetësi të huaj.
3. Është rezident në një shtet të huaj.
4. Nuk është në ndjekje penale për vepra penale, për të cilat, sipas legjislacionit shqiptar, parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 vjet.
5. Nuk ka detyrime ligjore ndaj autoriteteve shtetërore, personave juridikë dhe fizikë.

Vendimi për njohjen e faktit të heqjes dore nga shtetësia shqiptare mund të revokohet, kur vërtetohet se ish-shtetasi shqiptar, me vetëdije, ka përdorur të dhëna të pasakta ose dokumente të falsifikuara për lënien e shtetësisë .

Neni 16

Për të miturit shtetësia shqiptare mbaron kur të dy prindërit, të cilët, nga ana e tyre, kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, merren vesh që edhe fëmija e tyre ta lërë shtetësinë shqiptare.

Edhe kur njëri prej prindërve nuk është dakord që fëmija të humbasë shtetësinë shqiptare, fëmijës mund t'i hiqet shtetësia, në se çmohet se një gjë e tillë është në dobi të fëmijës dhe nëse fëmija ka apo do të marrë një shtetësi tjetër.

Fëmija i mitur e humbet shtetësinë shqiptare kur birësohet nga prindër të huaj dhe fiton, me këtë rast, një shtetësi të re.

KREU IV

PROÇEDURA QË NDIQET PËR HEQJEN DORE NGA SHTETËSIA SHQIPTARE, SI DHE PËR FITIMIN E RIFITIMIT E SAJ ME NATYRALIZIM

Neni 17

Kërkesa për fitimin, rifitimin ose heqjen dorë nga shtetësia shqiptare paraqitet në organet e Ministrisë së Rendit Publik të vendbanimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, në përfaqësitë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. e shoqëruar me dokumentet e kërkuara nga ky ligj.

Neni 18

Në rast se dokumentet e nevojshme nuk janë të plota, organet kompetente, brenda një muaji, ia kthejnë kërkuarit për plotësime të mëtejshme.

Neni 19

Ministria e Rendit Publik brenda 6 muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës së individit, në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare, vendos për paraqitjen ose jo të kërkesës për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë pranë Presidentit të Republikës.

Kërkesa e Ministrisë së Rendit Publik shoqërohet me dosjen e plote individuale të kërkuarit.

Vendimi për bërjen ose jo të kërkesës nga ana e Ministrisë së Rendit Publik i behet e njohur subjekteve të interesuara, të cilat, në rast se nuk janë dakord me përmbajtjen e tij, mund të ngrenë padi në gjykatën e rrethit Tirane.

Neni 20

Presidenti i Republikës, brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës së Ministrisë së Rendit Publik, nxjerr dekretin përkatës. Në rast se kërkesa

nuk është e plotë, materiali i kthehet për t'u plotësuar Ministrisë së Rendit Publik brenda 1 muaji nga dita e paraqitjes.

Kur janë kushtet e pikës 7 të nenit 9 të këtij ligji, dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nxirret edhe pa ndjekur procedurën e mësipërme.

Neni 21

Kopje e dekretit për fitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare u dërgohet Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Drejtësisë për të bërë veprimet e duhura. Dekreti botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 22

Personit që ka fituar shtetësinë shqiptare i jepet dokumenti përkatës, ndërsa atij që e ka humbur shtetësinë shqiptare i jepet një dokument identifikimi i përkohshëm,

Neni 23

Personi që fiton shtetësinë shqiptare me natyralizim betohet para nëpunësit të zyrës së regjistrimit të shtetasve për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Shtetësia shqiptare quhet efektivisht e fituar që nga dita e bërjes së betimit.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Personit që ka hequr dore nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk ka shtetësi tjetër, i rijipet shtetësia menjëherë, mbi bazën e kërkesës së paraqitur prej tij.

Neni 25

Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme që, në bashkëpunim, të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e procedurave të përmendura në këtë ligj.

Neni 26

Dekreti nr. 1874, datë 7.6.1954 “ Mbi shtetësinë shqiptare,” si dhe ndryshimet e tij tij mëvonshme shfuqizohen.

Neni 27

Shteti shqiptar ruan të drejtën që, në përputhje me frymën e konventave ndërkombëtare për mënjanimin e rasteve të dyshtetësisë dhe të pashtetësisë , t’i kërkojë shtetasit të vet ose kërkuesit të shtetësisë shqiptare të zgjedhë vetëm një shtetësi.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2188, datë 13.8.1998 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

LIGJ

Nr. 8442, Datë 21.1.1999

Për disa ndryshime në ligjin nr. 8389, datë 5.8.1998

“Për shtetësinë shqiptare”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetesh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 7 i ligjit nr. 8389, datë 5. 8. 1998 “Për shtetësinë shqiptare” ndryshohet si vijon:

“Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare.”

Neni 2

Neni 16 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Për të miturit, shtetësia shqiptare mund të mbarojë kur të paktën njëri nga prindërit ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Në këtë rast kërkohet pëlqimi i të dy prindërve.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2299, datë 26.1.1999 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

LIGJ

Nr. 9060, datë 8.5.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3827, datë 2.6.2003 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIM TË DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA (5 TETOR 1961)

Shtetet Palë në këtë Konventë, me dëshirën për te hequr kërkesën për legalizim diplomatik dhe konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja, vendosen të hartojnë këtë Konventë duke rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë.

Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare:

a) dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretaritë e gjykatave dhe zyrat përmbare;

b) dokumentet administrative;

c) aktet noteriale;

d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar të noterialit të vërtetuesit së firmave.

Kjo Konventë nuk zbatohet:

a) për dokumentet e ekzekutuara nga agjente diplomatike ose konsullore;

b) për dokumentet administrative që lidhen drejtpërdrejt me veprime tregtare ose doganore.

Neni 2

Çdo Shtet Palë përjashton nga legalizimi dokumentet e lëshuara në territorin e tij mbi të cilat zbatohet kjo Konventë. Në kuptim të kësaj Konvente, legalizimi nënkupton vetëm aktin e formalitetit, me anë të të cilit agjentët diplomatike ose konsullorë të shtetit, në territorin e të cilit lëshohet dokumenti, vërtetojnë autenticitetin e firmës, cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka firmosur dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës dhe pullës që bart.

Neni 3

Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i firmës, cilësia në të cilën ka vepruar personi që firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai bart, formaliteti i vetëm që mund të kërkohet është paraqitja e një çertifikate, të përshkruar në nenin 4, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin.

Megjithatë, formaliteti i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk mund të kërkohet në rastin kur ligjet, rregulloret dhe praktika në fuqi në shtetin në të cilin lëshohet dokumenti ose një marrëveshje midis dy a më shumë Shteteve Palë e shmang, e thjeshton ose e përjashton dokumentin nga legalizimi.

Neni 4

Çertifikata e përmendur në nenin 3 paragrafi i parë vendoset për së gjati në një qoshe të dokumentit, sipas modelit bashkëngjitur kësaj Konvente.

Megjithëse ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon dhe në një gjuhë të dytë, titulli, çertifikata, duhet të jenë në gjuhën frënge "Apostille" (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961).

Neni 5

Çertifikata lëshohet me kërkesë të personit që ka firmosur dokumentin

ose të çdo personi tjetër. Nëse plotësohet saktësisht, ajo vërteton autenticitetin e firmës, cilësinë në të cilën ka vepruar personi që e ka firmosur dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës ose pullës që ky dokument bart.

Firma, vula dhe pulla në çertifikatë përjashtohen nga çdo lloj vërtetimi i mëtejshëm.

Neni 6

Mbështetur ne paragrafin e parë të nenit 3, çdo Shtet Palë përcakton autoritetin kompetent për nxjerrjen e çertifikatës në përputhje me funksionin zyrtar të tij.

Në momentin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të aderimit ose të deklaratës së zgjerimit, Shteti Palë njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës për caktimin e autoritetit kompetent për nxjerrjen e çertifikatës, si edhe për ndryshimet e mundshme të autoritetit kompetent në të ardhmen.

Neni 7

Autoriteti kompetent, ne zbatim të nenit 6, mban një regjistër në të cilin regjistrohen certifikatat e lëshuara, duke specifikuar:

a) numrin dhe datën e certifikatës;

b) emrin e personit që firmos dokumentin zyrtar dhe cilësinë në të cilën ka vepruar

ose, në rastet e dokumenteve të pafirmosura, emrin e autoritetit që ka vënë vulën ose pullën.

Me kërkesë të personit të interesuar, autoriteti që ka lëshuar certifikatën vërteton nëse të dhënat në çertifikatë korrespondojnë me të dhënat e mbajtura në regjistër.

Neni 8

Nëse midis dy ose më shumë Shteteve Palë ekziston një marrëveshje, traktat ose konventë, që përmban dispozita që lidhen me vërtetimin e firmës, vulës ose pullës për disa formalitete të caktuara, dispozitat e kësaj Konvente kanë përparësi përsa u takon atyre dispozitave që sanksionojnë formalitete më strikte, sesa ato të parashikuara në nenet 3 dhe 4.

Neni 9

Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të shmangur legalizimin e dokumenteve nga agentët e tij diplomatikë dhe konsullorë në rastet kur kjo Konventë parashikon përjashtimin.

Neni 10

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private si dhe për Islandën, Irlandën, Lichtenstein dhe Turqinë. Pas ratifikimit instrumentet përkatës depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 11

Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 10.

Konventa hyn në fuqi për çdo Shtet Palë që e ratifikon në një datë të mëvonshme, në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumenteve përkatëse të ratifikimit.

Neni 12

Çdo shtet, që nuk përmendet në nenin 10, mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 11 paragrafi

i pare. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe Shteteve Pale, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e lajmërimit, parashikuar nga neni 15 pika d. Për do kundërshtim duhet të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës.

Konventa hyn në fuqi, ndërmjet shtetit aderues dhe shteteve, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtime për këtë aderim ditën e gjashtëdhjetë pas përfundimit të periudhës 6 - mujore, përmendur në paragrafin me sipër.

Neni 13

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit dhe aderimit, çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës.

Nëse deklarata e zgjerimit bëhet nga një shtet, i cili e ka nënshkruar dhe e ka ratifikuar Konventën, kjo Konventë hyn në fuqi për territoret në fjale në përputhje me dispozitat e nenit 11. Nëse deklarata e zgjerimit bëhet nga një shtet, i cili ka aderuar, kjo Konventë hyn në fuqi për këto territore në përputhje me dispozitat e nenit 12.

Neni 14

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi, në përputhje me nenin 1 paragrafi i parë, përfshi edhe shtetet që e kanë ratifikuar ose e kanë aderuar në një datë të mëvonshme.

Nëse nuk ka denoncime, Konventa rinovohet në mënyrë të heshtur çdo

pesë vjet. Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës prej 5 vjetësh.

Ajo mund të kufizohet për disa territore në të cilat zbatohet Konventa. Denoncimi ka efekt vetëm për shtetin që e paraqet. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 15

Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës u njofton Shteteve Palë të përmendura në nenin 10, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 12, sa më poshtë:

- a) njoftimin e parashikuar në nenin 6 paragrafi i dytë;
- b) nënshkrimet dhe ratifikimet e parashikuara në nenin 10;
- c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë;
- d) aderimet dhe kundërshtimet e parashikuara në nenin 12 dhe datën në të cilën ato bëhen efektive;
- e) zgjerimet e parashikuara në nenin 13 dhe datën në të cilat ato bëhen efektive;
- f) denoncimet e parashikuara në nenin 14 paragrafi i tretë.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë në Hagë, më 5 tetor 1961 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të lidhura në një kopje të vetme, ku teksti frëngjisht ka përparësi në rast divergjencash ndërmjet dy teksteve. Kopja e vetme depozitohet në arkivat e Qeverisë holandeze. Prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e nëntë të konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe Islandës, Irlandës, Lichtenstein dhe Turqisë.

SHTOJCË E KONVENTËS

Model i çertifikatës

“Çertifikata do të jetë në formën e një katrori me brinjë jo më të vogla se 9 cm.

Apostille

Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961

1. vendi.....

Ky dokument zyrtar

2. është firmosur nga.....

3. i cili vepron në cilësinë e.....

4. dhe mban vulën/pullën e.....

Vërtetohet

5. në.....6. më.....

7.nga.....

8.nr.....

9. vula/pulla.....10. firma.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 134, datë 7.3.2003

PËR

**VËRTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TË LËSHUARA
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR PERDORIM JASHTË VENDIT
DHE TË DOKUMENTEVE TË HUAJA, PËR PËRDORIM BREND
VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr. 8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore" dhe të shkronjës "d" të nenit 6 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vërtetimi i dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit, të bëhet:

a. institucionet e administratës publike, të nivelit qendror, që më poshtë do të quhen "institucione qendrore", si për dokumentet e lëshuara nga vetë ato dhe nga institucionet e varësisë ose institucionet e linjës;

b. institucionet e pavarura, për dokumentet e lëshuara nga administrata e tyre;

c. nga prefektët, për dokumentet e lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore.

“Institucionet qendrore” dhe “institucione të pavarura”, në kuptim të këtij vendimi, janë institucionet e parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”

2. Dokumentet e vërtetuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, të lëshuara nga institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët, legalizohen nga nëpunësit konsullorë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

3. Aktet e lëshuara nga noteri legalizohen drejtpërdrejt nga nëpunësit konsullorë.

4. Dokumentet e autoriteteve të huaja, që do të përdorën brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

5. Në vendet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi të akredituar, legalizimi i dokumenteve të huaja, të legalizuara më parë nga Ministria e Jashtme e vendit të origjinës, kryhet në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

6. Modeli i vërtetimit dhe legalizimit të dokumentit është sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Ndryshimet e modeleve bëhen nga Ministri i Punëve të Jashtme, i cili njofton menjëherë institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët.

7. Titullarët e institucioneve qendrore, të institucioneve të pavarura dhe prefektët, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme emrat e personave të ngarkuar, për vërtetimin dhe lëshimin e dokumenteve, si dhe depozitojnë specimenet e nënshkrimeve të tyre dhe gjurmët e vulave zyrtare.

8. Në rast largimi të personave të përcaktuar sipas pikës së mësipërme, titullarët e institucioneve qendrore, të institucioneve të pavarura dhe prefektët njoftojnë menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe

depozitojnë pranë saj nënshkrimet e personave zëvendësues.

9. Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme për emërimin ose largimin nga detyra të noterit dhe depoziton nënshkrimin dhe gjurmët e vulave të tij.

10. Ngarkohen institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos NANO

Lidhja 1

Modeli i vërtetimit

(Institucioni i administratës publike/prefekti)

Nr. _____

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z

(Emri, mbiemri i nëpunësit lëshues)

me funksion

(funksioni zyrtar)

dhe vula zyrtare

(Emri, mbiemri i nëpunësit vërtetues) (Nënshkrimi)

(Vendi), me (Data)

(Vula zyrtare e institucionit qendror)

Lidhja 2

Modeli i legalizimit

(Ministria e Punëve të Jashtme/Përfaqësia)

No. _____

Hereby is certified the authenticity of signing of

Mrs/Mr./

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z

(Emri, mbiemri i nëpunësit vërtetues)

in the capacity / me funksion

(funksioni zyrtar)

and the official seal / dhe vula zyrtare

(Emri, mbiemri i nëpunësit konsullor)

(Nënshkrimi)

(Vendi), (Data)

(Vula zyrtare)

(Ministria e Punëve të Jashtme/Përfaqësia) No.

Hereby is certified the authenticity of signing of Mrs/Mr./

Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z
(*Emri, mbiemri i nëpunësit vërtetues*)

in the capacity / me funksion
(*funksioni zyrtar*)

and the official seal / dhe vula zyrtare
(*Emri, mbiemri i nëpunësit konsullor*)

(*Nënshkrimi*) ,

(*Vendi*), (*Data*)

(*Vula zyrtare*)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 8126/4 Prot datë: 21. 11. 2006

MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 8962/4 Prot datë: 21. 11. 2006

AKT - MARRËVESHJE

PËR

BASHKËPUNIMIN E ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE DHE DREJTORIVE RAJONALE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR DHËNIEN E CERTIFIKATAVE TË VDEKJES, PËR EFEKT TË MBYLLJES SË PENSIONEVE

ndërmjet

MINISTRISË SË FINANCAVE

dhe

MINISTRISË SË BRENDSHME

Në mbështetje të gurmës "e", të nenit 60, të ligjit nr. 8950, datë 11. 10. 2002, "Për gjendjen civile", të ligjit nr. 7703, datë 11. 05. 1992 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe pikës 6, Kapitulli VIII, të Rregullores nr. 34, datë 01.02.2002, "Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve", e ndryshuar, me qëllim informimin në kohë për vdekjet në mënyrë që të evitohet çdo keqpërdorim i fondit të pensioneve dhe mbrojtjen e fondeve publike, bien dakort si më poshtë:

1. Zyrat e gjendjes civile në komuna e bashki, dërgojnë zyrtarisht, me postë dhe sipas skemës së Aneksit 1 bashkëlidhur, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore brenda datës 5 të çdo muaji, listën me personat e vdekur gjatë muajit pararendës, të shoqëruar me certifikatat e vdekjes.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të koordinojnë punën për evidentimin, dokumentimin dhe kryerjen e pagesës sipas rregullave dhe tarifave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për shërbimin e gjendjes civile ndaj institucioneve shoqërore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bashkëpunojnë për të zgjidhur çdo problem që mund të rezultojë ndërmjet Zyrave të Gjendjes Civile dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për zbatimin e kësaj Akt-Marrëveshje.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan BODE

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol OLLDASHI

Aneks 1

Zyrat e gjendjes civile të komunave dhe bashkive dërgojnë listat me personat e vdekur, shoqëruar me certifikatat e vdekjes, sipas skemës në vijim:

27 zyra të gjendjes civile të qarkut Berat (Berat, Kuçovë, Skrapar), në DRSSH Berat.

35 zyra të gjendjes civile të qarkut Dibër (Peshkopi, Bulqizë, Mat), në DRSSH Peshkopi

20 zyra të gjendjes civile të qarkut Durrës (Durrës, Krujë) në DRSSH Durrës.

54 zyra të gjendjes civile të qarkut Elbasan (Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin), në DRSSH Elbasan.

46 zyra të gjendjes civile të qarkut Fier (Fier, Mallakastër, Lushnjë), në DRSSH Fier.

32 zyra të gjendjes civile të qarkut Gjirokastrë (Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë), në DRSSH Gjirokastrë.

40 zyra të gjendjes civile të qarkut Korçë (Korçë, Pogradec, Devoll, Ersekë), në DRSSH Korçë.

21 zyra të gjendjes civile të qarkut Lezhë (Lezhë, Laç, Mirditë), në DRSSH Lezhë.

37 zyra të gjendjes civile të qarkut Shkodër (Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë), në DRSSH Shkodër.

19 zyra të gjendjes civile të bashkisë dhe komunave Kukës e Has, në DRSSH Kukës.

8 zyra të gjendjes civile Tropojë (bashki dhe komuna), në Degën Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tropojë.

41 zyra të gjendjes civile të qarkut Tiranë (Tiranë, Kavajë), në DRSSH Tiranë.

17 zyra të gjendjes civile të Vlorës (bashki e komuna), në DRSSH Vlorë.

13 zyra të gjendjes civile Sarandë, Delvinë (bashki e komuna), në Degën Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Sarandë.

LIGJ

Nr. 9220, date 15. 4. 2004

“PËR SHËRBIMIN PUBLIK TË VARRIMIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPERISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave e afateve për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Ne kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Vdekje” është ndalimi i veprimtarisë jetësore të organizmit të njeriut.
2. “Kufomë” është trupi pa jete i njeriut.
3. “Varr” është një gropë e hapur në tokë, për të futur kufomën.
4. “Varrezë” është një parcele e veçantë toke, ku varrosen të vdekurit.
5. “Varrim” është ceremonia e fundit që i bëhet të vdekurit.
6. “Varrezë publike” është vendi ku ndodhen varrezat e një rajoni, të cilat janë prone e bashkisë ose komunës.
7. “Mineralizim i kufomës” është dekompozimi i indeve të kockave, të cilat fitojnë cilësi minerare.
8. “Mbetje mortale” janë mbeturinat, që kanë mbetur pas mineralizimit

të kufomës.

9. "Shërbim i varrimit" është veprimtaria që zhvillohet nga ndërmarrja publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrosjen e kufomës.

10. "Morg" është mjedisi për mbajtjen e kufomës në kushte frigoriferike.

11. "Periudha e observimit" është koha e mbikqyrjes së kufomës para varrimit.

12. "Shenje funebre" është çdo lloj simboli ose mbishkrimi i vendosur mbi varr nga familjaret.

13. "Zonë e rezervuar" është zona që nga banesa e fundit e periferisë së qytetit ose fshatit deri te fillimi i varrezave.

KREU II

PROÇEDURAT E ZHVILLIMIT TË VARRIMIT

Neni 3

Administrimi i varrezave

1. Çdo bashki ose komune duhet të ketë të paktën një varreze. Toka e caktuar për ndërtimin e varrezave është prone publike.

2. Komunat, që përfshijnë disa fshatra, në të cilat transporti i kufomave deri në qendër të komunës nuk është i lehtë, për shkak të vështirësive të komunikacionit, duhet të kenë varreza të veçanta për këto fshatra.

3. Komunat e vogla mund të kenë një varreze të përbashkët vetëm në qoftë se janë fqinje me njëra - tjetrën. Në këtë rast, me marrëveshje të përbashkët, shpenzimet për shërbimin dhe mirëmbajtjen e varrezave shpërndahen ndërmjet komunave, në bazë të të dhënave të popullsisë së tyre.

4. Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit vendor" bashkia ose komuna sigurojnë mirëmbajtjen, rregullin dhe ruajtjen e varrezave dhe kur varreza është e përbashkët këtë detyrë e kryen komuna ku ndodhet varreza. Këto veprime kryhen nga ndërmarrja publike vendore ose nga një shoqëri private e liçensuar, sipas kritereve të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

5. Zyrat përgjegjëse të bashkisë ose komunës duhet të jenë të pajisura

me një planimetri me shkallë 1 : 5000 të varrezave ekzistuese, e shtrirë në zonën rrethuese të tyre. Planimetria duhet të azhurnohet çdo vit, duke pasqyruar në të të gjitha ndryshimet e kryera.

6. Bashkia ose komuna, për administrimin e varrezave, bashkëpunon edhe me komunitetet fetare.

Neni 4

Zona e rezervuar

1. Varrezat duhet të jenë të izoluara nga zonat e banimit nëpërmjet zonës së rezervuar.

Ndalohet të bëhen ndërtime të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese brenda zonës së rezervuar.

2. Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10 000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jete më e madhe se 100 m nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi me të vogël se 10 000 banorë, duhet të jete me e madhe se 50 m.

3. Këshilli bashkiak ose komunal ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e zonës së rezervuar. Kjo bëhet vetëm me vendim të motivuar të organeve të mësipërme, duke marrë mendimin e inspektoratit sanitar.

Neni 5

Ndalimi i varrimit në një vend të ndryshëm nga varrezat

1. Varrosja e kufomave bëhet vetëm në varreza. Me kërkesë të komuniteteve fetare lejohet varrosja në mjediset brenda selive fetare. Kundërvajtësi dengjet me masë administrative me gjobe dhe të gjitha shpenzimet për transportimin e kufomës janë në ngarkim të tij.

2. Varret e vendosura në vende të ndryshme nga varrezat transferohen, pas periudhës së mineralizimit, në varrezat publike me shpenzimet e familjareve.

Neni 6

Pranimi i kufomave në varreza

Në varrezat publike të bashkive dhe komunave prانهen:

- a) kufomat e personave te vdekur ne territorin e bashkive ose komunave, pavarësisht nga vendi i banimit kur ishin gjalle;
- b) kufomat e personave te vdekur jashtë territorit te bashkive ose komunave, por që, kur ishin gjalle, ishin banues të tyre;
- c) kufomat e personave që nuk banonin në këtë bashki ose komune kur ishin gjalle dhe që kanë vdekur jashtë territorit të kësaj bashkie ose komune;
- ç) kufomat e shtetasve të huaj me banim ose jo në Shqipëri, që dëshirojnë të varrosen në këto territore;
- d) mbeturina mortale të personave të përmendur ne shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni;
- dh) të lindurit të vdekur.

Neni 7

Shërbimi i varrimit

1. Pranë çdo bashkie ose komune funksionon shërbimi i varrimit. Përgjegjësi i këtij shërbimi merr në dorëzim dhe ruan për çdo varrim lejen e varrimit, të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile pranë bashkisë ose komunës. Ndalohet kryerja e varrimeve pa lejen përkatëse.

2. Kur vdekja ndodh në ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit kërkon dokumentet që vërtetojnë vdekjen, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe me këto dokumente bën deklarinimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile në ditën e pare të punës.

3. Çdo shërbim varrimi regjistrohet në dy regjistra të njëjtë, numri i faqeve të të cilave vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkisë apo komunës. Në regjistër shënohen:

a) varrimet që janë kryer, duke saktësuar emrin, mbiemrin, moshën, vendin dhe datën e lindjes (siç rezulton nga leja e varrimit), vitin, ditën dhe orën e varrimit, numrin e gurit të varrit dhe numrin rendor të faturës së varrimit;

b) çdo ndryshim që ka ndodhur si pasoje e zhvarrosjeve.

Regjistri nënshkruhet në çdo fletë nga përgjegjësi i shërbimit. Modeli i tij përcaktohet në udhëzimin e ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

4. Njëra prej kopjeve të regjistrit dorëzohet çdo fund viti në arkivin e bashkisë ose komunës, ndërsa kopja tjetër mbetet në ruajtje pranë shërbimit të varrimit.
5. Rakordimi i regjistrave me zyrat e gjendjes civile bëhet çdo tremujor.
6. Regjistrat e përmendur në pikën 3 të këtij neni paraqiten pranë organeve të kontrollit të njësisë vendore pas çdo kërkesë të tyre.

KREU III

NORMAT TEKNIKE PËR NDERTIMIN E VARREZAVE

Neni 8

Projektimi i varrezave

1. Çdo projekt për zgjerimin e varrezave ekzistuese dhe ndërtimin e varrezave të reja bëhet në bazë të një studimi të plote të zonës, të miratuar nga këshilli bashkiak ose komunal, veçanërisht, për sa i përket vendndodhjes, shtrirjes së tokës e natyrës fiziko-kimike të saj, thellësisë dhe drejtimit të shtresës hidrike.
2. Në projektet e ndërtimit të varrezave të reja mund të parashikohen edhe parcela të ndara sipas komuniteteve fetare, në funksion të përbërjes fetare të popullsisë së rajonit.
3. Normat teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

Neni 9

Vendmbajtja e përbashkët e eshtrave

Çdo varreze ka vendmbajtjen e eshtrave, që përbehet nga një ndërtesë e destinuar për mbledhjen e eshtrave, që vijnë nga zhvarrimet dhe që nuk janë kërkuar nga familjarët për destinacion tjetër në varreza. Vendmbajtja e eshtrave duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që eshtrat të mos shihen nga publiku. Vendmbajtja e eshtrave lejohet edhe brenda selive të komuniteteve fetare, pas marrjes së lejes nga bashkia ose komuna.

Neni 10

Krijimi i kushteve për kryerjen e riteve fetare

Planet rregulluese të varrezave parashikojnë vende të veçanta për kryerjen e riteve fetare, sipas kërkesave të komuniteteve fetare, në bazë të parimit të barazisë për të gjithë.

KREU IV

VARRIMET JASHTË VARREZAVE

Neni 11

Varrime te veçanta mbisipërfaqësore

Varrimi i veçantë mbisipërfaqësor i kufomave ose mbetjeve mortale në vende të ndryshme nga varrezat autorizohet me dekret të Presidentit të Republikës, duke respektuar normat e përcaktuara në këtë ligj. Autorizimi për këtë lloj varrimi behet kur ekzistojnë motive të justifikueshme për nderime të veçanta.

KREU V

PRISHJA E VARREZAVE

Neni 12

E drejta e prishjes së varrezave

1. Prishja e varrezës vendoset nga një komision i posaçëm, i ngritur nga këshilli bashkiak ose komunal, i cili harton dokumentin përkatës për verifikimin e gjendjes së plote të varrezës, pasi është marrë mendimi i Inspektoratit Sanitar Shtetëror.
2. Ndalohet prishja e varrezave, që janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, përveç rasteve kur behet e domosdoshme për interesa publike.

Neni 13

Përdorimi i varrezës së prishur

1. Toka e një varreze, për të cilën është vendosur prishja, nuk destinohet për përdorim tjetër pa kaluar 15 vjet nga varrimi i fundit që bëhet në të. Gjate kësaj periudhe, kjo varreze mbetet nën mbikëqyrjen e bashkisë ose komunës, e cila organizon mirëmbajtjen e saj.
2. Përpara se të përdoret për qellim tjetër, nga taka e varrezës duhet të hiqen me kujdes eshtrat në një thellësi jo më të madhe se 2 m dhe ato vendosen në ndërtesën e përbashkët të vendosjes së eshtrave ose në varrezën e re.

Neni 14

Materialet dhe shenjat funebre të varrezës së prishur

1. Materialet mbitokësore të varrezave, monumentet dhe shenjat funebre, të vendosura mbi varret që do të prishen, mbeten në pronësi të familjareve, të cilët mund t'i transportojnë ato në varrezën e re.
2. Në rastet kur familjarët refuzojnë t'a bënë këtë, këto materiale kalojnë në pronësi të bashkisë ose komunës.
3. Shpenzimet për ndërtimin dhe ripërshtatjen e monumenteve të varrezave, që kërkohen gjatë transferimit të mbetjeve ekzistuese, janë në ngarkim të familjareve.

KREU VI

MENYRA E VARRIMIT

Neni 15

Varrimi nëntokësor

1. Varrimi nëntokësor bëhet në gropa të gërmuara dhe më pas të mbuluara me dhe. Kufomat duhet të vendosen në arkivole të lehta, që të dekompozohen me lehtësi. Çdo varr dallohet nga bordura anësore, pllaka e varrit, sipas një numri progresiv dhe identifikimi i kufomës.
2. Fushat e destinuar për këtë lloj varrimi shtrihen në toka të

përshtatshme nga pikëpamja e strukturës gjeologjike dhe mineralogjike për vetitë mekanike dhe fizike, si dhe për nivelin e shtresës hidrike.

3. Kushtet e përdorimit të varrezës, të mënyrës së hapjes së varreve, si dhe të dhënat teknike të arkivoleve që do të përdoren, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

Neni 16

Varrimi mbitokësor

1. Varrimi mbitokësor ka të bëjë me vendosjen e kufomës në një dhomë të mbyllur hermetikisht me mur ose me pllaka guri. Në këtë mënyrë mund të vendosen edhe kufomat e balsamosura.

2. Kufomat e destinuara për varrim mbitokësor duhet të vendosen në arkivole me mure të dyfishta, njëri prej druri dhe tjetri prej metali.

3. Në arkivolin e jashtëm vendoset pllaka metalike, ku shënohen emri, mbiemri, data e lindjes dhe e vdekjes së kufomës.

4. Kushtet teknike të ndërtimit dhe të përdorimit të varrezave mbitokësore përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

KREU VII

MËNYRAT E ZHVARRIMIT

Neni 17

Zhvarrime të zakonshme nga nëntoka

1. Zhvarrimet e zakonshme nga nëntoka kryhen pas një periudhe 10-vjeçare nga viti i varrimit. Varret e liruara nga mbeturinat e arkivolit përdoren për varrime të reja.

2. Në rastet kur vërtetohet se pas periudhës 10-vjeçare nuk sigurohet mineralizimi i plote i kufomave, behet zgjatja e kësaj periudhe me miratim të mjekut ligjor dhe, në mungesë të tij, të mjekut anatomo-patolog. Në rast se edhe pas kësaj periudhe nuk realizohet mineralizimi i plote i kufomave, Ministria e Shëndetësisë vendos për transferimin ose jo të varrezave.

3. Kur vërtetohet se në një varreze, për shkak të kushteve të veçanta të përbërjes apo strukturës së tokës, mineralizimi i kufomave kryhet për një periudhë më të shkurtër, mjeku ligjor dhe, në mungesë të tij, mjeku anatomo-patolog autorizon shkurtimin e kësaj periudhe jo më pak se 5 vjet.

4. Kryetari i bashkisë ose komunës lëshon lejet për zhvarrimet e zakonshme nga nëntoka, të cilat kryhen nga ndërmarrja që administron varrezat.

Neni 18

Zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka

1. Kufomat mund të zhvarrosen përpara periudhës së caktuar, me urdhër të gjyqtarit ose prokurorit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale ose me autorizimin paraprak të kryetarit të bashkisë ose komunës, për t'i transportuar në varr tjetër.

2. Për zhvarrimet e jashtëzakonshme nga nëntoka, të urdhëruara nga gjyqtari ose prokurori, kufomat duhet të transportohen në sallat e autopsisë, duke respektuar kërkesat e bëra nga këto organe.

3. Të tilla zhvarrime duhet të kryhen në prani të grupit të mjekeve ligjore, përfaqësues të organeve që e kanë kërkuar zhvarrimin dhe të të ngarkuarit me shërbimin e varrezave.

Neni 19

Rastet kur nuk mund të kryhen zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka

Përveç rasteve të urdhëruara nga gjyqtari ose prokurori, nuk kryhen zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka:

a) në muajt maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator, duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me varreza malore, ku lejohen procedurat e zhvarrimeve edhe në muajt e mësipërm;

b) në rastet e kufomave të personave të vdekur nga sëmundje infektive, përveç rasteve kur ka kaluar 2 vjet nga data e varrimit dhe kur zhvarrimi kryhet në përputhje me masat për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Neni 20

Depozitimi i eshtrave te zhvarrosura nga nëntoka

1. Eshtrat, qe mblidhen si rezultat i zhvarrimeve te zakonshme, duhet te grumbullohen në vendin e tyre të përbashkët, me përjashtim të rasteve kur varrosen në një parcelë të veçantë.
2. Eshtrat, si rezultat i zhvarrimeve te zakonshme, mund të groposen në të njëjtin varr me një kufome tjetër, sipas kërkesës së familjareve.
3. Te gjitha mbeturinat e varrezave konsiderohen si mbeturina të veçanta dhe duhet të asgjësohen.

Neni 21

Zhvarrime te zakonshme mbitokësore

1. Zhvarrimet mbitokësore kryhen ne mbarim te periudhës së lejes, që varion nga 5 deri në 20 vjet dhe bëhen me autorizim të kryetarit të bashkisë ose komunës.
2. Arkivolet e zhvarrosura varrosen nën tokë, pasi arkivolit t'i hapen disa të çara të përshtatshme, për të lejuar fillimin e procesit të mineralizimit të kufomës.
3. Kur kufomat e zhvarrosura gjenden ne kushtet e një mineralizimi të plotë, me miratimin e mjekut anatomo-patolog, nga ndërvarja që administron varrezat mund të merren masa për mbledhjen e eshtrave në kasën e tyre.

Neni 22

Ndalimi i zvogëlimit të përmasave të kufomave

1. Ndalohet çdo veprim që ka të bëjë me zvogëlimin e përmasave të kufomës së varrosur mbi toke, për ta futur në një arkivol me përmasa më të vogla se ato fillestare të arkivolit, me të cilin është varrosur.
2. Për rastet e parashikuara si vepër penale nga neni 118 i Kodit Penal te Republikës së Shqipërisë, përgjegjësi i shërbimit të rojës së varrezave bën kallëzim për ndjekje penale dhe ndërkohë vë në dijeni kryetarin e bashkisë ose komunës.

Neni 23

Zhvarrimet e jashtëzakonshme mbitokësore

1. Kryetari i bashkisë ose komunës autorizon zhvarrimin mbitokësor të arkiveleve të destinuara për t'u transportuar në një vend tjetër pas çdo periudhe kohe dhe në çdo muaj të vitit, me kusht që, pas hapjes së varrit mbitokësor, autoriteti sanitar vendor të verifikojë gjendjen e rregullt të arkivolit dhe të deklarojë se transferimi i tij nuk përbën asnjë rrezik për shëndetin publik.
2. Kur autoriteti sanitar i sipërpërmendur vëren se arkivoli nuk është në gjendje të rregullt, mund të lejojë transferimin e tij, vetëm pasi të sistemohet në mënyrë të përshtatshme, sipas normave të përcaktuara në zbatim të këtij ligji.

KREU VIII

TRANSPORTIMI I KUFOMES

Neni 24

Transportimi i kufomës në varrezë

1. Transportimi i kufomës nga vendi i vdekjes deri në morg ose në varrezë bëhet me automjete të mbyllura dhe nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e policisë bashkiake ose komunale.
2. Ndalohej të kryhet transportimi i kufomave përpara periudhës së observimit, të këshilluar nga grupi mjekësor, gjatë së cilës mund të shfaqen raste eventuale të kthimit në jetë.
3. Automjetet e varrimit duhet të plotësojnë kushte të veçanta, të cilat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike, të ministrit që mbulon veprimtarinë e transportit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 25

Leja për transportimin e kufomave

1. Transportimi i kufomave nga një bashki ose komunë në një tjetër

autorizohet nga kryetari i bashkisë ose komunës, ku ka ndodhur vdekja. Kryetari i bashkisë ose komunës pritëse duhet të lajmërohet për ardhjen e kufomës.

Autorizimi i dorëzohet përgjegjësit të shërbimit të varrezave.

2. Për rastet kur kërkohet vendosja e kufomës në bashki ose komuna të tjera ndërmjetëse, për kryerjen e nderimeve të veçanta, autorizimi i lëshuar nga kryetari i bashkisë ose komunës u njoftohet edhe kryetareve të njësive vendore ndërmjetëse.

3. I ngarkuari për transportimin e kufomës jashtë bashkisë ose komunës pajiset me autorizimin e kryetarit të bashkisë ose komunës, ku ka ndodhur vdekja.

4. Nëse transportimi kryhet me hekurudhe, anije ose avion, autorizimi i mësipërm duhet t'i dorëzohet transportuesit gjatë kryerjes së transportit.

Neni 26

Transportimi i eshtrave

1. Transportimi i eshtrave ose i mbetjeve të tjera mortale të asimilueshme, përveç autorizimit të përmendur në nenin 25 të këtij ligji, shoqërohet edhe me autorizimin e Inspektoratit Sanitar Shtetëror.

2. Eshtrat dhe mbetjet mortale të asimilueshme futen në çdo rast në kaseta zinku, me trashësi jo më të vogël se 0,6 mm dhe mbyllen me saldim. Mbi kasete shënohen emri dhe mbiemri i kufomës.

3. Në rast se eshtrat ose mbetjet mortale janë të gjetura dhe nuk është i mundur identifikimi i tyre, në kasete shënohen vendi dhe data e gjetjes.

Neni 27

Transportimi i kufomave për dhe nga jashtë shtetit

1. Kufomat, që transportohen për dhe nga jashtë shtetit, duhet të jenë të shoqëruara nga një dokument i veçantë. Ky dokument lëshohet nga prefekti, për kufomat që nxirren nga territori shtetëror dhe nga autoriteti përgjegjës i shtetit nga sillet kufoma, për kufomat që hyjnë në territorin shtetëror.

2. Për futjen në vend të kufomave, që vijnë nga shtetet e tjera, i interesuari për transportimin e kufomës duhet të paraqesë, nëpërmjet autoriteteve

përkatëse ose personalisht, ne autoritetin konsullor shqiptar, në shtetin ku ka ndodhur vdekja:

- a) kërkesën për lejen e transportimit të kufomës për ne Shqipëri;
- b) çertifikatën e vdekjes, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse;
- c) çertifikatën e organeve përgjegjëse, që vërteton se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës.

Dokumentacioni i mësipërm paraqitet nga i interesuari me rrugë postare ose me faks.

Për shtetet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi diplomatike, kërkesa e mësipërme dërgohet në përfaqësinë, nga e cila mbulohet ai shtet.

3. Autoriteti konsullor shqiptar, pasi kontrollon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur dhe pasi bën verifikimin në autoritetet përkatëse që kanë lëshuar dokumentet e mësipërme, lëshon lejen për futjen e kufomës në Republikën e Shqipërisë. Leja i lëshohet drejtpërdrejt të interesuarit dhe autoritetit përkatës me poste ose me faks. Autoriteti konsullor shqiptar njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme, ministrinë që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike dhe prefektin e qarkut ose kryetarin e njësisë vendore ku do të çohet kufoma.

4. Për ekstradimin nga vendi të kufomave për ne një shtet tjetër, i interesuari duhet t'i drejtojë një kërkesë prefektit të qarkut, ku ndodhet kufoma, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

- a) miratimin për futjen e kufomës nga autoriteti konsullor i shtetit, në të cilin do të çohet kufoma;
- b) çertifikatën e organeve shëndetësore përgjegjëse, ku vërtetohet se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës.

5. Prefekti, pasi merr kërkesën, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, lëshon autorizimin, duke njoftuar prefektin e qarkut të pikës kufitare nga do të kalojë kufoma.

6. Masa e shpenzimeve, procedura që do të ndiqet, institucioni që do të ngarkohet për përballimin e shpenzimeve të varrimit, për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë vendit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Kushtet e veçanta për transportimin e kufomave

1. Kufomat e destinuar për ekstradim jashtë territorit të vendit ose që duhet të transportohen në bashki ose komuna dhe me mjetin e zgjedhur të transportit mund të arrijnë vetëm pas 24 orëve, ose kur transportimi kryhet pasi kanë kaluar 48 ore nga çasti i vdekjes, duhet t'i nënshtrohen trajtimit antiprishje, duke injektuar në trupin e kufomës të paktën 500 cc formalinë, pasi të ketë kaluar periudha e observimit.
2. Kufomat që janë balsamosur nuk u nënshtrohen këtyre kushteve.

Neni 29

Transportimi i të vdekurve me sëmundje infektive

Kur vdekja ka ardhur si pasoje e një sëmundjeje infektive, ngjitëse , që bën pjesë në listën e veçantë të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë, transportimi i kufomës u nënshtrohet rregullave të veçanta, të përcaktuara me udhëzim të ministrit që mbulon këtë veprimtari.

KREU IX

SANKSIONET NDAJ SHKELËSVE

Neni 30

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbejnë vepër penale, përbejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobe si më poshtë:
 - a) për shkelje të nenit 5 të këtij ligji, gjoba është në vlerën 30 000 lekë;
 - b) për shkelje të neneve 4 pikat 1 dhe 2, 7 pika 1, 16 pikat 1 dhe 2, 17, 18 pika 3, 19 shkronjat "a" dhe "b", gjoba është në vlerën 20 000 lekë;
 - c) për shkelje të nenit 24 pikat 1 dhe 3, 25 pika 1, 28 pika 1, gjoba është në vlerën 25 000 lekë.
2. Policia bashkiake dhe policia komunale janë organet që vendosin gjobën dhe bëjnë ekzekutimin e saj, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

3. Në rast përsëritjeje të shkeljeve, policia bashkiake ose komunale bën pezullimin ose ndërprerjen e veprimtarisë për subjektet shkaktare.
4. Kur këto shkelje përbejnë vepër penale, policia bashkiake ose komunale bën kallëzim për ndjekje penale.

Neni 31

Ankimi

1. Ankimi kundër vendimit të policisë bashkiake ose policisë komunale behet të kryetari i bashkisë ose komunës, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Kryetari i bashkisë ose komunës duhet t'i përgjigjet ankimit brenda afatit kohor prej 30 ditësh.
2. Ankimi kundër vendimit të kryetarit të bashkisë ose komunës apo kur ky i fundit nuk kthen përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, bëhet brenda 30 ditëve nga marrja ose jo e njoftimit në gjykatën e rrethit.

Neni 32

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 27 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 3, 8, 15 pika 3 dhe 16 pika 4.
3. Ngarkohen ministri që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike, ministri që mbulon veprimtarinë e transportit dhe Ministri i Shëndetësisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 24 të këtij ligji.
4. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 dite pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Shpallur me dekreten nr. 4225, datë 14.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu
Akte të tjera nënligjore lidhur me shërbimin publik të varrimit:

VENDIM

Nr. 426, datë 9.7.1998

PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BRENDË DHE JASHTË SHTETIT

I azhurnuar me:

- VKM Nr. 788, datë 26.11.2003
- VKM Nr. 721, datë 30.10.2007

Me propozimin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për çdo rast vdekjeje jepet një ndihmë financiare nga Buxheti i Shtetit për përballimin nga familja të shpenzimeve të varrimit, në masën e përcaktuar më poshtë, sipas vendbanimeve përkatëse:

- Për Bashkinë e Tiranës, në masën 10 000 lekë;
- Për bashkitë e tjera, në masën 8 500 lekë;
- Për komunat, në masën 5 000 lekë.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet drejtorive rajonale dhe agjencive të sigurimeve shoqërore kryen pagesën e kësaj ndihme, në bazë të certifikatës së vdekjes së lëshuar nga zyrat e gjendjes civile të njësive përkatëse të qeverisjes vendore (komuna ose bashkia) dhe të kërkesës së paraqitur nga familjarët e personit të vdekur.

Në buxhetin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin e sigurimeve shoqërore planifikohen, çdo vit, fonde për përballimin e shpenzimeve që lidhen me dhënien e ndihmës, në raste vdekjeje, si transfertë nga Buxheti i Shtetit.

3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave

vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursen një pjesë të këtyre shpenzimeve.

Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrisë së Financave.

4. Qarqet organizojnë heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve, me ose pa vendim gjyqësor, të të burgosurve politike, që kanë vdekur në burg ose në vendet e dënimit, pa u dënuar, si dhe të të vrarëve në kufi, në orvatje për t'u arratisur .

Shpenzimet përballohen nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet buxhetit të këshillave të rretheve përkatëse.

5. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ngarkohet të nxjerrë udhëzimin përkatës për mënyrën e organizimit të këtij shërbimi dhe të financimit e të likuidimit të tij.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 28.8.1992, nr. 484, datë 10.11.1992, nr. 189, datë 16.4.1993 dhe nr. 8, datë 17.11.1994, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos NANO

Lista e rretheve te grupuara sipas masës se ndihmës ne rast fatkeqësie:

Nr.	Rrethi	Zonat urbane		Zonat Rurale	
		0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç	0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç
1	Tirane	5800	9600	2200	3600
2	Shkodër	5000	8400	2200	3600
3	Durrës	5000	8400	2200	3600
4	Elbasan	5000	8400	2200	3600
5	Vlore	5000	8400	2200	3600
6	Korçe	5000	8400	2200	3600
7	Fier	5000	8400	2200	3600
8	Berat	5000	8400	2200	3600
9	Gjirokastër	5000	8400	2200	3600
10	Kavajë	5000	8400	2200	3600
11	Kruje	5000	8400	2200	3600
12	Lezhe	5000	8400	2200	3600
13	Lushnjë	5000	8400	2200	3600
14	Pogradec	5000	8400	2200	3600
15	Sarande	5000	8400	2200	3600
16	Dibër	4300	7200	2200	3600
17	Gramsh	4300	7200	2200	3600
18	Kolonje	4300	7200	2200	3600
19	Kukës	4300	7200	2200	3600
20	Kurbin	4300	7200	2200	3600
21	Librazhd	4300	7200	2200	3600
22	Mirdite	4300	7200	2200	3600
23	Mat	4300	7200	2200	3600
24	Përmet	4300	7200	2200	3600
25	Puke	4300	7200	2200	3600
26	Skrapar	4300	7200	2200	3600
27	Tepelene	4300	7200	2200	3600
28	Tropojë	4300	7200	2200	3600
29	Bulqizë	4300	7200	2200	3600
30	Delvine	4300	7200	2200	3600
31	Devoll	4300	7200	2200	3600
32	Has	4300	7200	2200	3600
33	Kuçove	4300	7200	2200	3600
34	Mallakastër	4300	7200	2200	3600
35	Peqin	4300	7200	2200	3600
36	Malësi e Madhe	4300	7200	2200	3600

UDHËZIM

Nr. 2, datë 19.7.2004

MBI PËRCAKTIMIN DHE PLOTËSIMIN E MODELIT TË REGJISTRIT TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit

UDHËZON:

1. Regjistri i shërbimit të varrimit është dokumenti përmbledhës i të dhënave të shërbimit të varrimit.
2. Modeli i regjistrit të shërbimit të varrimit është unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë, sipas modelit tip që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
3. Në këtë regjistrë shënohen të dhënat e sakta për varrimet që kryhen, mënyrën e varrimit, ndryshimin që ka ndodhur si pasoje e zhvarrosjeve, si dhe të dhëna në plotësim të kërkesave të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".
4. Drejtorja, sektori apo zyra që mbulon veprimtarinë e shërbimit të varrimit të çdo bashkie ose komune bën administrimin e këtij regjistri.
5. Përgjegjësi i drejtorisë, i sektorit apo i zyrës përkatëse të bashkisë apo komunës i jep me procesverbal dy kopje të njëjta të regjistrit të shërbimit të varrimit, me numër të njëjtë fletësh dhe të nënshkruara nga kryetari ose sekretari i bashkisë apo komunës, ndërmarrjes ose shoqërisë private të licencuar që administron varrezat.
6. Ndërmarrja apo shoqëria private e licencuar që administron varrezat, plotëson regjistrin e shërbimit të varrimit, sipas kërkesave të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".

7. Plotësimi i regjistrit bëhet nga një person i ngarkuar me këtë detyrë, bazuar në lejen e varrimit ose deklarimit të personave madhore të familjes së të ndjerit sipas nenit 50 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”.

8. Plotësimi i regjistrit do të bëhet me shkrim të qartë dhe pa korrigjime, duke regjistruar të dhënat si më poshtë vijon:

a) të dhënat e sakta të identifikimit që merren nga gjendja civile nëpërmjet lejes së varrimit; b) të dhënat e varrosjes si data, ora dhe numri i faturës;

c) lloji i varrimit kur kemi varrim nëntokësor, mbitorësor ose zhvarrim;

d) vendi i vendosjes me të dhënat që identifikojnë pozicionin e varrit në varrezat publike;

e) ndryshimet që mund të bëhen si rezultat i zhvarrimeve ose për vdekjet nga sëmundjet infektive, varrim i cili kryhet në kushte të veçanta.

Në rastet kur gjatë plotësimit të regjistrit bëhen gabime, korrigjimi i tyre bëhet sipas

mënyrës së korrigjimit të regjistrave të gjendjes civile, konform nenit 27 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”.

9. Kontrolli ditor i regjistrimeve, në këtë regjistër, bëhet nga përgjegjësi i shërbimit të varrimit duke firmosur në çdo fletë mbas mbushjes të saj.

10. Ndërmarrja ose shoqëria private e licencuar e administrimit të varrezave duhet të bëjë rregullisht rakordimin e regjistrit të plotësuar nga ajo, me regjistrin themeltar të zyrës së gjendjes civile që ka lëshuar lejen e varrimit. Në rast të mospërputhjes të regjistrave, veprohet konform nenit 51 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”.

11. Një kopje regjistri të plotësuar dorëzohet çdo fund viti në bashki ose komunë, ndërsa kopja tjetër mbetet pranë ndërmarrjes ose shoqërisë

private të administrimit të varrezave. Kontrolli i të dhënave të regjistruara dhe i mënyrës së plotësimit të tyre, bëhet nga organet përkatëse të pushtetit vendor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Bashkim FINO

RREGJISTËR I SHËRBIMIT TË VARRIMIT

Nr. Emri atësia Mbiemri Mosha Vendi i lindjes Data e lindjes Varrosja Lloji
i varrimit Vendi i vendosjes Ndryshimet
Dita Muaji Viti Ora Nr.ifat. Parcela Radha Nr.

UDHËZIM

Nr. 3912, datë 21.6.2004

MBI PROCEDURAT PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË, QË VDESIN BRENDA DHE JASHTË SHTETIT

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit" ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 26.11.2003 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 9.7.1998 "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit"; Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit, përcaktimin e rasteve të veçanta, si dhe përcaktimin e masës së kontributit në rastet kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjaret e të ndjerit.

Neni 2

Buxheti i Shtetit për çdo rast fatkeqësie jep, për shtetasit shqiptarë, një ndihmë të caktuar në lekë. Masa e kësaj ndihme përcaktohet sipas vendbanimit në zona rurale apo urbane, si dhe specifikohet për grupmoshat 0-14 vjeç dhe mbi 14 vjeç sipas listës bashkëngjitur vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 9.7.1998.

Neni 3

Ndihma në lekë tërhiqet nga të interesuarit pranë zyrës së financës në bashkinë apo komunën përkatëse kundrejt paraqitjes së çertifikatës së vdekjes së të ndjerit me shënimin “Shpenzime varrimi”. Për çdo rast pagese, financa e bashkisë apo e komunës, sipas çertifikatës së paraqitur, llogarit masën e ndihmës, si dhe plotëson mandatpagesën.

Neni 4

Shpenzimet për ndihmë planifikohen në buxhetin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe përdoren mbi bazën e kërkesave të organeve të pushtetit vendor.

Neni 5

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për persona që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për raste të veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Transporti i kufomave dhe eshtrave për kategoritë e cituara me sipër bëhet me automjetet e funeralit që ka në inventarin e saj Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit. Të gjitha shpenzimet e transportit ku përfshihen karburante, dietat për drejtuesit e automjetit, taksat e ndryshme kufitare dhe ato të lëvizjes, telefonatat e dokumentuara, biletat e trageit, fjetja etj. përballohen nga buxheti i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 6

Shpenzimet e tjera, si: shpenzime spitali, morgu, zhvarrosje, arkivoli, si dhe detyrime të tjera për përgatitjen e kufomës për transportimin në

atdhe, përballohen nga familja apo të afërmit e të ndjerit.

Neni 7

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit do të nisë automjetet për transportimin e kufomës apo eshtrave vetëm pas kërkesës zyrtare nga zyra konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila duhet të sqarojë në kërkesën e bërë gjeneralitetet dhe vendndodhjen e sakte të të ndjerit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse nga familja, përfundimin e procedurave që lejojnë transportin në Shqipëri.

Neni 8

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familja dhe të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursen një pjesë të këtyre shpenzimeve, llogaritur me tarifën 70 leke/km nga qendra administrative ku ka ndodhur vdekja deri në qendrën administrative ku do të bëhet varrimi.

Neni 9

Për transporte të kryera nga vende jashtë Evropës, shlyerja do të bëhet në masën 1500 dollarë. Kjo pagesë do të bëhet me lekë duke konvertuar valutën e huaj me kursin zyrtar ditën që plotësohet çeku për pagesë.

Neni 10

Pagesa e familjeve do të bëhet nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit kundrejt këtyre dokumenteve:

- a) Dokumenti i vdekjes nga shteti ku ka ndodhur vdekja
- b) Faturë, biletë apo dokument tjetër, që vërteton se shpenzimet e transportit i kanë kryer familja dhe të afërmit e të ndjerit
- c) Vërtetimin e varrimit në Shqipëri

d) Çertifikatë vdekje nga zyra përkatëse e gjendjes civile në Shqipëri

e) Letërnjoftimin ose fotokopje e noterizuar e familjarit që do ta tërheqë shpërblimin.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar. Dokumentacioni në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar.

Neni 11

Masa e pagesës të tërhiqet pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit brenda një viti nga dita e sjelljes së kufomës në Shqipëri. Në rastet kur shpenzimet e transportit për sjelljen e kufomës apo eshtrave në Shqipëri kryhen falas nga shteti përkatës apo shoqata të ndryshme, familjarët e të ndjerit nuk përfitojnë pagesë të transportit nga shteti shqiptar.

Neni 12

Këshillat e qarqeve, bashkitë ose komunat, nga buxheti i tyre, përballojnë heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve, me ose pa vendim gjyqi, të burgosurve politike, që kanë vdekur në burg ose në vendet e dënimit, pa u dënuar.

Për kryerjen e punimeve përkatëse, këshillat e qarqeve, bashkitë ose komunat ngarkojnë njësi të shërbimit që kanë në vartësi, të cilat përpilojnë dokumentacionin përkatës (fature, situacion etj.) për shpenzimet e kryera në fakt. Në bazë të këtij dokumentacioni bëhet dhe financimi i tyre.

Neni 13

1. Rastet e veçanta, për të cilat me fonde të Buxhetit të Shtetit organizohet shërbimi i transportit të kufomave dhe eshtrave, konsiderohen këto kategori personash:

- Personalitete të shquara të artit, mbajtës i titullit "Artist i Popullit"
- Personalitete të shquara të shkencës, mbajtës i titullit "Profesor"
- Personalitete të shquara të sportit, mbajtës i titullit "Mjeshtër sporti"
- Invalid dhe veteranë të Luftës Nacionalçlirimtare.
- Persona me aftësi të kufizuar.

Propozimet për organizimin e shërbimit të transportit të kufomave dhe të eshtrave për personat e lartshënuar bëhen nga institucione qendrore, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme ku ata bëjnë pjesë dhe miratohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Neni 14

Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit me nr. 4252/1, Ministrisë së Financave me nr. 2125/4 shfuqizohet.

Neni 15

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË
TERRITORIT DHE TË TURIZMIT

MINISTRI I FINANCAVE

Bashkim FINO

Arben MALAJ

Nr.	Rrethi	Zonat urbane		Zonat Rurale	
		0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç	0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç
1	Tirane	5800	9600	2200	3600
2	Shkodër	5000	8400	2200	3600
3	Durrës	5000	8400	2200	3600
4	Elbasan	5000	8400	2200	3600
5	Vlore	5000	8400	2200	3600
6	Korçë	5000	8400	2200	3600
7	Fier	5000	8400	2200	3600
8	Berat	5000	8400	2200	3600
9	Gjirokastrë	5000	8400	2200	3600
10	Kavajë	5000	8400	2200	3600
11	Krujë	5000	8400	2200	3600
12	Lezhe	5000	8400	2200	3600
13	Lushnjë	5000	8400	2200	3600
14	Pogradec	5000	8400	2200	3600
15	Sarandë	5000	8400	2200	3600
16	Dibër	4300	7200	2200	3600
17	Gramsh	4300	7200	2200	3600
18	Kolonjë	4300	7200	2200	3600
19	Kukës	4300	7200	2200	3600
20	Kurbin	4300	7200	2200	3600
21	Librazhd	4300	7200	2200	3600
22	Mirdite	4300	7200	2200	3600
23	Mat	4300	7200	2200	3600
24	Përmet	4300	7200	2200	3600
25	Pukë	4300	7200	2200	3600
26	Skrapar	4300	7200	2200	3600
27	Tepelene	4300	7200	2200	3600
29	Tropojë	4300	7200	2200	3600
30	Bulqizë	4300	7200	2200	3600
31	Delvine	4300	7200	2200	3600
32	Devoll	4300	7200	2200	3600
33	Has	4300	7200	2200	3600
34	Kuçovë	4300	7200	2200	3600
35	Mallakastër	4300	7200	2200	3600
36	Peqin	4300	7200	2200	3600
36	Malësi e Madhe	4300	7200	2200	3600

Udhëzim

Nr. 16, datë 18.4.2008

Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.721, datë 30.10.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr.426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit"", të ndryshuar

Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.721, datë 30.10.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", të ndryshuar, udhëzohet të zbatohen procedurat si më poshtë:

1. Pagesa e shpenzimeve të varrimit, në shumën e përcaktuar në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.721, datë 30.10.2007, bëhet në emër të një familjari të personit të vdekur, i cili paraqet pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të rrethit certifikatën e vdekjes, faturën e funeralit ose një vërtetim nga kryeplaku i fshatit dhe një kërkesë të thjeshtë për tërheqjen e shpenzimeve të shërbimit të varrimit, ku cilësohet edhe relacioni me personin e vdekur.

2. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, nga drejtoritë rajonale ose ALSSH-ja do të hartohet çdo muaj urdhërpagesa e listuar në dy kopje, nga të cilat një kopje kalohet zyrtarisht në qendrën paguese të zgjedhur për kryerjen e këtyre pagesave dhe një kopje së bashku me dokumentet e tjera qëndron e arkivuar në zyrën e financës të rajonit apo agjencisë. Format i urdhërpagesës së listuar gjenden bashkëlidhur.

3. Urdhërpagesa e listuar bëhet e vlefshme për të autorizuar pagesat e shpenzimeve të varrimit nga qendrat paguese, vetëm pasi të nënshkruhet nga KD financës e drejtori i drejtorisë rajonale ose personat e autorizuar në ALSSH e t'i vendoset edhe vula. Dërgimi i urdhërpagesës së listuar për t'u paguar nga qendra paguese e Postës Shqiptare bëhet në mënyrë

protokollare dhe vetëm nëpërmjet filialit apo degës së Postës Shqiptare sh.a.

4. Urdhërpagesa e listuar plotësohet në fund të muajit mbi bazën e dokumenteve të cilësuar të pranuar gjatë muajit dhe dërgohet për pagesë që në datën 1 të muajit pasardhës. Kështu dokumentet e pranuar e të listuara në muajin janar 2008 do të dërgohen për pagesë në muajin shkurt 2008, e kështu në vazhdim.

5. Pagesa e shpenzimeve do të evidentohet në një listëpagesë, sipas formatit bashkëlidhur, e cila është dokument bazë që vërteton pagesën, plotësohet në dy kopje, nga të cilat një vjen zyrtarisht nga qendra e pagesës në zyrën e financës të sigurimeve shoqërore dhe shërben si dokument financiar për evidentimin në kontabilitet të pagesave të kryera. Procedurat e kontrollit, rakordimit, të financimeve paradhënie e përfundimtare dhe ato të kontabilitetit janë të njëjta si edhe për pagesën e pensioneve. Shpenzimet e kryera për këtë qëllim do të evidentohen në kontabilitet në nënlogarinë 60600.09 "Shpenzime të shërbimit të varrimit," ndërsa në raportin fiskal të muajit ato do të evidentohen së bashku me programet e tjera nënlogaria 60606.09.

6. Pagesat e kryera nga qendra paguese do të ballafaqohen çdo muaj me urdhërpagesën e listuar të dërguar duke evidentuar edhe rastet e papaguara. Këto raste, pasi të krahasohen edhe me listën e shpenzimeve të varrimit të papaguara të dërguara nga qendra paguese, do të evidentohen në urdhërpagesën e listuar të muajit pasardhës.

7. Në lidhje me marrëdhëniet me zyrat e pagesës, filialet dhe degët e Postës Shqiptare sh.a. procedurat janë përcaktuar në marrëveshjen e posaçme.

8. Shpenzimet e varrimit të identifikuar në vitin 2007 dhe të palikuiduara brenda periudhës do të likuidohen me fondet e akorduara për vitin 2008 në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste përfituesi duhet të paraqesë një dokument nga njësia e pushtetit vendor përkatës, që të vërtetojë moskryerjen e pagesës.

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ministri i Financave

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale
dhe Shanseve të Barabarta

Ridvan BODE

Koço BARKA

DREJTORIA RAJONALE

FILIALI I POSTËS SHQIPTARE
PËR ZYRËN POSTARE

Listëpagesë

*(Për pagesën e shpenzimeve të varrimit sipas vendimit të Këshillit të
Ministrave nr. 721, datë 30.8.2007)*

DATA E PAGESËS

NR.

EMRI

ATËSIA

MBIEMRI

NR.DOK. IDENTIFIKIMIT

SHUMA

NËNSHKRIMI

LIGJ

Nr. 7652, datë 23.12.1992

“PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE”

Neni 20

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992.

LIGJ

Nr. 7895, datë 27. 01. 1995

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SEKSIONI VIII

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Neni 189

Falsikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave
(ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12. 02. 2004, neni 5)

Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me gjobe nga katërqind mijë deri në një milion lekë.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të renda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me gjobë nga gjashtëqind mijë deri në dy milion lekë.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në tre milion lekë.

Neni 191

Falsifikimi i akteve të gjendjes civile

(ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12. 02. 2004, neni 7)

Falsifikimi apo përdorimi i akteve të gjendjes civile të falsifikuara dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në gjashtëqind mijë lekë.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të renda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në një milion lekë.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në tre milion lekë.

KODI PROÇEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU IV

B. GJYKIME NË LIDHJE ME MARTESËN

Neni 367

Pjesa urdhëruese e vendimit e vendimit të shkurorëzimit, mbasi ai të ketë marrë formën e prerë, i dërgohet nga gjykata për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

KREU VI

SHPLLJA E ZHDUKJES OSE E VDEKJES SE NJE PERSONI

Neni 375

Kush e bën kërkesën

Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar dhe nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë.

Neni 376

Përmbajtja e kërkesës

Në kërkesën për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur, përveç rrethanave nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme zhdukja ose vdekja e tij, tregohet edhe kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i tij, për rastet kur ka të tillë. Në kërkesën për deklarimin e një personi si të vdekur, duhet të tregohen edhe personat që janë ose mund të jenë trashëgimtarë të tij, si dhe gjithë personat e tjerë për të cilët është e ditur që nga ky fakt fitojnë ose humbin të drejta.

Neni 377

Publikimi i kërkesëpadisë

Gjykata, brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës për gjykim, i dërgon një kopje të saj bashkisë ose komunës, ku ka pasur banimin e tij të fundit personi që kërkohet të shpallet i zhdukur ose i vdekur, për ta shpallur në një vend të dukshëm. Kërkesa e mësipërme botohet edhe në Fletoren Zyrtare, si dhe të paktën në një gazetë lokale.

Shqyrtimi i çështjes nga gjykata nuk mund të bëhet pa kaluar gjashtë muaj nga shpallja e kërkesës ose botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

Neni 378

Proçedura e gjykimit

Gjykata, në shqyrtimin e kërkesës për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të një personi, pyet njerëz të afërt të tij, merr të dhëna për këtë person nga bashkia ose komuna, ku ai ka pasur vendbanimin e tij të fundit, si dhe nga çdo burim tjetër që mund të japë lajme për këtë person.

Neni 379

Në shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin ose prishjen e vendimit që ka deklaruar një person si të vdekur të thirren personat që kishin kërkuar deklarimin e vdekjes dhe personat që kanë fituar të drejta nga deklarimi i vdekjes.

Neni 380

Publikimi i vendimit

Gjykata vendos për shpalljen e një personi të zhdukur apo të vdekur, pasi të ketë dëgjuar edhe personat që përmenden në nenin 375 e 376 të këtij Kodi, si dhe prokurorin.

Gjykata urdhëron botimin e shkurtimit të vendimit në Fletoren Zyrtare ose të paktën në një gazetë lokale të caktuar prej saj ose në një mënyrë tjetër publikimi që do ta quajë të dobishme.

Gjykata mund të marrë edhe masa për sigurimin e pasurisë sipas

rrethanave që e bëjnë të nevojshme marrjen e tyre.

Neni 381

Regjistrimi i vendimit në zyrën e gjendjes civile

Vendimi i gjykatës, që e deklaron një person të zhdukur ose të vdekur, i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile në të cilën ai ka qenë i regjistruar, pasi të sigurohet se është bërë publikimi i tij sipas dispozitës së mësipërme.

KREU VIII

VERTETIMI GJYQËSOR I FAKTEVE

Neni 388

Kur mund të ngrihet kërkesa

Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi.

Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e rrethit në territorin e së cilës ndodhet sendi.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 389

Përmbajtja e kërkesës

Në kërkesën për vërtetimin e fakteve duhet të tregohen:

a. qëllimi për të cilin kërkuesi paraqit kërkesën për vërtetimin e faktit të

caktuar;

b. shkaqet për të cilat nuk mund të merret akti ose për të cilët nuk është mundur që akti të bëhet përsëri;

c. provat me të cilat do të provohet si shkak, për të cilin nuk është e mundur të merret akti ose ky akt nuk mund të bëhet përsëri, ashtu edhe fakti që kërkohet të vërtetohet.

Neni 390

Procedura e gjykimit

Kërkesa për vërtetimin e fakteve gjyqësore shqyrtohet në seancë gjyqësore, në prani të kërkuarit dhe të personave fizikë a juridikë që kanë interes në çështje. Kur çështja paraqet interes publik dhe gjykata e shihet arsyeshme, mund të thirret edhe prokurori.

Neni 391

Vendimi i gjykatës

Në vendimin e gjykatës duhet të tregohet fakti i vërtetuar prej asaj dhe provat në bazë të të cilave është vërtetuar fakti.

Kundër vendimit, me të cilin pranohet ose nuk pranohet kërkesa, mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme, nga kërkuari si dhe nga personat fizikë a juridikë që janë thirrur për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes. Vendimi nuk ka fuqi provuese kundër personave fizikë a juridikë që nuk kanë qenë thirrur në rast se e kundërshtojnë faktin e vërtetuar në vendim.

Neni 392

Efektet e vendimit të gjykatës

Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuarit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme.

KREU IX

NJOHJA E VENDIMEVE TË SHTETEVE TË HUAJA

Neni 393

Kushtet për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta.

Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes.

Neni 394

Pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:

- a. sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;
- b. kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;
- c. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;
- ç. është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;
- d. i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;
- dh. nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 395

Shqyrtimi i kërkesës

Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit. Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit.

Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën.

Neni 396

Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten:

a. kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;

b. vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;

c. prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.

Neni 397

Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394.

Për kërkesën e paraqitur gjykata e apelit jep vendi Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi.

PËR KODIN KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU I

PERSONAT FIZIKE

Ç. Banimi dhe qëndrimi

Neni 12

Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.

Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim. Kjo dispozitë nuk zbatohet për vendbanimin e veprimtarisë së tregtarit.

Neni 13

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij.

Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërmbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton. Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.

Neni 14

Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

D. Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi

Neni 15

Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës.

Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit. Kur muaji nuk mund të caktohet, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasëm.

Neni 16

Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar.

Vendimi i gjykatës, me të cilin një person është shpallur i zhdukur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Neni 17

Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.

Neni 18

Personi që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, në rast se kanë kaluar pa patur lajme dy vjet, nga dita që ka hyrë në fuqi marrëveshja e paqes ose tre vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, pa qenë nevoja të shpallet më parë i zhdukur.

Neni 19

Personi që ka humbur gjatë një fatkeqësie natyrore ose në rrethana që bëjnë të besohet se ka vdekur, mund të shpallet si i tillë me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur.

Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dy vjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit të mëpasshëm.

Neni 20

Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet kush prej tyre ka vdekur më parë, për efekte juridike, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë.

Neni 21

Kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet dita se kur ka ngjarë ajo. Kur kjo ditë nuk është e mundur të vërtetohet me saktësi, gjykata e cakton atë sipas rregullave të parashikuara në nenet e këtij Kodi.

Me kërkesën e çdo të interesuari, gjykata që ka dhënë vendimin, mund të ndryshojë datën e vdekjes, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër.

Neni 22

Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha asojet juridike me vdekjen e vërtetë.

Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Neni 23

Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi prishet nga gjykata që e ka dhënë.

Personi që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj, qoftë edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së tij, në kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod e nga Kodi i Familjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 1, datë 7.1.2009

PËR PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM, TË SHTETASVE SHQIPTARË DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE SHTRËNGUESE, PËR ATA, QË NUK APLIKOJNË BREND KËTYRE AFATEVE

I ndryshuar me :

- VKM nr. 50, datë 23.1.2009
- VKM nr. 332, datë 1.4.2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 3, pika 2, të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë," dhe të ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008 "Për ratifikimin e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike", ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aplikimi i shtetasve për t'u pajisur, për herë të parë, me letërnjoftim ose pasaportë elektronike, sipas kriterëve, mënyrës dhe vendit, të përcaktuara në ligjin nr.9972, datë 28.7.2008 "Për ratifikimin e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike", ndërmjet Ministrisë së Brendshme

të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e fondit shqiptaro-amerikan të ndërmarrjeve”, të fillojë më 12.1.2009.

2. Aplikimi për letërnjoftim dhe pasaportë elektronike kryhet në zyrat e regjistrimit, pranë bashkive/komunave/njësive bashkiake përkatëse, për personat, që kanë kryer në zyrat e postës ose në zyrat e financës të institucioneve përkatëse pagesën, të vërtetuar me mandatar këtëim përkatës, për çdo dokument.

3. Të gjithë shtetasit mbi moshën 16 vjeç janë të detyruar të aplikojnë për t’u pajisur me letërnjoftim elektronik. Aplikimi për letërnjoftimin elektronik është i vlefshëm edhe për pajisjen me pasaportën e re elektronike.

4. Shtetasit, të cilët janë të detyruar të pajisen me letërnjoftim, sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe që janë në moshën mbi 18 vjeç, në datën 28 qershor 2009, dhe nuk disponojnë pasaportë, nëse nuk pajisen me letërnjoftim deri më 15 maj 2009, nuk përfitojnë shërbimet e mëposhtme:

a) Pagesën ose shpërblimet për të gjithë personat fizikë, të punësuar në administratën dhe institucionet publike, si dhe për personat e punësuar në shoqëri, agjenci a ente shtetërore, qendrore apo vendore;

b) Pagesën apo shpërblimet për pensionistët;

c) Pagesën për ndihmë, përkrahje sociale a çdo lloj ndihme tjetër, ofruar nga institucionet publike, qendrore e vendore;

ç) Pranimin në provimet e fundvitit dhe regjistrimin në vitin shkollor/ akademik pasardhës, për të gjithë ata, që ndjekin studimet në shkollat e mesme dhe të larta, për pjesëmarrësit në konkurse apo gara të ndryshme, të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

d) Pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit;

dh) Shërbimin në zyrat e gjendjes civile, me përjashtim të regjistrimit të akteve të lindjes dhe të vdekjes, si dhe pajisjet me certifikatë, me fotografi, për aplikimin për letërnjoftim, sipas këtij vendimi;

e) Lëshimin ose rinovimin e lejeve, të autorizimeve, licencave nga organet e pushtetit qendror/vendor ndaj personave fizikë dhe përfaqësuesve ligjorë të personave juridikë;

ë) Aplikimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie, nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

- f) Aplikimin dhe lëshimin e dokumentit “Leje drejtimi automjeti” dhe kolaudimin e tyre;
- g) Lëshimin e vërtetimeve dhe të dokumenteve të tjera, të ngjashme me to, nga administrata gjyqësore;
- gj) Shërbimet noteriale;
- h) Shpërndarjen e karburantit, pa akcizë, për fermerët;
- i) Shërbimin nga zyrat e Alba-Postës.

Shërbimet e parashikuara në shkronjat “d” deri “i” nuk do të ofrohen edhe nëse shtetasi nuk ka aplikuar deri në datën 10 shkurt 2009.

4/1. Procedura e aplikimit për shtetasit e tjerë, të cilët disponojnë pasaportë, fillon në datën 1 maj 2009. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shtetasit, që kanë aplikuar përpara datës 31 janar 2009, për të cilët pajisja do të vazhdojë rregullisht:

- a) Nga data 1 prill 2009 deri më 1 maj 2009, shtetasit, që disponojnë pasaportë, nuk do të lejohen të aplikojnë për pajisjen me letërnjoftim.
- b) Në njësitë e qeverisjes vendore, ku ende nuk ka filluar procesi i aplikimit për pajisjen me letërnjoftim, procedura e aplikimit për shtetasit, që disponojnë pasaportë, do të fillojë më 1 qershor 2009.

5. Rekomandohet Banka e Shqipërisë të miratojë akte nënligjore, të detyrueshme për të gjithë ofruesit e shërbimeve bankare dhe financiare, në Republikën e Shqipërisë, me anë të të cilave detyrohen këta shtetas, që, pas datës 15 prill 2009, të paraqesin, pranë shërbimit bankar, dokumentin e identitetit ose kopje të formularit të aplikimit.

6. Udhëzohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që të miratojë akte nënligjore, të detyrueshme për ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik (duke përjashtuar shërbimet radiotelevizive) dhe shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm (të palëvizshëm), të lëvizshëm, tokësor dhe jotokësor, me anën e të cilave detyrohen këta shtetas, që, pas datës 30 prill, të paraqesin pranë këtyre autoriteteve letërnjoftimin ose kopje të formularit të aplikimit për pajisje me letërnjoftim.

7. Në çdo rast, ofruesit e shërbimeve, të përmendura në pikën 4 të këtij vendimi, duhet të shënojnë në dokumente numrin personal të identitetit

ose numrin e aplikimit, që ndodhet në formularin e aplikimit. Në mungesë të këtyre numrave, ofrimi i shërbimit nga punonjësit përben kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e masa të tjera administrative.

7/1. Nëse nga grupet e monitorimit vërehen, gjatë aplikimit, shkelje të afateve e të procedurave, të parashikuara në këtë vendim, nga punonjësit përkatës të zyrës së gjendjes civile, për shtetasit, që disponojnë pasaportë, kostoja e aplikimit do t'i ngarkohet punonjësit përgjegjës.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u dërgon, jo më vonë se data 30 janar 2009, të gjitha bashkive/komunave/njësisive bashkiake, listën përkatëse të shtetasve, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Njësia përkatëse e bën listën publike, si dhe brenda 10 ditëve, njofton shtetasit, emrat e të cilëve janë të shënuar në listë, për të aplikuar me përparësi për letërnjoftim.

Njoftimi shoqërohet me paralajmërimin për masat shtrënguese, që parashikohen sipas këtij vendimi apo akte të tjera ligjore e nënligjore, në fuqi. Pajisja me certifikatë e shtetasve, për qëllim të aplikimit për letërnjoftim, sipas shkronjës "d" të pikës 4 të këtij vendimi, nuk pengohet për asnjë shkak nga zyrat e gjendjes civile.

8/1. Lista e shtetasve të njësisë vendore përkatëse, sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të përditësohet në mënyrë periodike, si dhe të shpallet pranë zyrës së aplikimit, duke fshirë emrat e shtetasve, që kanë aplikuar. Nëse ndonjë shtetas, që nuk disponon pasaportë, nuk është përfshirë në listë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, mund ta paraqesë kërkesën për regjistrim pranë zyrës së gjendjes civile, pasi të ketë marrë më parë vërtetimin nga Drejtoria e Policisë së Shtetit.

9. Të gjitha institucionet shtetërore, qendrore apo vendore, marrin masa që pagesa për aplikimin për letërnjoftim për punonjësit e tyre të kryhet brenda institucioneve përkatëse. Kjo pagesë mund të përfshijë edhe pagesat për familjarët e personave të punësuar në institucionet shtetërore.

10. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzimin për formën e përmbajtjen e dokumenteve standarde për pagesën dhe aplikimin për pajisje me letërnjoftim dhe pasaportë elektronike, si dhe të marrë masat e duhura administrative për bashkërendimin e veprimtarive me të gjitha institucionet publike për zbatimin e këtij vendimi, e për fushatën publicitare, për nxitjen e shtetasve për pajisjen me letërnjoftim dhe pasaportë elektronike.

10/1. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzimet, për formën dhe përmbajtjen e formularit të njoftimit për shtetasit, si dhe për çdo kërkesë apo masë, që lidhet me pajisjen, me përparësi të shtetasve, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Ministri i Brendshëm informon, në mënyrë periodike, KQZ-në dhe Këshillin e Ministrave për ecurinë e procesit të pajisjes me letërnjoftim të shtetasve, që nuk disponojnë pasaportë.

11. Vendimi nr.596, datë 7.9.2006 i Këshillit të Ministrave "Për përdorimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të identitetit të shtetasve nga organet e administratës publike", dhe çdo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

12. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Financave, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe Banka e Shqipërisë, si dhe të gjitha institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe ministrave ose Këshillit të Ministrave, që ofrojnë shërbime, të nxjerrin akte nënligjore, sipas fushave dhe në përputhje me ligjet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali BERISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 418, datë 27.4.2009

PËR NJOHJEN DHE PËRDORIMIN E LETËRNJOFTIMIT SI DOKUMENT IDENTIFIKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3, 6 e 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë," të ndryshuar, të pikave 4 e 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile," të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 "Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve," me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet, publike dhe jopublike, vendase dhe të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do ta njohin si dokument identifikimi letërnjoftimin, sipas modelit të paraqitur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Certifikata personale me fotografi do të përdoret si dokument identifikimi vetëm për shtetasit nën moshën 16 vjeç.
3. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, mbajnë shënim numrin personal dhe numrin e letërnjoftimit, si dhe mund të bëjnë

fotokopje të letërnjoftimit të shtetasve, të cilëve u shërbejnë, nëse u nevojitet ky dokument si pjesë përbërëse e praktikës përkatëse.

4. Në rastet kur shtetasit nuk disponojnë letërnjoftim për arsye të justifikuara, lejohet përdorimi i certifikatës personale me fotografi, si dokument identifikimi, deri më 31 dhjetor 2009, në përputhje me dispozitat e parashikuara në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore.

5. Ndaj punonjësve të institucioneve, publike dhe jopublike, vendase, në rast të moszbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë vendim, do të merren masa disiplinore fillimisht me gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës, në rast përsëritjeje gjobë në vlerën e një page dhe nëse ripërsëritet pezullim nga detyra.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali BERISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 1243 , datë 11. 12. 2009

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTEVE, QË DUHET TË PARAQESIN SHTETASIT, E TË PROÇEDURAVE, QË DUHET TË KRYEJNË ZYRAT E GJENDJES CIVILE, NË BASHKI / NJËSI BASHKIAKE / KOMUNA, DHE INSTITUCIONET SHTETËRORE, TË POSAÇME, PËR NDRYSHIMIN E VENDBANIMIT/ADRESËS SË SHTETASVE.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 4, 20, pika 4, e 22, pika 2, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen Civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Shtetasit, të cilët kërkojnë të regjistrojnë/ndryshojnë vendbanimin duhet të paraqesin në zyrën e gjendjes civile nën juridiksionin e së cilës ndodhet ndërtesa, këto dokumente:

- a. Kërkesën me shkrim;
- b. Dokumentin e pronësisë së banesës, ose kontratë qiramarrjeje / huadhënie / përdorimi apo banimi;
- c. Letërnjoftimin, fotokopja e të cilit, për çdo person madhor, mbahet në praktikën përkatëse;
- d. Kontratën, apo çdo dokument tjetër të ligjshëm, të parashikuar nga

legjislacioni në fuqi, që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës.

Këto dokumente administrohen dhe ruhen nga zyra e gjendjes civile për një periudhë pesëvjeçare, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon Shërbimin e Gjendjes Civile.

2. Pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët kërkojnë të ndryshojnë vendbanimin e tyre, më parë duhet të realizojnë veçimin, si familje më vete, në zyrën e gjendjes civile ekzistuese, përveç rasteve të regjistrimit të vendbanimit, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi.

3. Bashkimi i një personi ose i një familjeje me një familje tjetër bëhet me pëlqimin e të gjithë pjesëtarëve madhorë me anën e deklarimit përpara nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile dhe kur plotësohet minimumi i sipërfaqes së banimit, 4 m² për frymë, përveç bashkimit me martesë dhe birësim.

II. VEPRIMET, QË KRYHEN NGA INSTITUCIONET SHTETËRORE, DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM DHE AFATET E KOMUNIKIMIT

4. Për shtetasit, të cilët kryejnë shërbimin ushtarak, apo kryejnë detyra në Forcat e Armatosura dhe banojnë brenda territorit të njësisë së Forcave të Armatosura, që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit, apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor, që qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, për kurim mjekësor afatgjatë dhe kur qëndrimi në këto institucione zgjat më shumë se tre muaj, institucioni përgjegjës duhet të paraqesë brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të tyre në institucion, pranë zyrës së gjendjes civile, që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, listën emërore të tyre.

5. Lista emërore e hartuar nga institucionet në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi, duhet të përmbajë emrin, atësinë, mbiemrin për çdo shtetas, të shoqëruar me fotokopje të letërnjoftimit.

6. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për këtë kategori shtetasish, kryen

veprimet sipas rregullave të përcaktuara nga ministri, që mbulon gjendjen civile.

7. Institucionet, shtetërore dhe arsimore, për shtetasit, të cilët për arsye pune/arsimimi ndryshojnë vendbanimin, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit nga këta shtetas, në përputhje me kërkesat e ligjit për gjendjen civile, e dërgojnë listën në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

8. Për regjistrimin e vendbanimit të ri të shtetasve, të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, institucionet shtetërore duhet të paraqesin, pranë zyrës së gjendjes civile, nën juridiksionin e së cilës ndodhen, këto dokumente:

- a. Listën emërore, ku shënohen, emri, atësia dhe mbiemri;
- b. Dokumentin, që vërteton se këta shtetas e kanë zgjidhur vendbanimin jashtë ndërtesave të institucionit;
- b. Fotokopjen e letërnjoftimit.

III. VEPRIMET E ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE

9. Në rastet kur ka mangësi në dokumentacion, zyra e gjendjes civile në bashkëpunim me institucionin përkatës, njoftojnë brenda 5 ditëve shtetasit për plotësimin e dokumentacionit. Në rast mosparaqitje brenda 5 ditëve, zyra e gjendjes civile dhe institucionet ndërpresin shërbimin për këta shtetas deri në plotësimin e dokumentacionit.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për regjistrimin e vendbanimit të shtetasve të huaj e të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm, në Republikën e Shqipërisë, pasi merr njoftimin nga zyra, që mbulon shtetësinë dhe refugjatët, i kërkon zyrës së gjendjes civile, ku këto shtetas kanë të përcaktuar vendbanimin e tyre, të bëjë regjistrimin sipas afateve të përcaktuara në lejen e qëndrimit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Kërkesa duhet të shoqërohet me kopje të dokumenteve të praktikës përkatëse.

11. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pas marrjes së dokumentacionit e të kërkesës nga shtetasit dhe nga institucionet, që e kanë këtë detyrim ligjor, me përjashtim të rasteve, sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij vendimi, bën menjëherë ndryshimin e adresës së shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri, që mbulon gjendjen civile, duke përcaktuar kështu vendbanimin e ri kryesor të tij.

12. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

IV. SHFUQIZIMET

13. Vendimi Nr. 184, datë 20.3.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe veprimet e zyrave të gjendjes civile dhe për detyrimin e shtetasve për transferimin e të dhënave të gjendjes civile”, dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet e tij prej datës 1 Janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim BASHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 1299 , datë 16. 12. 2009

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË NUMRIT TË NËPUNËSVE TË SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE, NË BASHKI/ NJESI BASHKIAKE/KOMUNA DHE NE DEGET E QARQEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62, të ligjit Nr. 10 129, datë 11. 05. 2009 “Për gjendjen civile”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e shërbimit të gjendjes civile ehte sipas pasqyrës Nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Organika e shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve është sipas pasqyrës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Numri prej 37 nëpunësish, i cili pakësohet nga numri i nëpunësve të miratuar për institucionin e prefektit, si nëpunës të gjendjes civile në degët e qarkut, i kalon numrit të përgjithshëm të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.
4. Numri i zyrave të shërbimit të gjendjes civile ehte 390 dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve është 524 veta.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Brendshme, programi i gjendjes civile.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi Nr. 21, date 9. 1. 2008 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali BERISHA


MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar NISHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pasqyra Nr. 1

STRUKTURA E SHËBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË



Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut

QARKU DIBER

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.G.J.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë
1	Dibër			1	(1 përgjegjës)
2		Peshkopi		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)
3			Arras	1	1 përgjegjës
4			Lure	1	1 përgjegjës
5			Fushë Cidhen	1	1 përgjegjës
6			Kala e Dodës	1	1 përgjegjës
7			Kastriot	1	1 përgjegjës
8			Luzni	1	1 përgjegjës
9			Maqellarë	1	1 përgjegjës
10			Melan	1	1 përgjegjës
11			Muhurr	1	1 përgjegjës
12			Selishtë	1	
13			Tomin	1	1 përgjegjës
14			Silovë	1	1 përgjegjës
15			Zall Dardhe + Zall Rec	1	1 përgjegjës
Total				15	15
1	Mat			1	1 përgjegjës
2		Burrel		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)
3		Klos		1	1 përgjegjës
4			Baz	1	1 përgjegjës
5			Ulëz	1	1 përgjegjës
6			Gurrë	1	1 përgjegjës
7			Komsi	1	1 përgjegjës
8			Lis	1	1 përgjegjës
9			Rukaj	1	1 përgjegjës
10			Derjan + Macukull	1	1 përgjegjës
11			Suç	1	1 përgjegjës
12			Xibër	1	1 përgjegjës
Total				12	13
1	Bulqizë			1	1 përgjegjës
2		Bulqizë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)
3			Gjoricë	1	1 përgjegjës
4			Ostren + Trebisht	1	1 përgjegjës
5			Martanesh	1	1 përgjegjës
6			Shupenzë	1	1 përgjegjës
7			Zerqan	1	1 përgjegjës
8			Fushë Bulqizë	1	1 përgjegjës
Total				8	9
		Totali Bashki		4	7
		Totali Komunë		28	27
		Total Dega e Qarkut		3	3
Total Qarku Dibër				35	37

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
QARKU DERRES

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Durrës			1	(1 përgjegjës)	1
2		Durrës, Rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Durrës, Rajoni 2		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4		Durrës, Rajoni 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Durrës, Rajoni 4		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
6		Durrës, Rajoni 5		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
7		Manëz		1	1 përgjegjës	1
8		Sukth		1	(1 përgjegjës + 1 punonjes)	2
9		Shijak		1	(1 përgjegjës + 1 punonjes)	2
10			Gjepalaj	1	1 përgjegjës	1
11			Ishëm	1	1 përgjegjës	1
12			Katund i ri	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
13			Maminas	1	1 përgjegjës	1
14			Rrashbull	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
15			Xhafzotaj	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
Total				15		31
1	Krujë			1	1 përgjegjës	1
2		Krujë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Fushë Krujë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Bubq	1	1 përgjegjës	1
5			Cudhi	1	1 përgjegjës	1
6			Thumanë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
7			Nikël	1	1 përgjegjës	1
Total				7		10
		Total Bashki		10		24
		Total Komunë		10		14
		Total Dega e Qarkut		2		2
Total Qarku Durrës				22		40

QARKU ELBASAN

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Elbasan			1	(1 përgjegjës)	1
2		Elbasan, Rajoni Nr. 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Elbasan, Rajoni Nr. 2		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4		Elbasan, Rajoni Nr. 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Elbasan, Rajoni Nr. 4		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
6		Elbasan, Rajoni Nr. 5		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
7		Belsh +	Rrasë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
8		Cërrik		1	1 përgjegjës	1
9			Bradashesh + Gracen	1	1 përgjegjës	1
10			Fierze	1	1 përgjegjës	1
11			Funarë	1	1 përgjegjës	1
12			Gjergjan	1	1 përgjegjës	1
13			Gjinat + Zavalinë	1	1 përgjegjës	1
14			Gostimë	1	1 përgjegjës	1
15			Grekën	1	1 përgjegjës	1
16			Kajan	1	1 përgjegjës	1
17			Klos	1	1 përgjegjës	1
18			Labinot-Fushë	1	1 përgjegjës	1
19			Labinot-Mal	1	1 përgjegjës	1
20			Mollas	1	1 përgjegjës	1
21			Papër	1	1 përgjegjës	1
22			Shales	1	1 përgjegjës	1
23			Shirgjan	1	1 përgjegjës	1
24			Shushicë	1	1 përgjegjës	1
25			Tregan	1	1 përgjegjës	1
Total				25		31
1	Gramsh			1	1 përgjegjës	1
2		Gramsh +	Skënderbegas + Kushovë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Kodovjat + Lenie	1	1 përgjegjës	1
4			Kukur	1	1 përgjegjës	1
5			Pishaj + Poroçan + Sult	1	1 përgjegjës	1
6			Tunjë	1	1 përgjegjës	1
Total				6		7
1	Peqin			1	1 përgjegjës	1
2		Peqin +	Karinë	1	1 përgjegjës	1
3			Gjocaj	1	1 përgjegjës	1
4			Pajovë	1	1 përgjegjës	1
5			Përparim	1	1 përgjegjës	1
6			Shezë	1	1 përgjegjës	1
Total				6		6
1	Librazhd			1	1 përgjegjës	1
2		Librazhd +	Steblevë	1	1 përgjegjës	1
3		Prrenjas		1	1 përgjegjës	1

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
QARKU FIER

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Fier			1	(1 përgjegjës)	1
2		Fier, Rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Fier, Rajoni 2		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
4		Fier, Rajoni 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Fier, Rajoni 4		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
6		Patos		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
7		Roskovec		1	1 përgjegjës	1
8			Cakran	1	(1 përgjegjës+ 1nëpunës)	2
9			Dermenas	1	1 përgjegjës	1
10			Frakull	1	1 përgjegjës	1
11			Kuman	1	1 përgjegjës	1
12			Kurjan	1	1 përgjegjës	1
13			Levan	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
14			Libofsh	1	1 përgjegjës	1
15			Mbrostar	1	1 përgjegjës	1
16			Portez	1	1 përgjegjës	1
17			Qender Fier	1	1 përgjegjës	1
18			Ruzhdie	1	1 përgjegjës	1
19			Strum	1	1 përgjegjës	1
20			Topojë	1	1 përgjegjës	1
21			Zharëz	1	1 përgjegjës	1
Total				21		30
1	Lushnjë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Lushnje, Rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Lushnje, Rajoni 2		1	2 nëpunës	2
4		Bashkia Divjakë		1	1 përgjegjës	1
5			Allkaj	1	1 përgjegjës	1
6			Ballagat	1	1 përgjegjës	1
7			Bubullimë	1	1 përgjegjës	1
8			Dushk	1	1 përgjegjës	1
9			Fier Shegan	1	1 përgjegjës	1
10			Golem	1	1 përgjegjës	1
11			Grabian	1	1 përgjegjës	1
12			Gradishtë	1	1 përgjegjës	1
13			Hysgjokaj	1	1 përgjegjës	1
14			Karbunarë	1	1 përgjegjës	1
15			Kolonjë	1	1 përgjegjës	1
16			Krutje	1	1 përgjegjës	1
17			Remas	1	1 përgjegjës	1
18			Tërbuf	1	1 përgjegjës	1
Total				18		20
1	Mallakastër			1	1 përgjegjës	1

QARKU GJIROKASTER

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.G.J.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Gjirokastrë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Gjirokastrë		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Libohovë +	Zagori + Qendër	1	1 përgjegjës	1
4			Cepo + Picar	1	1 përgjegjës	1
5			Dropull i Poshtëm	1	1 përgjegjës	1
6			Dropull i Sipërm	1	1 përgjegjës	1
7			Lazarat	1	1 përgjegjës	1
8			Lunxhëri + Antigoni + Odrë	1	1 përgjegjës	1
9			Pogon	1	1 përgjegjës	1
	Total			9		11
1	Tepelenë			1	1 përgjegjës	1
2		Tepelenë		1	1 përgjegjës	1
3		Memaliaj		1	1 përgjegjës	1
4			Memaliaj Fshat	1	1 përgjegjës	1
5			Krahas + Qesarat	1	1 përgjegjës	1
6			Lufthinje + Buz	1	1 përgjegjës	1
7			Qendër + Kurvelesh + Lopes	1	1 përgjegjës	1
	Total			7		7
1	Përmet			1	1 përgjegjës	1
2		Përmet		1	1 përgjegjës	1
3		Këlcyrë		1	1 përgjegjës	1
4			Ballaban	1	1 përgjegjës	1
5			Carcove	1	1 përgjegjës	1
6			Dishnice	1	1 përgjegjës	1
7			Petran	1	1 përgjegjës	1
8			Qendër + Frasher	1	1 përgjegjës	1
9			Suke	1	1 përgjegjës	1
	Total			9		9
		Total Bashki		6		8
		Total Komunë		16		16
		Total Dega e Qarkut		3		3
	Total Qarku Gjirokastrë			25		27

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
QARKU KORÇE

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Korçë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Korçë		4	(1 përgjegjës + 6 nëpunës)	7
3		Maliq		1	1 përgjegjës	1
4			Gorë	1	1 përgjegjës	1
5			Drenovë	1	1 përgjegjës	1
6			Libonik	1	1 përgjegjës	1
7			Liqenas	1	1 përgjegjës	1
8			Mollaj + Vithkuq	1	1 përgjegjës	1
10			Pirg	1	1 përgjegjës	1
11			Pojan	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
12			Bulgarec	1	1 përgjegjës	1
13			Voskop	1	1 përgjegjës	1
14			Voskopojë + Lekas + Moglicë	1	1 përgjegjës	1
17			Vreshtas	1	1 përgjegjës	1
Total				17		21
1	Kolonjë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Ersekë		1	1 përgjegjës	1
3		Leskovik	Barmash + Leskovik	1	1 përgjegjës	1
4			Mollas + Clirim	1	1 përgjegjës	1
5			Qendër Ersekë + Novoselë	1	1 përgjegjës	1
Total				5		5
1	Pogradec			1	(1 përgjegjës)	1
2		Pogradec		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3			Buçimas	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Çerravë	1	1 përgjegjës	1
5			Dardhas	1	1 përgjegjës	1
6			Hudenisht	1	1 përgjegjës	1
7			Proptisht	1	1 përgjegjës	1
8			Trebinjë	1	1 përgjegjës	1
9			Velcan	1	1 përgjegjës	1
Total				9		12
1	Devoll			1	(1 përgjegjës)	1
2		Bilisht		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Qender Bilisht	1	1 përgjegjës	1
4			Miras	1	1 përgjegjës	1
5			Progër	1	1 përgjegjës	1
6			Hocisht	1	1 përgjegjës	1
Total				6		7
		Total Bashki		9		15
		Total Komunë		24		26
		Total Dega e Qarkut		4		4
Total Qarku Korçë				37		45

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut

QARKU KUKES

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë
1	Kukës			1	(1 përgjegjës)
2		Kukës +	Kolsh	1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)
3			Bicaj + Ujmisht	1	1 përgjegjës
4			Bushtrice + Gryk-Caje + Kalis	1	1 përgjegjës
5			Malzi	1	1 përgjegjës
6			Shishtavec	1	1 përgjegjës
7			Shtiqen	1	1 përgjegjës
8			Surroj + Arren	1	1 përgjegjës
9			Tërthorë	1	1 përgjegjës
10			Topojan	1	1 përgjegjës
11			Zapod	1	1 përgjegjës
	Total			11	13
1	Has			1	1 përgjegjës
2		Krumë +	Gjinaj	1	1 përgjegjës
3			Fajza	1	1 përgjegjës
4			Golaj	1	1 përgjegjës
	Total			4	4
1	Tropojë			1	1 përgjegjës
2		Bajram Curri		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)
3			Bytyc	1	1 përgjegjës
4			Bujan	1	1 përgjegjës
5			Lekbibaj	1	1 përgjegjës
6			Fierzë	1	1 përgjegjës
7			Tropojë	1	1 përgjegjës
8			Llugaj	1	1 përgjegjës
9			Margegaj	1	1 përgjegjës
		Total		9	10
		Totali Bashki		3	6
		Totali Komunë		18	18
		Total Dega e Qarkut		3	3
		Total Qarku Kukës		24	27

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut

QARKU LEZHË

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Lezhë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Lezhë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Ballëdre	1	1 përgjegjës	1
4			Blinisht	1	1 përgjegjës	1
5			Dajç	1	1 përgjegjës	1
6			Kallmet	1	1 përgjegjës	1
7			Kolsh	1	1 përgjegjës	1
8			Shëngjin	1	1 përgjegjës	1
9			Shënkoll	1	1 përgjegjës	1
10			Ungrej	1	1 përgjegjës	1
11			Zejmen	1	1 përgjegjës	1
	Total			11		12
1	Mirditë			1	1 përgjegjës	1
2		Rrëshen +	Kaçinar	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Rubik		1	1 përgjegjës	1
4			Fan	1	1 përgjegjës	1
5			Kthellë + Selitë	1	1 përgjegjës	1
6			Orosh	1	1 përgjegjës	1
	Total			6		7
1	Kurbini			1	1 përgjegjës	1
2		Laç		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Mamurras		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Fushë-Kuqe	1	1 përgjegjës	1
5			Milot	1	1 përgjegjës	1
	Total			5		8
		Total Bashki		5		10
		Total Komunë		14		14
		Total Dega e Qarkut		3		3
	Totali Qarku Lezhë			22		27

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
QARKU SHKODER

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Shkodër			1	(1 përgjegjës)	1
2		Shkodër		1	(1 përgjegjës + 9 nëpunës)	10
3		Vau-Dejës +	Temal	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Ana-Malit	1	1 përgjegjës	1
5			Bushat	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
6			Bërdicë	1	1 përgjegjës	1
7			Dajç	1	1 përgjegjës	1
8			Gur i Zi	1	1 përgjegjës	1
9			Hajmë + Vig-Mnëllë	1	1 përgjegjës	1
10			Postribë	1	1 përgjegjës	1
11			Fult	1	1 përgjegjës	1
12			Krethinat	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
13			Shalë + Shosh	1	1 përgjegjës	1
14			Velipojë	1	1 përgjegjës	1
15			Shllak	1	1 përgjegjës	1
Total				15		27
1	Pukë			1	1 përgjegjës	1
2		Pukë +	Rrapë	1	1 përgjegjës	1
3		Fushë-Arrës +	Blerim + Qafë-Mali	1	1 përgjegjës	1
4			Ilballë	1	1 përgjegjës	1
5			Fierzë	1	1 përgjegjës	1
6			Gjegjan	1	1 përgjegjës	1
7			Qerret + Qelëz	1	1 përgjegjës	1
Total				7		7
1	Malësi e Madhe			1	1 përgjegjës	1
2		Koplik		1	1 përgjegjës	1
3			Gruemirë	1	1 përgjegjës	1
4			Kastrat	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5			Kelmend	1	1 përgjegjës	1
6			Qender	1	1 përgjegjës	1
7			Shkrel	1	1 përgjegjës	1
Total				7		8
		Total Bashki		5		15
		Total Komunë		21		24
		Total Dega e Qarkut		3		3
Total Qarku Shkodër				29		42

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
QARKU TIRANE

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Zyra Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Tiranë			1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
2		Bashkia Tiranë		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Njësia Bashkiake Nr. 1		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
4		Njësia Bashkiake Nr. 2		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
5		Njësia Bashkiake Nr. 3		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
6		Njësia Bashkiake Nr. 4		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
7		Njësia Bashkiake Nr. 5		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
8		Njësia Bashkiake Nr. 6		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
9		Njësia Bashkiake Nr. 7		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
10		Njësia Bashkiake Nr. 8		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
11		Njësia Bashkiake Nr. 9		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
12		Njësia Bashkiake Nr. 10		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
13		Njësia Bashkiake Nr. 11		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
14		Bashkia Kamëz		1	(1 përgjegjës + 5 nëpunës)	6
15		Bashkia Vorë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
16			Baldushk	1	1 përgjegjës	1
17			Bërxullë	1	1 përgjegjës	1
18			Bërzhitë	1	1 përgjegjës	1
19			Dajt	1	1 përgjegjës	1
20			Farkë	1	1 përgjegjës	1
21			Kashar	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
22			Krrabë	1	1 përgjegjës	1
23			Ndroq	1	1 përgjegjës	1
24			Paskuqan	1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
25			Pejë	1	1 përgjegjës	1
26			Prezë	1	1 përgjegjës	1
27			Petrelë	1	1 përgjegjës	1
28			Shëngjergj	1	1 përgjegjës	1
29			Vaqarr	1	1 përgjegjës	1
30			Zall-Bastar	1	1 përgjegjës	1
31			Zall-Herr	1	1 përgjegjës	1
Total				31		79
1	Kavajë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Kavajë		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Rrogozhinë	Sinaballaj	1	1 përgjegjës	1
4			Golem	1	1 përgjegjës	1
5			Gosë	1	1 përgjegjës	1
6			Helmes	1	1 përgjegjës	1
7			Kryevidh	1	1 përgjegjës	1
8			Lekaj	1	1 përgjegjës	1
9			Luz i vogël	1	1 përgjegjës	1
10			Synej	1	1 përgjegjës	1
Total				10		12
		Total Bashki		16		62
		Totali Komune		23		26
		Total Dega e Qarkut		2		3
Total Qarku Tiranë				41		91

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
QARKU VLORE

Nr.	Rrethi	Bashkia	Komuna	Z.GJ.C	Numri nëpunësve për çdo zyrë	
1	Vlorë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Vlorë, Rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Vlorë, Rajoni 2		1	2 nëpunës	2
4		Vlorë, Rajoni 3		1	2 nëpunës	2
5		Vlorë, Rajoni 4		1	2 nëpunës	2
6		Vlorë, Rajoni 5		1	2 nëpunës	2
7		Himarë		1	1 përgjegjës	1
8		Orikum		1	1 përgjegjës	1
9		Selenice		1	1 përgjegjës	1
10			Armen	1	1 përgjegjës	1
11			Brataj	1	1 përgjegjës	1
12			Hore-Vranisht	1	1 përgjegjës	1
13			Kotë	1	1 përgjegjës	1
14			Novoselë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
15			Qender	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
16			Sevaster	1	1 përgjegjës	1
17			Shushicë	1	1 përgjegjës	1
18			Vllahinë	1	1 përgjegjës	1
Total				18		25
1	Sarandë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Sarandë		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
3		Konispol		1	1 përgjegjës	1
4			Aliko	1	1 përgjegjës	1
5			Dhivër	1	1 përgjegjës	1
6			Ksamil	1	1 përgjegjës	1
7			Livadhja	1	1 përgjegjës	1
8			Lukovë	1	1 përgjegjës	1
9			Markat	1	1 përgjegjës	1
10			Xarrë	1	1 përgjegjës	1
Total				10		13
1	Delvinë			1	1 përgjegjës	1
2		Delvinë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Finiq	1	1 përgjegjës	1
4			Mesopotam	1	1 përgjegjës	1
5			Vergo	1	1 përgjegjës	1
Total				5		6
		Total Bashki		11		20
		Totali Komune		19		21
		Total Dega e Qarkut		3		3
Total Qarku Vlorë				33		44

Organika e Shërbimit të Gjendjes Civile në Bashki, Komuna dhe në Degët e Qarkut
PERMBLEDHJESE

Nr.	Qarku	Z.Gj.C Bashki	Nëpunës Bashki	Z.Gj.C Komuna	Nëpunës Komuna	Z.Gj.C Rreth	Nëpunës Rreth	Z.Gj.C Total Qark	Nëpunës Total Qark
1	Berat	7	11	17	17	3	4	27	31
2	Dibër	4	7	28	27	3	3	35	37
3	Durrës	10	24	10	14	2	2	22	40
4	Elbasan	11	18	33	33	4	4	48	55
5	Fier	10	19	34	36	3	3	47	58
6	Gjirokastrë	6	8	16	16	3	3	25	27
7	Korçë	9	15	24	26	4	4	37	45
8	Kukës	3	6	18	18	3	3	24	27
9	Lezhë	5	10	14	14	3	3	22	27
10	Shkodër	5	15	21	24	3	3	29	42
11	Tiranë	16	62	23	26	2	3	41	91
12	Vlorë	11	20	19	21	3	3	33	44
Totali		97	215	257	272	36	38	390	525



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 332, datë 17. 03. 2010

PËRPËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTËVE PËRBËRËSE, MËNYRËS SË MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE BAZË, QË MBAHEN DHE LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 25, të ligjit Nr. 10 129, date 11.5.2009 "Për Gjendjen Civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Forma dhe elementët përbërës të dokumenteve që mban dhe lëshon Shërbimi i Gjendjes Civile, të jenë sipas modeleve bashkëlidhur, në lidhjen nr. 1, përkatësisht:

- a) Mod. nr. 1, akt lindje;
- b) Mod. nr. 2, akt martese;
- c) Mod. nr. 3, akt vdekjeje;
- ç) Mod. nr. 4, procesverbal për ndryshim emri/mbiemri;
- d) Mod. nr. 5, procesverbal për bashkim familjeje;
- dh) Mod. nr. 6, procesverbal për veçim familjeje;
- e) Mod. nr. 7, procesverbal për njohje atësie;
- ë) Mod. nr. 8, shpallje martese;
- f) Mod. nr. 9, vendim për pezullimin e procedurës për lidhje martese;
- g) Mod. nr. 10, vendim për refuzim për lidhje martese;
- gj) Mod. nr. 11, vendim për ndreqje gabimi material;

- h) Mod. nr. 12, leje varrimi;
- i) Mod. nr. 13, çertifikatë, për përdorim brenda vendit;
- j) Mod. nr. 14, çertifikatë lindjeje për përdorim nga autoritetet e huaja;
- k) Mod. nr. 15, çertifikatë për lidhje martesë, për përdorim nga autoritetet e huaja;
- l) Mod. nr. 16 çertifikatë martesë, për përdorim nga autoritetet e huaja;

2. Çertifikata për përdorim brenda vendit do të ketë numër rendor progresiv, në të cilin tre numrat e parë tregojnë kodin e përcaktuar për çdo zyrë të gjendjes civile, sipas lidhjes nr. 2, të bashkëlidhur dhe 6 shifrat e tjera numrin e serisë së çertifikatës.

3. Të gjithë dokumentat e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, plotësohen on-line nga nëpunësit e zyrës së gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake, komuna nëpërmjet Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.

4. Përmasat e fletëve të dokumentave bazë të gjendjes civile janë të formatit A-4.

5. Afati i ruajtjes së modeleve është si më poshtë vijo:

- a) Me ruajtje të përhershme, mod. nr. 4, mod. nr. 5, mod. nr. 6, mod. nr. 7 dhe mod. nr. 11;
- b) Me ruajtje për një periudhë dy-vjeçare, mod. nr. 8;
- c) Për një periudhë njëvjeçare, mod. nr. 9 dhe mod. nr. 10.

7. Specifikimet teknike të shtypshkrimeve dhe mënyra e lidhjes së akteve dhe proçesverbaleve përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

8. Vendimi nr. 828, datë 11. 12. 2003 i Këshillit të Ministrave "Për formën, mënyrën e mbajtjes, elementët përbërëse dhe afatin e përdorimit të dokumenteve të gjendjes civile", i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
Sali BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim BASHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 1

AKT LINDJENr. ____ Datë: ____ / ____ / ____
(dita) (muaji) (viti)Datëlindja: ____ / ____ / ____
(dita) (muaji) (viti)

Ora e lindjes: ____ : ____

Vendlindja: ____ / ____
(fshati / qyteti) (rrethi)Emri: _____ (_____) Mbiemri: _____ Gjinia: M ☐ F ☐
Emri i përkohshëmKombësia: _____ (_____)
Kombësia e përkohshme

Shtetësia: _____ Numri i identitetit _____

Lloji i lindjes: Normal ☐ Binjakë ☐ Siamezë ☐

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E BABAIT	TË DHËNAT E NËNËS
Emri, mbiemri		
Mbiemri para martesë		
Numri i identitetit		
Datëlindja		
Vendlindja (fshati/qyteti, rrethi)		
Kombësia		
Shtetësia		
Vendbanimi (adresa) dhe ZGjC-ja		
Vendqëndrimi (adresa)		

Deklaruesi: Emri mbiemri		
Numri i identitetit		
Vendbanimi (adresa) ZGjC-ja		
Lidhja e deklaruesit me fëmijën		
Përkthyesi: Emri, mbiemri		
Numri i identitetit		

Vërejtje

Ky akt, pasi u redaktua, u lexua, u nënshkrua nga deklaruesi dhe unë.

Deklaruesi**Përkthyesi**

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënime nga verifikimi vjetor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 2

AKT MARTESE

Nr. _____ Datë: ____ / ____ / ____
(dita) (muaji) (viti)

Nr. _____ Data e shpalljes së martesës: ____ / ____ / ____
(dita) (muaji) (viti)

Vendim Nr. _____ Data ____ / ____ / ____ i Gjykatës
(dita) (muaji) (viti)

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E BASHKËSHORTIT	TË DHËNAT E BASHKËSHORTES
Emri, mbiemri		
Numri i identitetit		
Atësia		
Amësia		
Datëlindja		
Vendlindja (fshati/qyteti, rrethi)		
Gjendja Civile		
Kombësia		
Shtetësia		
Vendbanimi (adresa)		
Vendqëndrimi (adresa)		

Mbiemri që do të mbajë secili prej bashkëshortëve pas martesës		
Njohja e atësisë dhe amësisë së fëmijëve të lindur para martesë		
Nr. data e kontratës së regjimit pasuror		
Dëshmitarët: Emri, Mbiemri, Numri i Identitetit, Vendbanimi (adresa)	1.	
	2.	
Përkthyesi: Emri, Mbiemri		
Numri i Identitetit		

Vërejtje

Ky akt, pasi u redaktua, u lexua u nënshkrua prej të gjithëve e meje.

Dëshmitarët	Bashkëshortët	Përkthyesi
_____ (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)	_____ (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)	_____ (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)
_____ (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)	_____ (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)	

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënime nga verifikimi vjetor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 3

AKT VDEKJE

Nr. _____ Datë: ____ / ____ / ____
(dita) (muaji) (viti)

Data e vdekjes: ____ / ____ / ____
(dita) (muaji) (viti)

Ora e vdekjes ____ : ____

Vendi i vdekjes: _____

Shtëpi/institucion mjekësor/të tjera

Shkaku i vdekjes: _____

Kodi i sëmundjes: _____

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E PERSONIT TË VDEKUR
Emri, mbiemri	
Numri i identitetit	
Atësia	
Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja (fshati/ qyteti, rrethi)	
Gjendja Civile	
Emri dhe mbiemri i bashkëshortit/ es	
Kombësia	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa)	
Vendqëndrimi (adresa)	

Deklaruesi: Emri, mbiemri, Numri i identitetit,

Lidhja e deklartuesit me personin e vdekur

Vendbanimi (adresa)

Mjeku ose eksperti ligjor: Emri, mbiemri

Numri i identitetit

Leja e Prokurorisë (Nr. Datë)

Vendim Gjykatë (Nr. Datë)

Vërejtje

Ky akt, pasi u redaktua, u lexua , u nënshkrua nga deklaruesi dhe unë.

Deklaruesi

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënime nga verifikimi vjetor:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 4

PROÇESVERBAL Nr. _____ PËR NDRYSHIM EMRI/MBIEMRI

Sot më datë ____/____/____ në praninë time _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër identiteti _____, atësi _____, amësi _____, i datëlindjes ____/____/____, vendlindja _____, banues në adresën _____

regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve, i cili me anë të kërkesës me Nr. ____ Prot., datë ____/____/____, kërkon të ndryshojë emrin/mbiemrin nga: _____ në _____

Për arsye se: _____

Në bazë të Nenit _____ të Ligjit Nr. _____, datë ____/____/____ "Për Gjendjen Civile", pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, unë e pranoj këtë kërkesë, për ndryshim emri/mbiemri nga _____ në _____.

Kërkuesi / Përfaqësuesi ligjor

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Personat madhorë të familjes

1. _____
3. _____
5. _____
7. _____
9. _____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

2. _____
4. _____
6. _____
8. _____
10. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 5

PROÇESVERBAL Nr. _____ PËR BASHKIM FAMILJE

Sot më datë ____/____/____ në praninë time _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër identiteti _____, atësi _____, amësi _____ i datëlindjes ____/____/____, vendlindja _____, banues në adresën _____

regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili me kërkesën Nr. _____, Datë ____/____/____ kërkon të bashkohet me familjen _____ për arsye se: _____.

Në përputhje me nenin _____, të Ligjit _____, Datë ____/____/____ "Për Gjendjen Civile", unë e pranoj këtë kërkesë, për bashkim familje.

Ky procesverbal nënshkruhet nga nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile, kërkuesi dhe të gjithë personat madhorë të familjes pranuese.

Kërkuesi

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Personat madhorë të familjes

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 6

PROÇESVERBAL Nr. _____ PËR VEÇIM FAMILJE

Sot më datë ____/____/____ në praninë time _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër identiteti _____, atësi _____, amësi _____, i datëlindjes ____/____/____, vendlindja _____, banues në adresën _____

regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili me kërkesën Nr. _____, Datë ____/____/____ kërkon të veçohet nga familja _____ për arsye se: _____.

Në përputhje me nenin _____, të Ligjit _____, Datë ____/____/____ "Për Gjendjen Civile", unë e pranoj këtë kërkesë, për veçim nga familja.

Ky procesverbal nënshkruhet nga nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile, kërkuksi dhe të gjithë personat madhorë të familjes.

Kërkuksi

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Personat madhorë të familjes

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 7

PROÇESVERBAL Nr. _____

PËR

NJOHJE ATËSIE

Sot, me datë _____ para meje _____, nëpunëse e zyrës së gjendjes civile të _____, u paraqiten:

Z. _____, i biri i _____ dhe i _____ i datëlindjes _____, me profesion _____, banues në _____, me Nr. Identiteti _____ me zotësi të plotë për të vepruar; dhe

Znj. _____, e bija e _____ dhe e _____ e datëlindjes _____, me profesion _____, banuese në _____, me Nr. Identiteti _____ me zotësi të plotë për të vepruar,

Të cilët deklarojnë se:

Fëmija me emër _____, i regjistruar në aktin e lindjes Nr. _____, datë _____, në Zyrën e Gjendjes Civile _____, si fëmijë me mëmësi _____ dhe me atësi të pagënë _____, e njohin si fëmijë të tyre.

Për këtë njohje jep pëlqimin dhe nëna e fëmijës .

Ky procesverbal u redaktua në tre kopje, iu lexua deklaruësve me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua prej tyre dhe meqenëse u gjet sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë u nënshkrua prej deklaruësve e meje.

Deklaruesit

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi.)

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi.)

Bashkëlidhur vendoset dhe fotokopja e lehtënjoftimit e deklaruësve dhe certifikata e aktit lindjes.

Një kopje mbahet në zyrën e protokollit, një në zyrën e gjendjes civile dhe një i jepet shtetasit. Ky dokument ruhet përgjithmonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 8

SHPALLJE MARTESE Nr. _____

Sot më datë ____/____/_____, publikohet shpallja e martesës së shtetasve:

(dita) (muaji) (viti)

me _____

(Emri, Mbiemri)

(Emri, Mbiemri)

të cilët kërkuar të lidhin martesë në Zyrën e Gjendjes Civile _____.

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E BASHKËSHORTIT TË ARDHSHMËM	TË DHËNAT E BASHKËSHORTES SË ARDHSHME
Emri		
Mbiemri		
Atësia		
Amësia		
Numri i identitetit		
Datëlindja		
Vendlindja		
Kombësia		
Shtetësia		
Vendbanimi (Adresa)		
Vendqëndrimi (Adresa)		

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Personat, të cilët kanë shkaqe ligjore, duhet të paraqesin brenda 10 ditëve, nga dita e sotme, kundërshtimet për lidhjen e kësaj martese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 9

VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ / ____ / ____

**PËR
PEZULLIMIN E PROÇEDURËS PËR LIDHJE MARTESE**

Në bazë të Nenit _____ të Ligjit Nr. _____, datë ____ / ____ / ____ “Kodi i Familjes”, procedura e lidhjes së martesës ndërmjet _____, dhe _____, shpallur më datë ____ / ____ / ____ në Zyrën e Gjendjes Civile _____, pezullohet për shkak se:

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 10

VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ / ____ / ____

PËR REFUZIM PËR LIDHJE MARTESE

Unë, _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____ në bazë të Nenit _____ të Ligjit Nr. _____, datë ____ / ____ / ____ "Kodi i Familjes", refuzoj lidhjen e martesës ndërmjet shtetasve _____, dhe _____, shpallur më datë ____ / ____ / ____ në Zyrën e Gjendjes Civile _____, për shkak se:

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 11

VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ / ____ / ____

**PËR
NDREQJE GABIMI MATERIAL**

Sot më datë ____/____/____ në praninë time, _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____, me numër identiteti _____, atësi _____, amësi _____, i datëlindjes ____/____/____, vendlindja _____, banues në adresën _____ regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili me anë të kërkesës Nr. ____ Prot., datë ____/____/____, kërkon ndreqje në rubrikën _____.

Pas verifikimeve rezultoi se dokumentacioni i paraqitur, ishte në përputhje me ligjin.

Për këtë arsye, bazuar në Nenin _____ të Ligjit _____, datë _____. _____. 2009, "Për Gjendjen Civile",

VENDOSA:

Të bëhet ndreqja e gabimit material në rubrikën

nga _____ në _____
nga _____ në _____

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Për çdo ndreqje gabim material, shtetasi duhet të paraqesë certifikatën e marrë nga akti i lindjes si dhe certifikata të të gjitha regjistrimeve pas vitit të lindjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 12

LEJE VARRIMI

Për shtetasin _____, i cili vdiq më datë ____/____/____,
u mbajt akti i vdekjes Nr. ____ , datë ____/____/____.

Lejohet kryerja e varrimit pas orës ____ : ____ , më datë ____/____/____.

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

QARKU BERAT

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Berat			1
	Berat, Rajoni Nr. 1		2
	Berat, Rajoni Nr. 2		3
	Berat, Rajoni Nr. 3		4
	Ura Vajgurore		5
		Kutalli	6
		Lumas	7
		Otllak	8
		Poshnje	9
		Roshnik	10
		Sinje	11
		Terpan	12
		Velabisht	13
		Vertop	14
		Cukalat	15
Kuçovë			16
	Kuçovë		17
		Kozarë	18
		Perondi	19
Skrapar			20
	Çorovodë		21
	Poliçan		22
		Bogovë	23
		Çepan	24
		Gjerbës	25
		Leshnjë	26
		Potom	27
		Qender	28
		Vendreshë	29
		Zhepë	30

QARKU DIBER

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Dibër			31
	Peshkopi		32
		Arras	33
		Fushë Çidhen	34
		Fushë Muhurr	35
		Kala e Dodës	36
		Kastriot	37
		Lure	38
		Luzni	39
		Maqellarë	40
		Melan	41
		Tomn	42
		Selishtë	43
		Silovë	44
		Zall Dardhe	45
		Zall Reç	46
Mat			47
	Burrel		48
	Klos		49
		Derjan	50
		Gurrë	51
		Baz	52
		Komsi	53
		Lis	54
		Macukull	55
		Rukaj	56
		Suç	57
		Ulëz	58
		Xibër	59
Bulqizë			60
	Bulqizë		61
		Gjoricë	62
		Trebisht	63
		Martanesh	64
		Ostren	65
		Shupenzë	66
		Zerqan	67
		Fushë Bulqizë	68

QARKU DURRES

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Durrës			69
	Durrës, Rajoni 1		70
	Durrës, Rajoni 2		71
	Durrës, Rajoni 3		72
	Durrës, Rajoni 4		73
	Durrës, Rajoni 5		74
	Manëz		75
	Sukth		76
	Shijak		77
		Gjepalaj	78
		Ishëm	79
		Katund i ri	80
		Maminas	81
		Rrashbull	82
		Xhafzotaj	83
Krujë			84
	Krujë		85
	Fushë Krujë		86
		Bubq	87
		Cudhi	88
		Thumanë	89
		Nikël	90

QARKU ELBASAN

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Elbasan			91
	Elbasan, Rajoni Nr. 1		92
	Elbasan, Rajoni Nr. 2		93
	Elbasan, Rajoni Nr. 3		94
	Elbasan, Rajoni Nr. 4		95
	Elbasan, Rajoni Nr. 5		96
	Cërrik		97
	Belsh		98
		Bradashesh	99
		Fierze	100
		Funarë	101
		Gostimë	102
		Gracen	103
		Grekan	104
		Gjinat	105
		Gjergjan	106
		Kajan	107
		Klos	108
		Labinot-Mal	109
		Labinot-Fushë	110
		Mollas	111
		Papër	112
		Rrasë	113
		Shales	114
		Shirgjan	115
		Shushicë	116
		Tregan	117
		Zavalinë	118
Gramsh			119
	Gramsh		120
		Kodovjat	121
		Kukur	122
		Kushovë	123
		Lenie	124
		Pishaj	125
		Poroçan	126
		Skënderbegas	127
		Sult	128
		Tunjë	129
Peqin			130
	Peqin		131
		Karinë	132

QARKU FIER

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Fier			149
	Fier, Rajoni 1		150
	Fier, Rajoni 2		151
	Fier, Rajoni 3		152
	Fier, Rajoni 4		153
	Patos		154
	Roskovec		155
		Cakran	156
		Dermentas	157
		Frakull	158
		Kuman	159
		Kurjan	160
		Libofsh	161
		Levan	162
		Mbrostar	163
		Portez	164
		Qender Fier	165
		Ruzhdie	166
		Strum	167
		Topojë	168
		Zharëz	169
Lushnjë			170
	Lushnje, Rajoni 1		171
	Lushnje, Rajoni 2		172
	Divjakë		173
		Allkaj	174
		Ballagat	175
		Bubullimë	176
		Dushk	177
		Fier Shegan	178
		Golem	179
		Grabian	180
		Gradishtë	181
		Hysgjokaj	182
		Karbunarë	183
		Kolonjë	184
		Krutje	185
		Remas	186
		Tërbuf	187
Mallakastër			188

QARKU GJIROKASTER

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Gjirokaštër			198
	Gjirokaštër		199
	Libohovë		200
		Qendër	201
		Cepo	202
		Dropull i Poshtëm	203
		Dropull i Sipërm	204
		Lazarat	205
		Lunxhëri	206
		Odrie	207
		Picar	208
		Pogon	209
		Antigon	210
		Zagori	211
Tepelenë			212
	Tepelenë		213
	Memaliaj		214
		Buz	215
		Memaliaj Fshat	216
		Krahes	217
		Kurvelesh	218
		Lopes	219
		Luftinje	220
		Qesarat	221
		Qendër	222
Përmet			223
	Përmet		224
	Këlcyrë		225
		Ballaban	226
		Carcove	227
		Frasher	228
		Petran	229
		Qendër	230
		Suke	231
		Dishnice	232

QARKU KORÇE

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Korçë			233
	Korçë, Rajoni 1		234
	Korçë, Rajoni 2		235
	Korçë, Rajoni 3		236
	Korçë, Rajoni 4		237
	Maliq		238
		Drenovë	239
		Gorë	240
		Lekas	241
		Libonik	242
		Liqenas	243
		Moglicë	244
		Mollaj	245
		Pirg	246
		Pojan	247
		Bulgarec	248
		Vithkuq	249
		Voskop	250
		Voskopojë	251
		Vreshtas	252
Kolonjë			253
	Ersekë		254
	Leskovik		255
		Barmash	256
		Clirim	257
		Leskovik	258
		Mollas	259
		Novoselë	260
		Qendër Ersekë	261
Pogradec			262
	Pogradec		263
		Buçimas	264
		Çerravë	265
		Dardhas	266
		Hudenisht	267
		Proptisht	268
		Trebinjë	269
		Velçan	270
Devoll			271
	Bilisht		272
		Qender Bilisht	273
		Miras	274
		Hoçisht	275
		Progër	276

QARKU KUKES

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Kukës			277
	Kukës		278
		Arren	279
		Bicaj	280
		Bushtrice	281
		Malzi	282
		Ujmisht	283
		Tërthorë	284
		Shtiqen	285
		Zapod	286
		Shishtavec	287
		Topojan	288
		Surroj	289
		Kolsh	290
		Kalis	291
		Gryk-Cajë	292
Has			293
	Krumë		294
		Golaj	295
		Fajzë	296
		Gjinaj	297
Tropojë			298
	Bajram Curri		299
		Bujan	300
		Bytyç	301
		Fierzë	302
		Lekbibaj	303
		Llugaj	304
		Margegaj	305
		Tropojë	306

QARKU LEZHE

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Lezhë			307
	Lezhë		308
		Balldre	309
		Blinisht	310
		Dajç	311
		Kallmet	312
		Kolsh	313
		Shëngjin	314
		Ungrej	315
		Shënkoll	316
		Zejmen	317
Mirditë			318
	Rrëshen		319
	Rubik		320
		Fan	321
		Kaçinar	322
		Kthellë	323
		Orosh	324
		Selitë	325
Kurbin			326
	Laç		327
	Mamurras		328
		Fushë-Kuqe	329
		Milot	330

QARKU SHKODER

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Shkodër			331
	Shkodër, Lagja 1		332
	Shkodër, Lagja 2		333
	Shkodër, Lagja 3		334
	Shkodër, Lagja 4		335
	Vau-Dejës		336
		Ana-Malit	337
		Bushat	338
		Barbullush	339
		Bërdicë	340
		Dajç	341
		Gur i Zi	342
		Hajmel	343
		Postribë	344
		Pult	345
		Rrethinat	346
		Shalë	347
		Shosh	348
		Temal	349
		Velipojë	350
		Vig-Mnelë	351
		Shllak	352
Pukë			353
	Pukë		354
	Fushë-Arrës		355
		Blerim	356
		Iballë	357
		Fierzë	358
		Gjegjan	359
		Qafë-Mali	360
		Qelëz	361
		Qerret	362
		Rrapë	363
Malësi e Madhe			364
	Koplik		365
		Gruemirë	366
		Kastrat	367
		Kelmend	368
		Qender	369
		Shkrel	370

Shënim: Komuna Barbullush është bashkuar me Komunën Bushat

QARKU TIRANE

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Tiranë			371
	Bashkia Tiranë		372
	Njesia Bashkiake Nr. 1		373
	Njesia Bashkiake Nr. 2		374
	Njesia Bashkiake Nr. 3		375
	Njesia Bashkiake Nr. 4		376
	Njësia Bashkiake Nr. 5		377
	Njësia Bashkiake Nr. 6		378
	Njësia Bashkiake Nr. 7		379
	Njësia Bashkiake Nr. 8		380
	Njësia Bashkiake Nr. 9		381
	Njësia Bashkiake Nr. 10		382
	Njësia Bashkiake Nr. 11		383
	Bashkia Kamëz		384
	Bathore		385
	Bashkia Vorë		386
		Baldushk	387
		Berzhitë	388
		Berxullë	389
		Dajt	390
		Farkë	391
		Kashar	392
		Ndroq	393
		Paskuqan	394
		Petrelë	395
		Pezë	396
		Prezë	397
		Shëngjergj	398
		Vaqarr	399
		Vaqarr	400
		Zall-Bastar	401
		Krrabë	402
Kavaje			403
	Kavajë		404
	Rrogozhinë		405
		Golem	406
		Gosë	407
		Helmes	408
		Kryevidh	409
		Lekaj	410
		Luz i vogël	411
		Sinaballaj	412
		Synej	413

Shënim: Bathore është mbyllur

QARKU VLORE

Rrethi	Bashkia	Komuna	Kodi
Vlorë			414
	Vlorë, Rajoni 1		415
	Vlorë, Rajoni 2		416
	Vlorë, Rajoni 3		417
	Vlorë, Rajoni 4		418
	Vlorë, Rajoni 5		419
	Himarë		420
	Orikum		421
	Selenice		422
		Armen	423
		Brataj	424
		Hore-Vranisht	425
		Kote	426
		Novoselë	427
		Qender	428
		Sevaster	429
		Shushicë	430
		Vllahinë	431
Sarandë			432
	Sarandë		433
	Konispol		434
		Aliko	435
		Dhiver	436
		Dhiver 2 (mbyllur)	437
		Ksamil	438
		Livadhja	439
		Lukove	440
		Markat	441
		Xarrë	442
Delvinë			443
	Delvinë		444
		Finiq	445
		Mesapotam	446
		Vergo	447

Shënim: Dhiver 2 është mbyllur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

URDHËR

Nr. 1366, Datë 19. 08. 2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PRANIMIN NË DETYRE TE PUNONJESIT TE ZYRES SE GJENDJES CIVILE

Ne mbështetje të pikes 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe germa a, b, g të nenit 60, pika 2 e nenit 61, dhe pika 2 e nenit 63 të ligjit nr. 8950 dt. 10.10.2002 "Për Gjendjen Civile" dhe me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Urdhëroj:

1. Emërimi i punonjësve të zyrave të gjendjes civile në Degën e Qarkut/ Bashki/Njësi Bashkiake/ Komuna, bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Kjo rregullore do të zbatohet edhe për të gjithë punonjësit e zyrave të gjendjes civile në Degën e Qarkut/ Bashki/Njësi Bashkiake/ Komuna, që janë emëruar pa zbatuar Urdhrin nr. 154 dt. 19.11.2003 "Për zbatimin e kritereve profesionale për funksionimin e shërbimit të gjendjes civile" ose në kundërshtim me këtë Urdhër.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të beje evidentimin e këtyre rasteve, dhe në bashkëpunim me Prefektët dhe Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të filloje procedurën e emërimit sipas rregullores së re.

4. Urdhëri nr. 154 dt. 19.11.2003 dhe çdo akt tjetër që ka lidhje me zbatimin e tij , shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Prefektet e Qarqeve, Kryetaret e njësive të qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Sokol OLLDASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES CIVILE

RREGULLORE

PËR PRANIMIN NË DETYRE TE PUNONJESIT TE ZYRES SE GJENDJES CIVILE

Procedura për hapjen e konkursit.

1. – Pranimi në detyren e nepunesit të zyrës së gjendjes civile në Degën e Qarkut/Bashki/Njësi Bashkiakë/Komunë bëhet vetëm nëpërmjet procedurës së konkurimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në bashkepunim me Institucionet të cilat kanë bërë kërkesën.

2. – Në rastet e krijimit të vendit të lirë të punës së punonjësit të gjendjes civile, Prefekti i Qarkut/Kryetari i Njësisë Vendore komandon në këtë detyrë përkohësisht një punonjës, kriteret profesionale të të cilit nuk bien në kundërshtim me këtë urdhër.

3. - Prefekti i Qarkut/Kryetari i Njësisë Vendore paraqet kërkesë me shkrim në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për plotësimin e vendit të lirë të punës, jo me vonë se një muaj nga data e krijimit të vendit të lirë, (e cila duhet të korrespondojë me ditën e komandimit të një punonjësi të përkohshëm), duke e shoqëruar këtë me shpjegimin e shkaqeve të krijimit të vendit të lirë.

4. – Në të njëjtën datë me datën e nisjes së kërkesës në DPGJC, Prefekti i Qarkut/Kryetari i Njësisë Vendore, bën shpallje publike në vende me hyrje të lirë për publikun dhe në mediat lokale, për pozicionin e lirë të vendit të

punës. Ky njoftim duhet të zgjasë deri në 10 dite para datës së zhvillimit të testimit.

5. – Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pasi merr në shqyrtim kërkesën e bërë nga Prefekti i Qarkut/Kryetari i Njësisë Vendore, vendos për zhvillimin e testimit, datën, oren dhe vendin.

Si rregull, DPGJC, organizon testimin të premtën e fundit të çdo tremujori. Në raste të veçanta mund të zhvillojë testime jashtë radhe me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile pas konfirmimit të Ministrisë ose Zëvendësministrit.

6. – Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile vendos për zhvillimin e testimit në rast se plotësohet minimumi i mundshëm prej 4 konkurrentësh për një vend pune në Degën e Qarkut/Bashki dhe 3 konkurrentësh për një vend pune në Komunë.

7. – Në rast të mosplotësimit të një prej pikave të procedurës së hapjes së konkursit, testimi shtyhet për në testimin e ardhshëm.

8. – Në rast të mos zhvillimit të testimit pas dy tentativave, Prefekti i Qarkut/Kryetari i Njësisë Vendore duhet të rekomandojë një nëpunës tjetër të gjendjes civile dhe procedura rifillon nga e para.

KRITERET E PRANIMIT NË DETYRE PËR PUNONJESIN E ZYRËS SË GJENDJES CIVILE NË DEGEN E QARKUT

- 1) Të ketë arsim të lartë, preference Fakultetin Juridik.
- 2) Të ketë përvojë pune në administratë, të paktën 1 vit.
- 3) Të jete njohës i mirë i ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002, "Për Gjendjen Civile", i ligjit nr. 8951, datë 10.10.2002, "Për Numrin e Identitetit të shtetasve", i ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, "Për Dokumentin e Identitetit të shtetasve shqiptarë", i ligjit nr. 9062, datë 8.05.2003, "Kodi i Familjes", i ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002, "Për Prefektin", i ligjit

nr. 7726, datë 29.06.1993, "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat" si dhe i akteve nënligjore, udhëzimeve, urdhrave, rregulloreve, etj. të dala ne baze dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara.

4) Të mos ketë qene i dënuar penalisht me vendim të gjykatës të formës së prerë.

5) Të ketë njohuritë baze të punës ne kompjuter për programin WINDOWS-WORD.

6) Të mos ketë lidhje farefisnie deri ne rradhe të dytë me Prefektin e Qarkut .

7) Të ketë shkrim të qarte.

8) Të ketë aftësi të mira komunikuese.

KRITERET E PRANIMIT NË DETYRE PËR PUNONJESIN E ZYRËS SË GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI BASHKIAKE/KOMUNA

1) Të ketë arsim të larte.

2) Të jete njohës i mire i ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002, "Për Gjendjen Civile", i ligjit nr. 8951, datë 10.10.2002, "Për Numrin e Identitetit të shtetasve", i ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, "Për Dokumentin e Identitetit të shtetasve shqiptare", i ligjit nr. 9062, datë 8.05.2003, "Kodi i Familjes", i ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ligjit nr. 8927, date 25.07.2002, "Për Prefektin", i ligjit nr. 7726, datë 29.06.1993, "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat" si dhe i akteve nënligjore, udhëzimeve, urdhrave, rregulloreve, etj. të dala ne baze dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara.

3) Të mos ketë qene i dënuar penalisht me vendim të gjykatës të formës së prerë.

4) Të ketë njohuritë baze të punës ne kompjuter për programin WINDOWS-WORD.

5) Të mos ketë lidhje farefisnie deri ne rradhe të dytë me Kryetarin e Njësisë Vendore.

6) Të ketë shkrim të qarte.

7) Të ketë aftësi të mira komunikuese.

Për Komunat, në rast të mosplotësimit të pikës 1 të kriterëve të përcaktuara, merret miratim nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile,

për konsiderimin e kandidateve me arsim të mesëm.

Paraqitja e Dokumenteve të konkurentëve. :

Dokumentet do të dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile nga titullari i institucionit që bën kërkesën ose nga vete i interesuari, jo më vonë se 1 javë përpara datës së testimit.

Dokumentet që nuk dorëzohen brenda këtij afati, nuk pranohen.

Dokumentet që do të paraqiten janë :

- 1) Kërkesë personale për pozicionin e vendit të punës
- 2) CV (Curriculum Vitae)
- 3) Diplome e shkollës së lartë (Fotokopje e noteruar)
- 4) Dëshmi penaliteti e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë
- 5) Çertifikate e njohurive baze në përdorimin e kompjuterit me programe WINDOWS-WORD
- 6) Çertifikate personale me fotografi
- 7) Fotokopje e Librezës së Punës

Mungesa e njërit prej dokumenteve të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumenteve, sjell skualifikimin e konkurentit

TESTIMI

Hartimi i tezave

- Komisioni i hartimit të tezave është i përbërë prej dy anetaresh të cilët janë specialistet e te Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Procedurave dhe hartojnë tre teza testimi të sekretuara .Secila teze në total ka 100 pike.
- Teza ka në përbërje pyetje nga baza ligjore e shërbimit të gjendjes civile dhe mund të përpilohet në formë testi me përgjigje ose në formë pyetjesh të përgjithshme.
- Pas hartimit të tezës, secila prej tyre mbyllet në zarf, dhe i jepet komisionit të testimit.
- Në çdo rast specialisti që harton tezen e testimit nuk mund të jete anëtar i komisionit të testimit.

Zhvillimi i Testimit

- Komisioni i testimit është i perbere prej 3 anëtarë :
 - o Drejtori i Drejtorise së Dokumentacionit në DPGJC Kryetar
 - o Përgjegjësi i Sektorit të Procedurave në DPGJC Anëtar
 - o Specialist i Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Procedurave Anëtar
- Secili nga konkurrentet merr nga komisioni i procedurës së testimit flete të nevojshme për zhvillimin e tezes. Në fletën e pare është i vendosur emri dhe mbiemri i konkurentit, njësia vendore dhe data, e cila pastaj me fillimin testimit sekretohet. Vendosja e shenjave të veçanta në tezë çon në skualifikimin e konkurentit.
- Në mbarimin e testimit të të gjithë konkurrenteve, bëhet korrigjimi i testit nga komisioni i testimit.
- Sapo mbaron korrigjimi hartohet menjëherë procesverbali i vleresimit të tezave.

Ankimimi

1. Çdo konkurrent mund të beje ankim me shkrim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile brenda 5 ditëve nga dita e zhvillimit të testimit.
 2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile pasi shqyrton ankesën, kthen përgjigje brenda 10 ditëve nga data e marrjes së ankesës.
 3. Në rast se konstatohet shkelje në zbatimin e procedurave, Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, propozon përsëritjen e procedurave të testimit.
 4. Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm ankimohe brenda 3 ditëve nga marrja e saj te Sekretari i Përgjithshëm, i cili kthen përgjigje brenda 10 ditëve.
- Kjo përgjigje është e formës së prerë dhe përfundimtare.

Pas përfundimit të të gjithë procedurës, procesverbali i hartuar në tre kopje i dërgohet titullarit të institucionit që ka bërë kërkesën, një kopje

tjetër dërgohet në protokollin e Ministrisë së Brendshme dhe kopja e trete mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Procedura e emërimit

1. Titullari i Institucionit zgjedh ndërmjet dy konkurrenteve të cilët radhiten të parët dhe që janë vlerësuar mbi 40 pike në procesverbalin e hartuar nga Drejtoria e Dokumentacionit dhe Procedurave. Me përcaktimin e fituesit, Titullari përpilon aktin e emërimit të punonjësit të zyrës së gjendjes civile sipas nenit 61 pika 2, 63 pika 2 e ligjit nr. 8950 "Për gjendjen civile".

2. Një kopje e vendimit të emërimit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Prefektit të Qarkut, së bashku me specimenet përkatëse të punonjësit të ri, vula zyrtare, (vula e nëpunësit nëse ka) si dhe formularin tip me një fotografi.

MINISTRI

Sokol OLLDASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

UDHËZIM

Nr. 116, datë 12. 04. 2010

**PËR PROÇEDURAT E PËRFTIMIT TË SHPËRBLIMIT NGA REGJISTRIMI
I FËMIJEVE SIPAS LIGJIT NR. 10 129, DATË 11. 05. 2009 "PËR
GJENDJEN CIVILE".**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4 e nenit 41 të ligjit Nr. 10129, datë 11. 05. 2009 "Për gjendjen civile",

UDHËZOJ :

1. Nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile do të regjistrojnë të gjithë fëmijët e paregjistruar dhe të lindurit pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi sipas procedurave ligjore ekzistuese.
2. Për rastet e regjistrimit të lindjeve të ndodhura brenda vendit të cilat deklarohen brenda afatit 60 ditor nga dita e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile do të mbajë aktin e lindjes dhe do të pajisë të interesuarin me çertifikatë lindje, në të cilën duhet pasqyruar saktë data e lindjes dhe data e mbajtjes së aktit të lindjes.
3. Për rastet e regjistrimit të lindjeve të ndodhura jashtë shtetit, të cilat deklarohen brenda afatit 90 ditor nga dita e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile do të pajisë të interesuarin me çertifikatën e lindjes në të cilën do të pasqyrojë saktë datën e lindjes dhe datën e mbajtjes së aktit, kur akti mbahet në këtë zyrë ose datën e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për rastet kur akti është mbajtur jashtë shtetit.

4. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pasi vëren se rasti përmbush kriteret e pikës 2 dhe 3, e pajis të interesuarin me çertifikatën e lindjes së fëmijës me shënimin “Për efekt shpërblimi, nga regjistrimi i lindjes brenda afatit ligjor”. Për të gjithë këto raste, zyra e gjendjes civile harton një listë mujore dhe e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe një kopje zyrës së financës përkatëse.

5. I interesuari me çertifikatën e lindjes duhet të paraqitet në zyrën e financës së Bashkisë/Njesisë Bashkiake/Komunës përkatëse, për të tërhequr shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekë.

6. Punonjësi i ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë/Njesisë Bashkiake/Komunës, pasi administron çertifikatën e lindjes me shënimin “Për efekt shpërblimi, nga regjistrimi i lindjes brenda afatit ligjor”, e verifikon me listën e hartuar nga zyra e gjendjes civile, kryen pagesën dhe në fund të çdo muaji harton listën e shtetasve, të cilët kanë përfituar nga ky shpërblim.

7. Brenda datës 05 të muajit pasardhës, Kryetari Bashkisë/Njesisë Bashkiake/Komunës, dërgon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme kërkesën për fond, të shoqëruar me listën emërore të fëmijëve të regjistruar brenda afatit ligjor dhe që kanë përfituar/ do të përfitojnë shpërblimin.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, përgatit pasqyrën përmbledhëse për njësitë shpenzuese që kanë paraqitur kërkesë për fond dhe çdo dy muaj e dërgon pranë Drejtorisë së Politikave Financiare.

9. Drejtoria e Politikave Financiare përgatit praktikën dhe e dërgon menjëherë në Ministrinë e Financës për rialokimin e fondit nga programi i “Gjendjes Civile”, për Bashkitë/Njësitë Bashkiake/Komunat.

10. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Politikave Financiare në Ministrinë e Brendshme dhe Bashkitë/Njësitë Bashkiake/Komunat.

11. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTRI
Lulzim BASHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

UDHËZIM

Nr. 308, datë 8. 5. 2009

PËR PAJISJEN ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës konsensionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”;

UDHËZOJ:

1. Shtetasit aplikojnë për pasaportë biometrike në mjediset e përcaktuara nga koncesionari për këtë qëllim dhe në përputhje me rregullat e miratuara në kontratën koncesionare midis Ministrisë së Brendshme dhe Koncesionarit.
2. Dokumentacioni shkresor ruhet nga koncesionari në arkivë për një periudhë pesëvjeçare pas prodhimit të pasaportës.
3. Aplikimi i shtetasve nën moshën 16 vjeç për pasaportën biometrike bëhet vetëm në prezencë të të paktën të njërit prej prindërve, të kujdestarit ligjor ose të përfaqësuesit me prokurë të posaçme.
4. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile nuk ka fuqi vendimmarrëse në procesin e aplikimit, por kryen vetëm verifikimin e identitetit të aplikuesit,

duke e konfirmuar në formularin e aplikimit.

5. Shtetasit nën moshën 16 vjeç pajisen me pasaportë biometrike si më poshtë:

a) 0 vjeç deri 6 vjeç, do të pajisen me pasaportë biometrike pa u marrë shenjat e gishtave.

b) 6 vjeç deri 16 vjeç, gjatë aplikimit për pasaportë biometrike do t'u merren, përveç të tjerave, edhe shenjat e gishtave.

6. Pajisja me pasaportë biometrike bëhet brenda 15 ditëve nga data e aplikimit.

7. Pasaporta biometrike do të tërhiqet pranë drejtorive/komisariateve të policisë, sipas procedurës së miratuar.

8. Tërheqja e pasaportës kryhet nga aplikanti, përfaqësuesit e përcaktuar në pikën 2 ose një pjesëtar i afërt i familjes (bashkëshorti/ja, prindi, fëmija).

9. Vlefshmëria e pasaportës për shtetasit nën moshën 16 vjeç është 5 vjet.

10. Shtetasit që kanë aplikuar për pasaportë biometrike, në momentin e marrjes në dorëzim të kësaj pasaporte, vihen në dijeni për pavlefshmërinë e pasaportës së mëparshme, veprim i cili kryhet menjëherë nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit pranë DPPSH.

11. Në rastet kur shtetasit disponojnë viza të vlefshme në pasaportat ekzistuese, ata paraqesin para organeve të kufirit pasaportën biometrike të shoqëruar me pasaportën ekzistuese, në të cilën ndodhet viza e vlefshme. Pasaporta e vjetër evidentohet dhe shënohet, duke ia dorëzuar shtetasit për përdorim deri në përfundim të vlefshmërisë së vizës.

12. Pas lëshimit të pasaportave biometrike, sistemi i kontrollit të kufirit (TIMS) do të kryejë procedurat si vijon:

a) Transferimi i të dhënave do të kryhet manualisht, periodikisht deri në momentin kur të dy sistemet do të mund të komunikojnë online.

b) Kompania koncesionare dërgon periodikisht në rrugë manuale/elektronike/online, informacion mbi pasaportat e lëshuara. Ky grup pasaportash do të krahasohet me pasaportat aktive në sistemin TIMS; të gjitha krahasimet pozitive çaktivizojnë pasaportat ekzistuese në sistemin TIMS.

13. Në çdo rast, kur shtetasi kërkon të ripajiset me pasaportë, do të zbatohen të njëjtat procedura si për marrjen e saj për herë të parë, por duke lëshuar nga ana e aplikantit një deklaratë për arsyet e kërkesës për ripajisje.

a) Shtetasi kërkon të ripajiset me pasaportë përpara mbarimit të afatit të pasaportës që disponon në rastet e mëposhtme:

- kur pasaporta e mëparshme është vjedhur ose dëmtuar;
- kur pasaporta e mëparshme ka humbur;
- kur ndryshojnë gjeneralitetet.

14. Në rast të shkeljeve të procedurave të parashikuara në këtë udhëzim, ndaj nëpunësve të ngarkuar me zbatimin e këtij akti do të merren masa disiplinore.

15. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zyrat e gjendjes civile në bashi/komuna/njësi bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

16. Dispozitat e udhëzimit nr. 1627, datë 22.1.2002 “Mbi procedurat për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, që bien ndesh me këtë udhëzim, revokohen për të gjitha zyrat ku ka filluar aplikimi për pajisjen me pasaporta biometrike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe gjen zbatim në të gjitha zyrat që do të fillojnë aplikimin, si dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar NISHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 375 datë 03.06.2009

Mbi Procedurat e ripajisjes së shtetasve me letërnjoftim/pasaportë biometrike në rastet të humbjes/vjedhjes së tyre

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim 7/2 të ligjit 9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", në zbatim të nenit 5/c të Ligjit nr. 8952 datë 10.10.2002 "Për dokumentin e indentifikimit të shtetasve shqiptarë", si dhe me qëllim përcaktimin e rregullave për paisjen e shtetasve me letërnjoftim/pasaportë

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e policisë së qarqeve nëpërmjet komisarivateve të policisë të marrin masa për pranimin e kallëzimeve dhe evidencimin e rasteve të humbjes apo vjedhjes së letërnjoftimeve apo të pasaportave, të paraqitura nga shtetasit e ndryshëm.
2. Për të gjithë rastet e marrjes dijeni për humbjen e letërnjoftimit/pasaportave të shtetasve shqiptar, seksionet e parandalimit të krimit e policimit në komunitet, në komisaritet e policisë, të marrin kallëzimin me shkrim personit që i ka humbur dokumentin, si dhe të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për verifikimin e rrethanave të këtij fakti dhe të autorësisë së mundshme.
3. Brenda tre ditëve nga marrja e kallëzimit për humbjen apo vjedhjen e dokumentit (letërnjoftimit elektronik, pasaportës) komisarati i policisë

të pajisë shtetasin përkatës me vërtetimin e deklaramit të humbjes së dokumentit sipas modelarit bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

4. Kallëzimet e marra për këto raste të administrohen dhe ndiqen sipas rregullave të përgjithshme procedurale dhe udhëzimeve të Drejtorit Përgjithëm të Policisë.

5. Zyrat vendore të gjendjes civile me paraqitjen e shtetasit me vërtetimin e lëshuar nga Komisariati i Policisë, "Për deklaramin e humbjes së letërnjoftimit /pasaportës" fillojnë menjëherë procedurat në bashkëpunim me zyrat e konçesionarit, për të bërë të pavlefshme letërnjoftimin apo pasaportën e humbur/vjedhur dhe për ripaisjen e shtetasit me letërnjoftim apo pasaportë të re.

6. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Policia e Shtetit dhe zyrat e shërbimit të gjendjes civile.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI
Bujar NISHANI

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI
PËR SHËRBIMIN
E GJËNDJES CIVILE**